Ernesto Sabato

TUNELI

RILINDJA

Ernesto Sabato

TUNELI

Biblioteka **A T L A S**

Redaktor
ALI PODRIMJA

860(82)-31

ERNESTO SABATO

t

Tuneli



RILINDJA
Redaksia e botimeve
Prishtinë
1981

Titulli i origjinalit

ERNESTO SABATO

EL TÚNEL

BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE
"HIVZI SULEJMANI"
PRISHTINË

Përktheu

JAK MITA

BIBLIOTEKA POPULLORE „MILLADIN POPOVIĆ"
NARODNA BIBLIOTEKA „MILADIN POPOVIĆ"
PRISHTINË — PRIŠTINA

Lektor

GANI BOBI

Kopertinën e punoi

ENVER SYLEJMANI

Ky libër iu kushtua më 1951 miqësisë fisnike të Rohelio Friherios. Emri i tij u ngrit shpesh, vite me radhë, në lartësi të dhembshme të prijësit nacional. Në atë periudhë pajtoheshim dhe u ndërvajtëm, por diçka mbeti e paprekur: miqësia e thellë që nga ditët studenteske.

Nga kjo ndjenjë, që nuk më treti kurrë, përveç në çështje të politikës, po e përtërij për pushtimin e atij botimi tashmë të kahershëm.

E. S.

„... sido që të jetë, ishte vetëm një
tunel, i errët dhe vetmitar:
Tuneli im!"

I

Mjafton po qe se them se unë jam Huan Pablo Kasteli, piktor që vrau Maria Iribarneon; supozoj se të gjithëve do t'u kujtohet procesi dhe do të jetë i tepërt çdo shpjegim tjetër për personin tim.

As dreqi vetë nuk e di ç'duhet t'u kujtohet njerëzve, dhe pse? Në të vërtetë, mendoja gjithnjë se nuk ka ndjenjë kolektive, e cila do të ishte, ndoshta, një lloj i mbrojtjes së gjinisë njerëzore. Thënia: „Ishte më e mirë koha që shkoi" nuk do të thotë se më parë ndodhnin më pak të këqia, por që — për fat — njerëzit i harrojnë ato. Thënia e këtillë nuk ka vlerë të përgjithshme; për mua, ta zëmë, është karakteristike ajo që mua më kujtohen për mrekulli ngjarjet e papëlqyeshme, ashtu që sikur e tanishmja të mos më dukej aq e tmerrshme si e kaluara gati do të thoja: „Ishte më e keqe koha që shkoi". Më kujtohen aq fatkeqësi, aq persona cinikë e mizorë, aq vepra të liga, sa mbamendja për mua është si dritë e fikshme që ndriçon muzeun e mënishëm të turpësisë.

Sa e sa herë më pat ndodhur, orë të tëra të qëndroj në këndin e errët të ateliesë, i dërmuar nga ndonjë lajm në kronika policore! Por, është

e vërtetë se në to nuk paraqiten ato që janë nga më të turpshmet për gjininë njerëzore; kriminelët janë, në njëfarë dore, njerëzit më të dëlirë, më të parrezikshmit; këtë nuk po e them ngase unë e vrava një qenie njerëzore; jo, por ngase jam sinqerisht e thellësisht i bindur. A është ndonjë qenie e rrezikshme? — E vret, e pat!. Unë këtë e quaj *aksion i mirë*. Merrni me mend sa është më keq për shoqërinë që ajo qenie e shtrydh edhe më tutje helmin e, në vend se ta likuidojë shoqëria, ajo do t'i kundërvihet veprave të saj duke përdorur çkamos, ligësi e ndyrësi të tjera të ngjashme. Sa më përket mua, dorën në zemër, tash më vjen keq që nuk e shfrytëzova më mirë kohën derisa isha në liri dhe nuk i vrava edhe gjashtë-shtatë tipa që i njoh.

Është e vërtetë se është e tepërt të pohosh se bota është e tmerrshme. Do të mjaftonte vetëm një bamuni për të pohuar atë, ja vetëm kjo: para ca kohësh pata lexuar se një pianist ish ankuar në një kamp përqëndrimi se ishte uritur, andaj e kishin detyruar ta hajë një mi xherizi, dhe atë *gjallë*.

Kjo nuk është, gjithsesi, gjëja për të cilën desha t'ju flas; nëse do të kem shteg, më vonë do të them diçka më shumë për atë mi xherizi.

II

Si thashë, quhem Huan Pablo Kasteli. Ndoshta do të pyeteni ç'më shtyri të shkruaj për krimin tim (nuk di a ju thashë se do të shkruaj për krimin tim), e, për më tepër se po kërkoj botues. E njoh aq mirë njeriun në shpirt sa e di, ç'më parë, se do t'ju shkojë ndërmend: skruta. Mendoni ç'të doni, aq më bën! Ka kohë që as nuk ma ndien për mendimin e njerëzve dhe për drejtësinë e tyre. Fundja, edhe unë jam prej mishit e gjakut, flokëve e thonjve si çdo njeri tjetër dhe, më duket, do të ishte shumë e padrejtë sikur të kërkonit prej meje, shi prej meje, të posedoj kualitete të posaçme. Ndokush beson ndonjëherë se është mbinjeri, madje edhe kur e heton se është i mjerë, i ndyrë e dyfytyrësh. Nuk po flas për skrutën: besoj se kjo nxitëse e rëndësishme e përparimit të njerëzimit, nuk i mungon askujt. Më bëjnë të qesh të gjithë ata zotërinj që stolisen me përvuajtëri të Ajnshtajnit e të njerëzve si ai. Përgjigjem: *E ka lehtë të jetë i përvuajtur ai që është i famshëm,* desha të them *të shtihet* i përvuajtur. Madje edhe kur pandehni se ajo nuk ekziston fare, e hetoni papritmas në formën e saj më të bukur: skruta e përvuajturisë. Sa e sa herë hasim njerëz të tillë? Edhe njeri, i vërtetë apo

simbolik, si Krishti, njeriu ndaj të cilit ndieja dhe ndiej edhe tash nderim të thellë, shqiptoi fjalët që i imponoheshin nga skruta, ose, tekefundit, krenaria. E ç'të themi për Leon Blumin, i cili mbrohej nga padia se është skrutar, duke pohuar se tërë jetën u shërbeu njerëzve që nuk i afrohen as deri te thembrat e këmbëve? Skrutë ka atje ku nuk presim të ketë (ku duhet të ketë më se paku): me mirësi, me vetëmohim, me zemërgjerësi. Kur kam qenë i vogël, tmerrohesha nga mendimi se nëna ime një ditë do të vdesë (njeriu me kohë arrin dijeninë se vdekja jo vetëm që durohet, por edhe ngushëllon) as që mendoja se nëna ime ka ndonjë të metë. Tash, që jam pa të, mund të them se ka qenë aq e mirë sa mund të jetë një qenie njerëzore. Por, më kujtohet, në vitet pak para vdekjes, sapo isha burrëruar, aq më shkaktonte në fillim dhembje në veprimet e saj më fisnike hetoja një fije të premisës së skrutës apo të krenarisë. Diçka më evidente më ndodhi mua vetë atëherë kur e patën bërë operacion nga kanceri. Për të arritur me kohë m'u desh të udhëtoj dy ditë të tëra pa shtjenë gjumë në sy. Kur iu afrova te shtrati, fytyra e saj prej mejti m'u çel në gaz me ëmbëlsi e me lëmonti. I ngatërroi ca fjalë të prekshme (asaj i erdhi keq që isha lodhur!). Ndërsa unë ndjeja ashtu pa qartë më vete krenari boshe që arrita aq shpejt. Po ua zbuloj këtë fshehtësi që të shihni sa e konsideroj veten më të mirë se të tjerët.

Ndërkaq, këtë rrëfim po e kallëzoj nga skruta. Ndoshta do të kisha qenë i gatshëm të pranoj se atë e përshkon ngapak mburrja apo krenaria. Mirëpo, ç'e do maninë që të gjurmohet shpjegimi për çdo sjellje në jetë? Kur zura ta kallëzoj këtë rrëfim, pata vendosur rrast që të mos jap shpjegim të kurrfarë lloji. Doja të flas vetëm për krimin tim, dhe pikë: kujt të mos i pëlqejë, mos ta lexojë. Ndonëse nuk besoj, sepse ata njerëz që kërkojnë gjithmonë shpjegime, janë në të vërtetë

nga më kureshtarët dhe, jam i bindur, se asnjëri prej tyre nuk do ta lërë rastin pa e lexuar deri në fund këtë tregim për një krim.

Mund t'i mbaja për vete arsyet që më shtyrën t'i shkruaj këto faqe të këtij rrëfimi: por, ngase nuk ma do të më konsiderojnë egocentrik, do ta them të vërtetën, e cila është gjithsesi krejt e thjeshtë: mendoja se tash që u bëra i famshëm këto faqe mund t'i lexojnë shumë njerëz; ndonëse nuk konsideroj se këto faqe janë kushedi se çka, megjithatë kam fare pak shpresë në njerëzit përgjithësisht, e posaçërisht lexuesit e këtyre faqeve — se do të më kuptojë ndonjë person. *Po ai, madje, qoftë një person i vetëm.*

Dikush do të pyetet, ndoshta, „pse vetëm një çik shpresë po qe se dorëshkrimin do ta lexojnë aq njerëz?" Këto farë pyetjesh i konsideroj të tepërta. E, megjithatë, duhet të parashihen, sepse njerëzit bëjnë vazhdimisht pyetje të padobishme, pyetje që edhe analiza më e përcipët i zbulon si të panevojshme. Do të kisha mund të bërtas e të flisja derisa të rraskapitesha para njëqind mijë rusësh të tubuar, askush nuk do të më kuptonte. Kuptoni, ç'dua të them?

Ekzistonte vetëm një person që mundi të më kuptojë. *Mirëpo, ai qe personi që e vrava.*

III

Të gjithë e dinë se unë e vrava Maria Iribarneo Hunterion, por askush nuk e di se e kam njohur, çfarë qenë në të vërtetë marrëdhëniet midis nesh dhe si më lindi ideja qi ta vras. Do të përpiqem të tregoj krejt ashtu si ngjau, sepse, njëmend, unë vuajta shumë me fajin e saj, por nuk kam pretendime gabërruese se edhe unë jam i përkryer.

Më 1946 ekspozova në sallonin pranveror pikturën e quajtur AMËSIA. Për nga stili ish si shumë piktura të tjera të mëhershme, si thonë kritikët në zhargonin e tyre të padurueshëm, ishte solide, me arkitekturë të mirë. Fundja, kishte atribute që këta sharlatanë i gjenin në pikturat e mia, duke përfshirë edhe atë „diçka e thellë intelektuale". Mirëpo, lart, në anën e majtë nëpër një dritarezë, shihej një skenë e vogël: plazhi vetmitar dhe gruaja që shikonte detin. Ish kjo grua, që shikonte detin, si të ishte duke pritur diçka, ndoshta grishje prej largësisë fare të papërcaktuar. Skena sugjeronte, sipas mendimit tim, vetminë e dëshiruar e të plotë.

Askush nuk ia vinte mendjen kësaj skene: shikimet rrëshqitnin përmbi si ndaj diçkasë sekondare, ndoshta dekorative; si duket, pos një

personi të vetëm, askush nuk e kuptonte se kjo skenë paraqiste diçka thelbësore. Iishte dita e hapjes së ekspozitës. Një vajzë e panjohur qëndronte para pikturës sime, as që i jepte, si dukej, rëndësi figurës së madhe të gruas në planin e parë, grua që shikonte fëmijën se si luante. Përkundër, shikonte me ngulmë skenën e dritarezës dhe, ndërsa vepronte kështu, isha i sigurt se ajo ishte ndarë nga tërë bota: as që i shihte, as që i dëgjonte njerëzit që kalonin ose ndaleshin para pikturës sime.

Tërë kohën e shikoja me dëshirim. Pastaj në turmë, ndërsa unë ndërdyshesha ndërmjet frikës së pazotërueshme dhe të dëshirës së flakët ta thërras. Frika nga çka? Ndoshta nga frika që të mos i humbas krejt paratë që i kisha në jetë duke i vënë në një numër të vetëm. Mirëpo, kur treti, isha i hidhur, i pafat ngase pandehja se nuk do ta shoh më, do të humbë ndër miliona banorë anonimë të Buenos Ajresit.

Atë mbrëmje u ktheva në shtëpi nervoz, i pakënaqur, i pikëlluar.

Derisa nuk u mbyll salloni, shkoja çdo ditë dhe ulesha mjaft afër pikturës që të mund t'i njihja personat që ndaleshin para pikturës sime. Mirëpo, ajo as që u duk më.

Muajve të ardhshëm mendjen e kisha vetëm tek ajo. Ishte kjo gjë asisoj sikur skena e vogël të kishte nisur të rritet e ta kishte zënë krejt pikturën dhe tërë punën time.

IV

Një ditë, më në fund, e pashë në rrugë. Ecte me hap të thekshëm trotuarit të dytë si çdo njeri që duhet të arrijë në vend dhe në kohë të caktuar.

E njoha menjëherë; do ta kisha njohur edhe në tollovinë më të madhe. Me kapi një tronditje që nuk përshkruhet. Aq më pat marrë mendjen për tërë ata muaj, sa çka nuk kisha marrë me mend, kurse tash që e pashë, s'dija çka të bëja.

Është e vërtetë se shpesh mendoja dhe planifikoja si do të mbahem në rast se e ndesh. Më bëhet se thashë se jam shumë i marrshëm; për këtë arsye mendoja vazhdimisht për këtë takim të mundshëm dhe mënyrën si do ta shfrytëzoj. Vështirësia më e madhe me të cilën kacafytesha në ato takime të imagjinuara, si të hyja në bisedë. Njoh shumë njerëz të cilëve nuk u duket aspak rëndë të zënë bisedë me ndonjë femër të panjohur. E pranoj se një kohë u kisha lakmi, sepse, ndonëse nuk kam qenë kurrë feminist, ose, për më saktë, pse nuk isha i tillë, nja dy-tri herë më pat ardhur keq (u pata prekur shumë) që nuk munda në ato raste të rralla të vë kontakt me atë vajzë kur mendoja se nuk do të jetë e

huaj në jetën time. Mjerisht, më është shkruar të jem dhe të mbetem i huaj në jetën e çdo femre.

Në ato takime të imagjinuara i analizoja mundësitë e ndryshme. E njoh vetveten dhe e di se në situata të papritura e të paparapara e humb orientimin për shkak të gabërrisë e të turpësisë sime. I përgatita disa variante që ishin logjike ose, të paktën, të mundshme. (Nuk është logjike që miku intim t'ju dërgojë dikë të panjohur që t'ju fyejë, por na e dimë të gjithë se është e mundur.)

Vajza e kishte zakon, sipas asaj që pashë, t'i vizitojë sallonet e pikturës. Nëse e gjej rastësisht në ndonjërin prej tyre, do t'i rri pranë dhe nuk do të jetë punë aq e ndërlikuar që të zë bisedë për ndonjë nga pikturat e ekspozuara.

Mbasi e shoshita në hollësi këtë mundësi, hoqa dorë nga ajo. *Unë nuk shkoja kurrë në sallonet e pikturës.* Mund të duket gjë fort e çuditshme për një piktor, por kjo gjë ka arsyen e vet. Dhe, jam i sigurt, nëse vendos ta shpjegoj, të gjithë do të më japin të drejtë. Mirë. Ndoshta po e teproj që po them *të gjithë.* Jo, *po e teproj sigurisht.* E di në saje të përvojës se çdo gjë që mua më duket e qartë dhe evidente, nuk u duket kurrë të tjerëve që më përngjajnë mua. Aq herë jam djegur, saqë tash, para se të zë ta arsyetoj ose ta shpjegoj veprimin, ndyrdyshëm dhe gati mbyllem gjithmonë më vete dhe nuk e hap derën. Këtu mbështetet arsyeja në të vërtetë që nuk u vendosa të ekspozoj krimin tim. Nuk e di, poashtu, se a ka kuptim që në këtë moment ta shpjegoj hollësisht mosinteresimin tim për sallone, paj druaj se do të pandehni, nëse e shpjegoj, se është për mes mani e thjeshtë, ndërsa për këtë gjë ekzistojnë në realitet arsye të thella.

Njëmend, për këtë gjë ekzistojnë shumë arsye. Dua të them, para së gjithash, se i urrej grupet, sektat, vëllezëritë, esnafët dhe përgjithësisht atë brofull insektesh që tubohen në vijën profesionale e edhe nga kënaqësia ose mani të

2 Tumoli
Nr. Inv. 1202
17
Nr. Inv. [illegible]
Inv. br. 12087

ngjashme. Këto përzierje të diçkasë e të gjithçkasë kanë veçori groteske: përtëritjen e llojit, zhargonin e vet, mendjemadhësinë se janë diçka më tepër se njerëzit e tjerë.

Po vëneroj se kjo çështje po ndërlikohet, por nuk e shoh edhe mundësinë që të thjeshtësohet. Më anë tjetër, ai që do ta ndërprejë këtu leximin e këtij tregimi, mund ta bëjë këtë menjëherë: e bëj me dije njëherë e përgjithmonë se do ta ketë lejen time absolute.

Ç'dua të them me këtë „përtëritja e llojit"? Ndoshta e keni vëneruar se sa është e pahijshme të haseni në dikë që shkrep orë e ças me sy ose e shtrembëron gojën. Po a mund t'i merrni me mend të gjithë këta tipa të mbledhur në një klub? Nuk ka as nevojë të merret ky ekstrem, mjafton, pa pikë dyshimi, të vënerohen ca familje te të cilat përsëriten tipare të caktuara, gjeste të caktuara, intonacione të caktuara të zërit. Më pat ndodhur të bie në dashuri me një grua (kuptohet, fshehurazi) e se ika i trazuar para mundësisë që t'i njoh motrat e saj. Në rastin tjetër më ndodhi diçka e tmerrshme: në një femër zbulova tipare tepër interesante, por kur e njoha motrën e saj, shumë kohë u ndjeva i turpëruar e i deprimuar; tiparet që më dukeshin tek ajo të mrekullueshme, tek e motra dukeshin tepër të theksuara e të deformuara, deri-diku të karikuara, por jo aq tepër; sikur të kishin qenë tepër të karikuara, kjo gjë *do të ishte krejt tjetër*, ndërsa kështu mjaftonin për të shkaktuar gazin. Edhe ky lloj i deformimit të pamjes së femrës në motrën e saj, më shkaktonte mua, përveç përshtypjeve të tjera, ndjenjë të turpërimit, si të isha edhe unë pjesërisht fajtor për shkak të dritës së tillë qesharake që e motra i hidhte së motrës të cilën e adhuroja aq shumë.

Ndoshta mua më duken ashtu gjërat, sepse jam piktor dhe se e kam vëneruar se njerëzit nuk u japin kurrfarë rëndësie këtyre deformimeve familjare. Duhet të shtoj se diçka e ngjashme po

më ndodh me ata piktorë që i imitojnë mjeshtrit e mëdhenj, si, për shembull, ata të mjerë që pikturojnë a la Pikaso. Madje, këtu hyn edhe zhargoni, karakteristika tjetër që nuk e duroj assesi. Mjafton të merret cilido shembull: psikoanaliza, komunizmi, fashizmi, periodizimi. Nuk e dua asnjërin, të gjithë më duken të urryer. Ta marrin shembull psikoanalizën që në këtë rast më ra në mend. Doktor Pratoja është bukur i talentuar dhe atë e konsideroja vërtet unik, deri në atë çast derisa nuk përjetova depremim të tmerrshëm, kur zënë të gjithë të më ndjekin, edhe ai iu bashkua asaj morie; por ta lëmë këtë. Një ditë, sapo kishte ardhur në ordinancë, Prato më tha se i duhej të dilte dhe më thirri të shkoj me të.

— Ku? — e pyeta.

— Në një koktej të Shoqërisë — m'u përgjegj.

— Të çfarë shoqërie? — e pyeta me ironi të padiktueshme, sepse më bën të tërknezëm mënyra si e përdorin ata fjalën e caktuar „Shoqëri" për „Shoqatë" e psikoanalistëve, „Partia" për Partinë Komuniste, „E shtata" për Simfonia e Shtatë të Bethovenit.

Më shikoi habitshëm, kurse unë i qëndrova shikimit të tij me shprehje naive.

— Shoqëria e psikoanalistëve, jahu — shtoi duke më shikuar thekshëm. E këtë shikim frojdistët e konsiderojnë të obligueshëm në profesionin e tyre e, duke më pyetur: ç'mahi po bën ky tash?

M'u kujtua se pata lexuar diçka për njëfarë tubimi ose kongresi, të cilin e kryesonte njëfarë doktor Bernari ose Bertrandi. I bindur se ajo nuk mund të jetë ajo, e pyeta a është ajo — ajo? Më shikoi buzagaz mënishëm.

— Ata janë sharlatanë — tha. — E vetmja shoqëri e pranuar në botë, është shoqëria jonë.

Prapë hyri në zyrën e vet, kërkoi diçka në një syzë dhe, në fund, ma tregoi një letër në anglishte. Ia hodha një shikim nga njerëzia.

— Unë nuk di anglisht — ia drodha.

— Kjo letër është prej Çikagos. Na njohin si shoqëri e vetme e psikoanalistëve në Argjentinë.

Bëra një shprehje të nderimit të thellë. ndërsa diku në tru m'u shfaq papritmas fytyra e njohur e Lav Trockit, me mjekërzën e tij. Më bëhet se kjo ndodhi për shkak se në shpirt m'u lidhen automatikisht me një Ortodoksi tjetër dhe Internacionale tjetër.

Pastaj dolëm dhe shkuam me automobilin e tij deri në atë lokal. Kishte shumë njerëz. Disa i njihja vetëm me emër, si Dr, Goldenbergun, i cili u bë kohët e fundit i njohur mbasi provojë ta mjekojë një grua e edhe atë edhe gruan i futen në çmendinë. Ai sapo kishte dalë në të vërtetë prej andej. E shikoja me kujdes, por nuk më dukej më keq se të tjerët; madje më dukej më i qetë. Ndoshta dukej kështu pse kishte qenë në burg. Pikturat e mia i lavdonte në atë mënyrë sa e kuptova se i përbuzte.

Ambienti ishte elegant sa më erdhi turp për shkak se i kisha rrobet e vjetra e pantallonat e pahekurosura. E kalova nje orë të tmerrshme. Më ra në sy diçka qesharake, edhe pse çdo gjë ishte rafinuese dhe elegante. Kur më shkoi për dore të dal në rrugë, isha tërbuar, e, po aq më vinte të qesh, posaçërisht që qesh prapë me njerëz të rëndomtë, njerëzve që shkonin në punë të veta, shitësve të gazetave, tregtarëve, policëve. Krejt këto e bënin të pabesueshme se në një vend, aty afër, ishin mbledhë njerëz të atillë, të mbyllur, që hanë senduiçe. Tërbimi erdhi e m'u shtua, sepse nuk munda ta gjej arsyen e indisponimit tim dhe për ç'arsye ky tubim ishte në thelb grotesk. Medje gati që nuk besova se e gjeta shkakun; kontrasti ndërmjet ambientit aq të pastërt (dyshemeja e glancuar, mobiljet e reja me shkëlqim, rrobet elegante, zonjusha magjepse) dhe, në të vërtetë, fjalor aq i ndyrë që përdoret me aq natyrësi. Në atë çast m'u kujtua se indisponimi im arriti kulmin kur një damë magjepse, ndërsa më ofroi pjatën me senduiç, i tha shkitas një kolegu:

— Në këtë ëndërr dominon simboli i fallusit.

U përpoqa të gjej një skutë të qetë, por lokali nuk ishte i madh, ndërkaq ishte stif me psikoanalistë dhe adhurues të tyre e mbasi ishte karakteristikë tjetër e kësaj sekte të flasë vetëm për marrëzitë e veta, në çdo kënd dëgjoheshin gjëra të njëjta.

Tekembramja, nga të gjitha tubimet, i urrej posaçërisht tubimet e piktorëve. Pjesërisht, kuptohet për arsye se i njoh më së miri, ndërkaq dihet se njeriu mund të urrejë me shumë arsye atë që e njeh anë e përtej. Kjo është diçka që nuk kam mund ta kuptoj kurrë. Sikur të kisha qenë kirurg i madh e sikur ndonjë zotëri, i cili nuk e ka pasur kurrë në dorë skalperin (thikën e kirurgjisë), që nuk është as mjek, e as që ia ka ndrequr, madje, këmbën e thyer macjes, të fillonte të m'i shpjegonte gabimet që i bëra gjatë operacionit, ç'do të mendonit ju? Po kështu është edhe me pikturën. Është gjë e pazakonshme që njerëzit nuk e vërejnë se kjo gjë është e njëjtë, e, madje, ndonëse qeshin me pretendimet e kritikut të kirurgjisë, i dëgjojnë me konsideratë të pabesueshme këta sharlatanë. Do të mund të dëgjohej ndonjëherë me një fije respekti mendimi i kritikut që është marrë dikur me pikturë, madje edhe me piktura mesatare? Edhe në atë rast, madje, kjo do të ishte absurde, sepse si mund të konsiderohet që një piktor mesatar t'i japë këshilla piktorit të mirë!

V

Drodha nga rruga. Kjo rrjedh nga ajo shprehi e mallkuar që ta përligj çdo veprim timin. Për ç'dreq të shpjegoi pse nuk shkoj në sallonet e pikturës? Jam i mendimit se gjithkush ka të drejtë të shkojë apo të mos shkojë, nëse ka dëshirë të paraqesë pa nevojë raport të gjerë përgjërues. Përndryshe, ku do të dilnim me ekstravagancë të ngjashme? Mirëpo, fundja, këtë e bëra, ndonëse do të detyrohem të them edhe çkamos për ekpozitat: përgojimet e kolegëve, verbërinë e publikut, gabërrinë e atyre që kanë për detyrë t'i përgatisin sallonet e të bëjnë renditjen e pikturave. Për fat (ose mjerisht), kjo gjë nuk më interesón më: përndryshe do të kisha shkruar, ndoshta, një ese më të gjatë me titull: *Mënyra si duhet të mbrohet piktori prej dashamirëve të pikturës.*

Pra, u desh t'i jap përparësi mundësisë se atë do ta gjej në ndonjë ekspozitë.

Mund të ndodhë edhe që ajo të ketë ndonjë mik, i cili është njëkohësisht edhe miku im; në atë rast, do të mjaftonte vetëm një prezentim i rëndomtë. I përfshirë nga ndjenja e pakëndshme e turpërimit, i rashë me kënaqësi në dorë kësaj mundësie. Një prezentim i rëndomtë! Si u bë

krejt kjo gjë e lehtë, aq e këndshme? Ky pushtim më pengoi që ta shoh menjëherë sa është absurd supozimi i ngjashëm. Nuk më shkoi poashtu mendja se ishte poashtu vështirë ta gjeja ndonjë mik të saj sa ta gjeja atë vetë, sepse është në mënyrë fare të qartë e pamundur ta gjeja ndonjë mik të saj, ndërsa nuk e dija kush është ajo. Mirëpo, sikur ta dija kush është ajo, pse atëherë të mbështetesha në dikë të tretë? Më mbeti, kuptohet, një përparësi e vogël e supozimit, të cilën nuk e nënçmoja. Por, është e qartë, problemi themelor ishte ta gjej atë, e, *pastaj*, ta kërkoja gjithsesi ndonjë mik tonin të përbashkët që do të na prezentojë.

Ishte edhe një rrugë tjetër, e anasjellët: të shoh a ishte ndonjë mik imi edhe miku i saj. E që të mund ta bëja këtë para se ta gjeja, do të mjaftonte ta pyetja ndonjë të njohur timin për një vajzë me të hollë të tillë e flokë të tilla e të tilla. Krejt kjo më dukej e parealizueshme, ashtu që e lashë fare pas dore. Më erdhi turp nga mejtimi që pyetje të tilla t'u bëja njerëzve siç ishin Mapeli ose Lartigo.

Mendoj, duhet të konstatoj, se këtë variant nuk e hodha poshtë, pse është jo e arsyeshme, këtë e bëra i shtyr nga arsyeja që, në të vërtetë, e parashtrova. Ndokush mund të besonte se është jo aq me arsye të merrem me mend posibilitete aq të hamendshme që ndonjë i njohur i imi të jetë edhe njëkohësisht edhe i njohur i saj. Ndoshta kjo mund t'i duket ndonjë zemërngushti, por jo edhe atij që është i prirur të merret me problemet njerëzore. Në shoqëri ekzistojnë *shtresa horizontale* që përbëhen nga persona me shije të njëjta dhe në këto shtresa pjekjet e rastit nuk janë të rralla, për më tepër kur këto shtresa i formojnë njerëzit që janë në pakicë. Më ka ndodhur që ta takojë një person të njëjtë në një skaj të Berlinit, mandej edhe në ndonjë vend të vogël, gati të panjohur të Italisë dhe, më në fund, në një librari të Buenos Airesit. A është e arsyeshme

që krejt këto takime të njëpasnjëshme t'i mvishen rastit? Oh! po flas dokrra: këtë e di çdo dashamir i muzikës, i esperantos, i spiritizmit.

Pra, u shtrëngova të kapen për mundësinë së cilës i drashta më së shumti. Ç'bëjnë, ta hajë dreqi, ca meshkuj kur duan t'i afrohen një femre për të zënë bisedë, madje edhe të hidhen në aventurë? Aty për aty e hodha poshtë çdo kombinim që do të fillonte me inisiativën time; sepse vetë dija ime e teknikës së rrugës dhe dukja ime më shtyrën të marr këtë vendim definitiv melankolik.

Nuk më mbeti tjetër pos të pres atë rast fatlum që shfaqet një herë në miliona herë që ajo të më drejtohet e para. Dhe, fati im ishte, në këtë mënyrë, deponim në një llotari të hamendshme, në të cilën duhej të fitoja një herë për të fituar gjasët të luaja përsëri, që të fitoja mandej preminë në rast se fitoj në tërheqjen e dytë. Duhej, pra, t'i jepja shteg vetes ta ndesh atë në rrugë e, pastaj, rast edhe më të vogël të mundshëm — që ajo të më drejtohet. Ndjeja njëfarë marrëmendjeje, pikëllimi dhe dekurajimi. Mirëpo, përgatitesha, megjithatë, edhe mëtutje për veprim të këtillë.

Merrja me mend, pra, që ajo të më drejtohet, për shembull, duke pyetur për ndonjë adresë ose ndonjë autobus, e, duke më prirë një fjali e tillë prirëse, muaj të tërë u bufata me persiatje, melankoli, tërbim, ndiesi të braktisjes dhe shprese, ndërtova një targ të pafund variantesh. Në njërin isha fjalaman, llafazan, (kurrë nuk kam qenë në të vërtetë); në tjetrin isha i matur; në të tjerat i buzëqeshur. Hera-herë u përgjigjesha rreptë pyetjeve të saj (gjë që ishte përjashtim), madje isha e përmbahesha në hidhërim; ndodhi (në njërin nga këto takime të imagjinuara) që biseda u ndërpre për shkak të zemërimit tim absurd, sepse ia zura panjerëzisht për të madhe një pyetje, të cilën e konsideroja të pavend e të pamatur. Këto takime të pasukseshme më mbushnin me indinjatë dhe, ditë të tëra e qortoja veten që, për

shkak të gabërrisë sime, e humba edhe atë posibilitet aq të largët që të vë kontakt me te. Për fat, krejt kjo përfundonte me aq, ngase e shihja se krejt këto ishin të imagjinuara dhe, për më tepër, më mbetej posibiliteti i njëmendtë. Pastaj zura të përgatitesha me më shumë entuziazëm dhe të merrja me mend dialogje të reja, më të suksesshme për në rrugë. Vështirësia mbështetej kryesisht në atë: në ç'mënyrë t'i lidh pyetjet e saj me diçka aq të përgjithshme e të largët nga preokupimet e përditshme siç është thelbi i përgjithshëm i artit ose, tekefundit, ç'mbresë i la dritareza ime? Nëse ke, natyrisht, kohë e rahati, gjërat e këtilla mund t'i vësh, pa i bërë ato aspak përngut, logjikisht në lidhje; në ndonjë tubim shoqëror ke mjaft e sa të duash kohë dhe etje mund të vësh në njëfarë mënyre lidhje ndërmjet temash krejtësisht të ndryshme; mirëpo, në tollovi të ndonjë rruge të Buenos Airesit, ndërmjet njerëzve që ngarendin dhe e shtyjnë njeriun përpara, është qartë se është dashur ta hedh poshtë mundësinë e bisedës si tillë .Por, në anë tjetër, nuk mund ta hedhja poshtë pa rrezik që fatin tim ta vë në pozitë të palakmueshme. Pra, fillova prapë t'i marr me mend dialogjet, ata më efikas e më të shpejtë, të cilët do të fillonin me fjalinë" „Ku është rruga kryesore"? dhe do ta vazhdoja për ca probleme të ekspresionizmit ose surealizmit. Kjo gjë nuk ishte aspak e lehtë.

Një nate pa gjumë nxora përfundim se është e padobishme dhe artificiale të filloja me biseda të tilla dhe se duhet t'i bie trup e shkurt, me një pyetje të guximshme, duke vënë krejt si në kumar. Të pyes, për shembull: „Pse e shikonit vetëm dritarezën"? Dihet se netëve pa gjumë lindin më shumë mundësi teorike sesa gjatë ditës, në realitet. Ditën tjetër, kur e analizova me gjakftohtësi këtë mundësi, nxora përfundim se do të më mungojë vazhdimisht guximi që ta bëj befas këtë pyetje. Dekurajimi më hodh, si gjithmonë, në ekstremitetin tjetër: atëherë e trillova një pyetje aq

të tërthortë, cila, për të arritur atë që më interesonte (dritareza), kërkohej gati miqësi e gjatë, pyetja si: „A ju intereson arti"?

Nuk më kujtohen më të gjitha variantet për të cilat e pata vrarë aq mendjen. Vetëm më kujtohet se ca variante qenë aq të ndërlikuara saqë, praktikisht, qenë të papërdorshme. Do të ishte mrekulli sikur realiteti të koicidonte me çelësin fort të komplikuar, i goditur pa e ditur se ç'formë ka brava. Por, ndoshta, duke shqyrtuar të gjitha ato mundësi, e harroja rendin e pyetjeve e të përgjegjeve, ose i ngatërroja, ashtu si ndodh në kombinimet e partisë së shahut. Më ndodhte shpesh të ndërtoj fjalinë e një varianti me fjalinë e variantit tjetër, andaj ajo dilte qesharake ose dekurajuese. Do të ishte groteske, për shembull, sikur ta ndal dhe ta pyes papritmas: „A ju intereson shum arti"?

Kur vija në situata të tilla, pushoja disa ditë nga pupuritja e kombinimeve.

VI

Kur e pashë, duke ecur në trotuarin e dytë, të gjitha variantet m'u ngatërruan në tru: ndjeja me hutim se në vetëdije më ajgtoheshin fjali të tëra, të cilat i kisha përgatitur dhe i kisha mësuar në ato ushtrimet e gjata përgatitore: „A ju intereson shumë arti"? „Pse e shikuat vetëm dritarezën"? e kështu me radhë. Më shumë se të gjitha fjalitë e tjera, më imponohej fjalia që e kisha hedhur poshtë, sepse ishte banale dhe, në këtë moment, më përmbushi me turp e më bënte të ndihem edhe më qesharak: „A ju pëlqen Kasteli"?

Ndërsa nuk e kuptova se është e padobishme ta mundoja veten me ato fjali të lira e të parenditura që krijonin rebus të ngatërrueshëm: m'u kujtua se ajo duhet të marrë inisiativën për çfarëdo bisede. Dhe, prej atij çasti, isha aq marrëzisht i qetë, madje pandeh se më shkoi ndërmend, natyrisht, prapë marrëzi: „Aha, tash do të shohim si do t'ia dalë ajo"?

Ndërkaq, përkundër këtij mendimi, isha aq nervoz dhe i trazuar saqë nuk munda të bëj asgjë pos t'i vihem, pas nëpër trotuar përballë, pa e vrarë aspak mendjen — se a doja t'i jap edhe gjasën më të vogël që të më pyesë për ndonjë adresë — se do të duhej të kaloja në anën tjetër të

trotuarit dhe t'i afrohem. Sa ishte, në të vërtetë, qesharake të merrej me mend se ajo do të bërtasë prej asaj ane dhe do të më pyesë për ndonjë adresë!

Ç' të bëj? Deri kur do të zgjasë kjo situatë? Ndihesha krejtësisht i pafat. I kaluam kështu disa bërryla rrugësh, kurse ajo ecte edhe mëtutje preraz përpara.

Isha tepër i pikëlluar, por nuk munda pa shkuar deri në fund: mbasi i pata pritur me muaj këto çaste e, nuk qe assesi e mundur deri tash, si ta lëshoja këtë shteg? Ndërsa ndërdyshesha në shpirt,hapi i shpejt më përftonte një ndjenjë të posaçme: mendimi m'u bë si krimb i verbër dhe i ngathët në automobilin e shpejtë.

U kthye në bërrylin e Rrugës Shën Martini, i bëri edhe ca hapa dhe hyri në ndërtesën e Kompanisë T. E kuptova se duhet të marr shpejt vendim dhe hyra pas saj, ndonëse në atë moment ndjeja se po bëj diçka të papëlqyeshme dhe çuditëritëse.

Priste ashensorin. Nuk ishte askush pos saj. Ajo pjesë më e guximshme e personit tim nxori nga unë këtë pyetje të pabesueshme gabërruese.

— A është kjo ndërtesa e Kompanisë T.?

Mbishkrimi i gjatë disa metra, i cili e përfshinte tërë ballin e ndërtesës, tregonte se kjo është ndërtesa e Kompanisë T.

Ndërkaq, ajo u kthye natyrshëm dhe pohoi me krye. (Më vonë duke menduar për këtë pyetje dhe për mënyrën si u përgjegj ajo natyrshëm e qetas, nxora përfundim se ndodh shpesh që njeriu të mos i vërejë mbishkrimet e mëdha dhe se pyetja, për këtë arsye, nuk duket aq gabërruese si mendoja në çastin e parë).

Dhe, fill pastaj, mbasi më shikoi, u skuq, gja që e shpjegova si shenjë se më njohti. Varianti që nuk e kam shqyrtuar kurrë, e, pa pikë dyshimi, i logjikshëm, sepse fotografia ime delte shpesh në revista e gazeta.

Aq isha shqetësuar sa ia dola të përflak pyetjen tjetër të paqëlluar: i thashë shpejt:

— Pse po skuqeni?

U skuq edhe më tepër dhe deshi, ndoshta, të më përgjigjet diçka, mirëpo, mbasi unë e kisha humbur krejt torruan, shtova shpejt:

— U skuqet për arsye se më njohet Edhe ju mendoni se kjo është rastësi, por nuk është rastësi; nuk ka rastësi. Muaj të tërë e kam mëndjen te ju. Duhet t'ju pyes diçka me rëndësi, diçka përkitazi me dritarezën. Kuptoni?

Ajo si të ishte frikësuar.

— Dritarezën? — nënëriti? — Çfarë dritareze?

Hetova se këmbët nuk më mbanin. A është e mundur që nuk po i kujtohet? Atëherë, pra, nuk i paska kushtuar kurrfarë rëndësie dhe e paska shikuar nga kërshëria e zakonshme. Hetova se u bëra qesharak dhe më shkrepi vetëtimthi mendimi se krejt çka bëra dhe punova gjatë këtyre muajve (duke e përfshirë edhe këtë skenë) ishte kulminacion i disharmonisë dhe qesharakes, një nga ato konstruksione tipike të trilluara, aq arbitrare si kur të bëhet rikonstruktimi i dinosaurusit në mbështetje të një unazeje të thyer.

Vajza gati që nuk shpërtheu në vaj. Kisha përshtypjen se m'u shemb tërë bota e, këtej, nuk më binte në mend asgjë qetësuese dhe efikase. E zura veten duke folur diçka që tash më vjen turp ta shkruaj.

— Po shoh se u mashtrova. Mirupafshim! — Dola shpejt dhe u nisa gati me vrap pa ia vënë mendjen drejtimit që mora. Eca kështu gati deri te bërryli i parë, kur dëgjova zërin që thërriste:

— Zotëri, zotëri!

Ishte ajo. Më ishte vënë pas, por i kishte munguar guximi të më ndalë. Rrinte pranë dhe nuk dinte si ta arsyetojë atë që ndodhi. Më tha me zë të ulët:

— Më falni, zotëri ... Më falni për gabërrinë time ... Qesh aq e frikësuar ...

Bota qe para disa çastesh kaos i gjësendeve dhe i qenieve të padobishme. E hetova se tash po rregullohet përsëri dhe u nënshtrohej ligjësive. E dëgjoja pa bërë ver me gojë.

— Nuk kuptova se po pyetni për skenën e pikturës — tha me zë të dridhshëm.

E kapa për dore, madje as që e hetova.

— Do të thotë, pra, ju kujtohet?

Heshti për një çast, ndërsa shikimin nuk e çoi. Pastaj shtoi ngadalë:

— Më kujtohet vazhdimisht.

Mandej ndodhi diçka e çuditshme: duket se u frikësua nga ajo që tha, u kthye dhe gati se ia dha vrapit. Mbas një çasti befasie, iu vura pas, derisa nuk e kuptova se ishte gjë qesharake; pastaj u ktheva djathtas — majtas dhe vazhdova rrugën me hap të shpejtë, por normal. Ky vendim qe i determinuar nga dy anë të pandehjes: e para, se është bukur qesharake që një njeri i njohur t'i vihet pas në vrap një vajze; e dyta, *nuk kishte nevojë*. Kjo e fundit ishte më e rëndësishme: mund ta shihja në çdo kohë, duke hyrë ose duke dalë prej zyrës. Pas të vrapoja si i marrë? Ajo ç'është të me rëndësi, që është njëmend me rëndësi se i kujtohej skena nga piktura: „i kujtohej vazhdimisht". Isha i kënaqur, më bëri të aftë për gjëra të mëdha dhe vetëm e qortoja veten që e humba kontrollin para ashensorit dhe, tash përsëri, që ngarenda pas saj si ndonjë i marrë, ndonëse ishte e qartë se mund ta shihja çdo çast në zyrë.

VII

Në zyrë? — pyeta veten menjëherë me zë, thuaja, duke britur e, këtej, hetoja se po më lëshojnë këmbët. Por, kush më tha se punonte në atë zyrë? Pse a mos hyjnë në një zyrë vetëm njerëzit që punojnë aty? Duke pandehur se do ta humb për disa muaj ose, ndoshta, përgjithmonë, m'u morën ment e, pa e përfillur rregullin, u dhashë këmbëve si dëshpërimtari. Fill e shpejt u gjenda para dyerve të Kompanisë T. Mirëpo, ajo nuk ishte askund. Ndoshta ishte ngjitur me ashensor? Desha ta pyes liftbojin, por në ç'mënyrë t'ia bëj pyetjen? Ndoshta ishin ngjitur shumë femra dhe, në atë rast, ishte dashur t'ia përshkruaj detajisht; ç'do të mendonte liftboji? Eca një çast ndërdyzash nëpër trotuar. Mandej kalova në trotuarin përballë dhe e vështroja ndërtesën nga balli — e as vetë nuk e di pse. Ndoshta në ndërdije shpresoja se do ta shoh vajzën që do të duket në dritare. Ndërkaq, ishte krejt absurde të mendoj se mund të dukej në dritare që të më japë shenjë ose të bëjë diçka kësisoj. Më ra në sy një mbishkrim tjetër tepër i madh, në të cilin shkruante *Kompania* T ..

Për sa m'u duk me sy mbishkrimi, ai kapte nja njëzet metra të ballit të ndërtesës. Dhe ky

çmim ma shtoi indisponimin. Mirëpo, tash nuk kisha kohë t'ia vë mendjen këtij indisponimi: do ta mundoj veten pak më vonë, ashtu ngadalë. Në atë çast nuk shihja shtegdalje tjetër pos të hyj. U rrasa energjikisht në ndërtesë dhe prita derisa nuk zbriti ashensori; por, derisa zbriti ai, vënerova se vendosmëria ime vinte e zvogëlohej me shpejtësi të njëjtë, me të cilën me rritej turpërimi. Kështu që, kur u hapën dyert e ashensorit, kisha vendosur ç'të bëj: *që të mos them asnjë fjalë të vetme*. Por, në atë çast, është e qartë, pse të hyja në ashensor? Nuk merrte bojë të mos hyja në ashensor, pas pritjes evidente në prani të aq shumë personave. Si do të shpjegohej sjellja e tillë? Nuk kisha zgjidhje tjetër pos të hyja në ashensor, kuptohet, duke iu përmbajtur pikëpamjes sime *që të mos them asnjë fjalë të vetme*. Ishte gjë plotësisht e sendërtueshme, madje edhe më normale se e kundërta: rëndom askush nuk flet në ashensor, përveç kur e ka mik liftbojin, në ç'rast është plotësisht e natyrshme që të pyesë për kohën ose djalin e sëmurë. Mirëpo, mbasi nuk kisha kurrfarë lidhjeje me të dhe, deri në këtë çast, nuk e kisha parë njëmend kurrë atë njeri, vendimi im që të mos e çel gojën, nuk mund të shkaktonte as komplikimin më të vogël. Vetë fakti se ishin më shumë persona, përpjekja bëhej edhe më e lehtë, sepse askush nuk e vëneronte.

Hyra krejt i qetë në ashensor dhe krejt kaloi si e parashikova, pa kurrfarë vështirësish, dikush fliste me liftbojin për zapullinë plot lagështi dhe kjo bisedë ndikoi që të ndihem mirë, sepse i vërtetonte supozimet e mia. Ndjeva një nervozitet të lehtë kur thashë „i teti", por këtë mund ta diktonte vetëm dikush që e dinte qëllimin nga synoja në atë çast.

Mbasi u ngjita në katin e tetë, pashë se edhe një person po del me mua, gjë që e komplikonte ngapak situatën; ecja ngadalë duke pritur që ai tjetri të hyjë në ndonjë zyrë, e unë të pres edhe

më tutje në mesore. Atëherë mora lehtë frymë; i rashë korridorit, dola deri te skaji tjetër, shikova nëpër një dritare panoramën e Buenos Airesit, u ktheva e pastaj drejt në ashensor. Fill e shpejt u gjenda te dera e ndërtesës dhe nuk ndodhi asfarë skene e papëlqyeshme nga e cila drashta (pyetjet e pazakonshme të liftbojit e të tjera kësodore), Nxora cigaren dhe ende pa e ndezur, hetova se fasha ime ishte bukur absurde: me taman se nuk ndodhi asgjë e pakëndshme, por ishte poashtu e qartë se *nuk ndodhi absolutisht asgjë*. Me fjalë të tjera, të zakonshme: vajza kishte tretur, përveq se, nëse kishte qenë vazhdimisht e zënë në këto zyre, sepse, po qe se hyri vetëm të kryejë ndonjë punë, do të jetë ngjitur e do të ketë zbritur dhe nuk u pa me mua. Më shkoi mendja se është poashtu e mundur, nëse hyri me farë pune, nuk do ta ketë kryer aq shpejt. Ky mendim më inkurajoi prapë, mandej vazhdova të pres para ndërtesës.

Prita një orë të tërë pa rezultat. Analizova mundësi të ndryshme:

1. Do të ketë pasur punë tepër të madhe, në atë rast duhej ta pritja edhe mëtytje.

2. Është e sigurt, pas asaj që ndodhi, ishte tepër e shqetësuar dhe do të ketë shkuar sigurisht të shëtisë para se të shkojë të kryejë punë; duhej poashtu ta pritja.

3. Punonte aty; në atë rast duhej ta pritja deri në mbarim të orarit të punës.

Pra, duke pritur në atë moment, u ballafaqova me dy mundësi:

Ky rezonim m'u duk shumë logjik dhe më qetësoi bukur shumë, kështu që vendosa të pres *shtruar* në kafene te bërryli i rrugës, nga trotoari i së cilës do t'i shihja njerëzit kur të dalin. Porosita birrë dhe shikova orën: ishte tre e një çerek.

Sa më shumë që koha kalonte, aq më shumë bindesha se supozimi i tretë është i saktë: ajo punonte atje. Në gjashtë u çova, sepse m'u bë se

është më mirë të pres te dera e ndërtesës: sigurisht dalin shumë njerëz menjëherë dhe është e mundur që të mos e shoh prej kafenesë.

Në gjashtë e disa minuta nëpunësit filluan të dalin.

Në gjashtë e gjysmë dolën gati të gjithë, e këtë e konstatova mbasi më vonë dilnin shumë më rrallë. Në shtatë pa një çerek askush nuk doli më: vetëm, kohë pas kohe, ndonjë funksionar i lartë, pos nëse është edhe ajo ndonjë funksionare e lartë (më tha mendja „absurditet") ose sekretareshë e ndonjë funksionari të lartë (kjo „po", më tha mendja me një fije shprese).

Në shtatë ishte krejt gati.

VIII

Ndërsa kthehesha tejet i molisur në shtëpi, përpiqesha të mendoj sa më kthjellët. Kryet më vlonte, mirëpo kur jam nervoz, mendimet nuk e presin njëri-tjetrin si në balet marramendës; përkundër kësaj ose, ndoshta, për shkak të saj, u mësova t'i zotëroj dhe t'i vë në rend; përndryshe, sikur të mos ishte kështu, mendoj se do të isha çmendur.

Si thashë, u ktheva në shtëpi tejet i molisur, por për atë shkak nuk lashë pa i vërë në rend, pa i klasifikuar mendimet, sepse e hetova se është e nevojshme të mendoj sa më kthjellët, nëse dua që të mos e humb personen, e cila, ishte evidente, e kuptonte pikturën time.

Ose hyri në zyrë të kryejë ndonjë punë ose punonte atje; mundësi tjetër nuk kishte. Natyrisht, kjo e fundit ishte mundësia më e volitshme. Në atë rast, mbasi u nda prej meje, dorëmënjë hetoi se ishte hutuar dhe kish vendosur të kthehet në shtëpi. Pra, duhej ta pritja ditën tjetër të hyrja e ndërtesës.

Pastaj e analizova mundësinë tjetër: punën. Ndoshta ndodhi që, e hutuar nga takimi, u kthye në shtëpi dhe e la punën për ditën tjetër. Edhe në atë rast duhej ta pritja te hyrja.

Këto ishin mundësi të volitshme. E treta ishte e tmerrshme: ajo e kreu punën ndërsa unë hyra në ndërtesë dhe gjatë aventurës sime në të hyrë dhe të dalë nga ashensori! Domethënë, u ndërvojtem dhe nuk u pamë. I tërë ky veprim ishte shumë i shkurtër dhe është e pabesueshme që ndodhi krejt ashtu, por ishte e mundur: mund të ndodhë që, për shembull, i është dashur ta dorëzojë ndonjë letër. Në atë rast, konsideroja, është e padobishme ta pres ditën tjetër.

Ekzistonin, pa dyshim, dy mundësi të volitshme në të cilat u mbështeta me dëshpërim.

Mbërrijta në shtëpi me një ndiesi të çuditshme. Në një anë kurdo që më binte në mend fjalia që më tha („Më kujtohet vazhdimisht", ZEMRA MË RRIHTE fort dhe ndjeja se po më hapet perspektivë e errët, por e hapet dhe e fuqishme; ndjeja se një fuqi e madhe, deri në atë çast e fjetur, donte të shpërthejë me hov në veten time. Në anë tjetër, merrja me mend se mund të kalonte shumë kohë para se ta gjej përsëri. Disaherë e zura veten duke folur me zë: „Duhet, duhet"

IX

Ditën tjetër, heret, qëndroja para derës së hyrjes të Kompanisë T.. Hynë të gjithë nëpunësit, por ajo nuk u duk: ishte e qartë se nuk punonte aty, edhe pse mbetej edhe më tutje supozimi i dobët se do të jetë sëmurë dhe se disa ditë nuk do të vinte në zyrë.

Përveç kësaj, mbeti mundësia e kryerjes së punëve, ashtu që vendosa tërë paraditën të pres në kafene para bërrylit të rrugës.

Sa kisha humbur shpresën (ishte rreth njëmbëdhjetë e gjysmë) kur e pashë duke dalë nga metroja. Kërceva tmerrësisht i trazuar nga karrigeja dhe u nisa t'i dalë përpara. Kur më pa, u ndal si të ishte ngurruar aty për aty: ishte evidente se nuk e kishte pritur takimin kësisoj. Ishte e pabesueshme se ndjenja, që mendimet i kisha të qëndrueshme si hakuri, më përmbushte me energji të parëndomtë. Ndihesha i fortë, isha plot vendosmëri burrërore dhe i gatshëm për gjithçka. Kështu që e kapa gati me vrazhdësi për dore dhe e tërhoqa teposhtë Rrugës Shën Martini në drejtim të Sheshit. Dukej si të mos ishte në qejf, nuk më tha asnjë fjalë të vetme.

Mbasi kaluam një apo dy bërryla rrugësh më pyeti:

— Ku po më çoni?

— Në Sheshin Shën Martini. Kam shumë të bisedoj me ju, — iu përgjigja, ecja i vendosur duke e tërhequr edhe më tutje për dore.

Nënëriti diçka përkitazi me zyrë të Kompanisë T ., por unë e tërhiqja dhe as që dëgjova çka foli.

Shtova:

— Duhet të flas me ju për shumë gjëra,

Nuk kundërshtoi: kurse unë ndihesha si lumi i vërshuar që bart një degë. Mbërrijtëm në Shesh dhe unë kërkova një bankë të lirë.

— Pse iket? — ishte gjëja e parë që e pyeta. Më shikoi po me atë shprehje që e vënerova një ditë më parë, kur më tha: „Më kujtohet vazhdimisht", ishte ky shikim i çuditshëm i epur, i depërtueshëm, dukej si të buronte nga thellësitë: ky shikim më kujtonte diçka, një palë sy asisoj, por nuk më kujtohej ku i kisha parë.

— Nuk e di — u përgjigj më në fund. — Tash, poashtu, kisha dashur të ik.

Ia shtrëngova dorën

— Më premtoni se nuk do të ikni më kurrë, Kam nevojë për ju, më duheni shumë — i thashë.

Prapë më shikoi si të më përgjonte, por nuk tha asgjë. Pastaj ia nguli sytë një peme diku në largësi.

Nga profili nuk më kujtonte asgjë. Fytyrën e kishte për bukuri, por me një shprehje të krodhët. Flokët i kishte të gjatë të gështenjtë. Fizikisht nuk dukej se ishte më shumë se njëzet e gjashtë vjeçe, por kishte diçka më vete që i tregonte vitet e saja të vërteta, diçka tipike për një femër që kishte jetuar tepër; nuk ishin flokët e thinjura ose farë shenje thjesht materiale, por diçka e pacaktuar dhe sigurisht spirituale: ndoshta shikimi, por deri në ç'masë mund të thuhet se shikimi i qenieve njerëzore është diçka fizike?; ndoshta mënyra si i rrudhte buzët, më pastaj, nëse janë goja dhe buzët elemente fizike, mënyra në të cilën shtrëngohet ca rrudha janë, poashtu,

elemente fizike. Nuk munda të konstatoj në atë moment, e, nuk munda ta konstatoj atë as tash, çka është ajo, më në fund, që linte këtë përshtypje për vitet. Mendoj se mund të jetë kjo mënyra si fliste.

— Më duheni shumë — përsërita.

Nuk u përgjigj dhe shikonte edhe më tutje pemën.

— Pse nuk po flisni — e pyeta.

Pa ia ndarë sytë pemës, përgjegji:

— Unë nuk jam askush, kurse ju jeni artist i madh. Nuk po shoh për çka ju duhem aq shumë.

Brita:

— Po ju them se më duheni! Më kuptoni!

Duke e shikuar edhe matutje pemën, pëshpëriti:

— Për çka?

Nuk iu përgjigja menjëherë. Ia lëshova dorën dhe treta në mendime, Njëmend, për çka? Deri në atë moment nuk ia kam shtruar vetes qartë këtë pyetje dhe, thënë më saktë, ndjeva diçka, diçka asisoj si instikti. Me një shkop nisa të vizatoj figura gjeometrike në tokë.

— Nuk e di — nënëriti pas një çasti — ende nuk e di.

E vritja mendjen intensivisht dhe me shkop i komplikoja përherë e më shumë vizatimet.

— Kryet e kam labirinth të errët. Hera-herë si të shkrepëtinte vetëtima dhe i ndriste ca mesore. Kurrë nuk kuptoj pse i bëj disa gjëra, Jo, nuk është ajo ...

Ndihesha mjaft gabërrueshëm; kjo nuk ishte assesi mënyra ime. U zhyta thellë në mendime: ndoshta nuk mendoja. Përkundrazi, truri më vlonte nga të menduarit, si makinë llogaritëse, për shembull, në këtë rrëfim, pse a nuk mendova me muaj dhe i pupurita supozimet dhe i klasifikova? Dhe, a nuk e gjeta, më në fund, në njëfarë mënyre Marinë në saje të aftësisë sime të të men-

duarit logjik? E hetova se jam afër të së vërtetës, shumë afër, ndërsa frikohesha mos po e humbas, u mundova. Brita:

— Kjo nuk është për arsye se nuk di të mendoj! Përkundrazi, mendoj pandërprerje. Mirëpo, merrni me mend kapitenin e anijes, i cili, e cakton në çdo moment, matematikisht pozitën e anijes dhe e mban drejtimin kah caku me rigorozitet të pamposhtur, por që *nuk e di pse shkon kah ai cak,* po më kuptoni?

Për një çast më shikoi habitshëm e pastaj ia lëshoi prapë sytë pemës.

— Po ndiej se ju do të jeni diçka thelbore për atë që duhet të bëj, edhe pse nuk e di ende arsyen.

Prapë nisa të vizatoj me shkop dhe thellohesha edhe më tutje mendrisht. Pas një copë kohe, shtova;

Tash për tash e di se diçka ka të bëjë me skenën e dritarezës: ju jeni personi i vetëm për të cilin qe ajo me rëndësi.

— Unë nuk jam kritik i artit — nënëriti.

U tërbova dhe brita:

— Mos më flisni për ata kretenë!

Pa pritur u kthye. Unë pastaj e ula zërin dhe i shpjegova pse nuk kam besim në kritikët e artit: fundja, teoria për thikën e kirurgjisë e krejt të tjerat.

Më dëgjonte, por nuk më shikoi. Ndërsa, kur e kreva fjalën, tha:

— Ju po ankoheni, kurse kritikët ju kanë lavdëruar gjithmonë.

U hidhërova.

— Aq më keq për mua! Nuk po kuptoni! Kjo është ndër gjërat që më indinjon dhe që më dha shkas të mendoj se po ndjek rrugë të keqe:: mund të merrni me mend, për shembull, s'ndodhi në atë sallon: asnjëri nga ata sharlatanë nuk e vëneroi rëndësinë e asaj skene. Ishte vetëm një person për të cilin qe ajo skenë e rëndësishme. E ju nuk jeni kritik. Jo, është vërtet edhe një

person që i dha njëfarë rëndësie, por negative, për këtë gjë edhe më ka folur, ia shtinte frikën, thuaja neverinë. Ndërsa ju . . .

Duke shikuar vazhdimisht përpara, tha më zë të ulët:

— Pse a nuk mund të jetë që edhe unë të mendoj njësoj si ai?

— Qysh, njësoj?

— Si ai person?

E shikoja i trazuar, por fytyra e saj nga profili, me fëlqinj të shtrënguara, nuk mund të nëpërdukej.

U përgjigja prerazi:

— Ju mendoni si unë.

— E çka po menduakeni ju?

— Nuk di, as që do të mund t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Mund të them më parë se ju ndieni atë që ndjej unë. Ju e shikuat atë skenë ashtu si do ta kisha shikuar edhe unë të kisha qenë në vendin tuaj. Nuk di çka mendoni as që di se çka mendoj vetë, por e di se mendoni si unë.

— Ju, pra, nuk mendoni për pikturat tuaja?

— Dikur mendoja shumë, i ndërtoja ashtu si ndërtohen shtëpitë, por atë skenë jo: m'u imponua se duhet ta pikturoj ashtu, pa e ditur, madje, as vetë pse. Madje as tash, fundja, nuk e di. Tekembramja, ajo nuk ka të bëjë me pjesën tjetër të pikturës, e, më pastaj, mendoj se njëri prej atyre idiotëve më pat tërhequr vërejtjen për të. Po eci duke përkitur dhe më duhet ndihma juaj, sepse e di se edhe ju ndiheni si unë.

— Nuk e di saktë çka mendoni ju?

Fillova ta humb durimin, iu përgjigja thatë:

— A nuk ju thashë se nuk di çka mendoj! Sikur të mund të shprehja me fjalë qartazi atë dhe ashtu si mendoj, kjo gjë do të ishte gati si të mendoja kthjellët, apo jo?

— Po, taman.

Heshta për një çast dhe mendoja, duke u rrekur të shoh qartë. Pastaj shtova;

— Mund të thuhet se e tërë puna ime e mëhershme është e përcipët.

— Cila punë e mëparshme?

— Ajo para dritarezës.

Mbasi u përmblodha, pastaj thashë:

— Jo, nuk është në të vërtetë kjo, nuk është. Nuk qe e përcipët.

Çka ishte në të vërtetë? Kurrë deri në atë çast nuk kam menduar për këtë problem. Tash e vënerova se skenën e dritarezës e pikturova si ndonjë somnabullist.

— Jo, nuk kam qenë i përcipët — shtova, gati si për vete. — Nuk e di, krejt kjo ka të bëjë me njëfarë lidhjeje me njerëzit përgjithësisht, më kuptoni? Më kujtohet se disa ditë para se ta pikturoja, lexova se dikush ish ankuar në kampin e përqëndrimit se ka uri dhe se kishin detyruar ta hajë një mi xherizi të gjallë. Nganjëherë më thotë mendja se asgjë nuk ka kuptim. Në një planet të vogël, i cili ngarend tash miliona vjet kah asgjëja, lindim në dhembje, rritemi, luftojmë, sëmuhemi, vuajmë, të tjerëve u shkaktojmë dhembje, bërtasim, vdesim, vdesim dhe të tjerët lindin që të fillojnë përsëri komedinë e pakuptimtë.

A është kështu, përnjëmend? Mendoja për këtë ide mbi mungesën emocionale. A është tërë jeta jonë një varg klithjesh anonime në shkretëtirë yjesh indiferentë?

— Ajo heshte edhe mëtutje.

— Ajo skena me plazh ma shtie frikën — shtova pas një kohe të gjatë — edhe pse e di se është diçka më e thellë. Jo, më mirë të them, ajo më paraqet mua më thellë. Kjo është. Tash jam i bindur se e zbulova, Ajo nuk paraqet ende ndonjë porosi të qartë, jo, por më paraqet mua në mënyrë më të thellë.

Dëgjova se ajo tha:

— Ndoshta porosi e dëshpërim?

E shikova me vëmendje.

— Po — u përgjigja — më duket porosi dëshpërimi. Po shihni se e pasket ndjerë si unë!

Pas një copë here pyeti:

— A ju duket lavdërim një porosi e dëshpërim?

E vështrova i befasuar.

— Jo — u përgjigja — më duket se jo. E çka mendoni ju?

Nuk u përgjigj një copë herë, në fund, ktheu kryet dhe shikimin ma nguli mua.

— Fjala lavdërim, nuk e ka këtu vendin — tha si t'u përgjigjej vetvetes. Me rëndësi është e vërteta.

— E ju mendoni se kjo skenë është e njëmendtë? — pyeta.

U përgjigj thuaja si rreptë:

— Taman se është e njëmendtë.

E shikoja me dëshirim fytyrën e saj të krodhët, shikimin e saj të mbërthyer.

„Nga kjo krodhësi" — pyetesha — „pse". Ndoshta e hetoi dëshirën time, nevojën time për t'u bashkuar, sepse shikimi i saj u ëmbëlsua për një çast dhe dukej se po më ofron urezë, por e hetova se kjo urezë ishte jetëshkurtër dhe e thyeshme, e varur mbi humnerë. Shtoi me zë të ndryshueshëm:

— Mirëpo, çka do të fitoni me atë që do të më shihnit. Unë iu shkaktoj dhembje të gjithë atyre që më afrohen.

X

U morëm vesh të shihemi së shpejti. Më vinte turp t'i them se kisha dëshirë ta shoh ditën tjetër ose se kisha dëshirë ta shikoj edhe mëtutje aty dhe se nuk do të duhej të ndahej kurrë nga unë. Përkundër asaj që kam mbamendje të pabesueshme, herë-herë kam zbrazëti të pashpjegueshme. Tash nuk e di ç'i pata thënë në atë moment, por më kujtohet se ajo u pat përgjigjur se i duhej të shkonte.

Po atë mbrëmje fola me të me anë të telefonit. M'u lajmërua një femër, kur i thashë se kisha dashur të flas me zonjushën Maria Iribarneo, m'u duk se u ndërdysh për një çast, por shtoi menjëherë se do të shkojë të shohë a është aty. Po thuaj në atë moment ia dëgjova zërin Marisë, disi si zyrtar, sa më përftoi drashjen.

— Duhet t'ju shoh, Maria — i thashë. — Qyshse u ndamë, mendjen e kam çdo sekondë te ju.

Pushova duke u dridhur. Ajo s'u përgjigj.

— Pse nuk po përgjigjeni? — pyeta me nervozitet.

— Pritni një moment — ndërhyri.

Dëgjova se e lëshoi receptorin. Pas disa çastesh ia dëgjova përsëri zërin, por tash zërin e vërtetë, tash më bëhej se ajo dridhej.

— Nuk munda të flas — u përgjigj.

— Pse?

— Këtu hyjnë e dalin.

— E si po mundeni tash?

— Pepse e mbylla derën. Kur ta mbyll derën, e dinë se nuk duhet të më trazojnë.

— Duhet t'ju shoh. Maria — përsërita shpejt. — Prej drekës e kam mendjen vazhdimisht të ju.

Ajo nuk u përgjigj.

— Pse nuk po përgjigjeni?

— Kastel... — nisi të flasë pavendosmërisht.

— Mos më thirrni Kastel!.. brita idhshëm.

— Huan Poblo... — tha turpshëm.

Ndjeja se me këto dy fjalë filloi lumturia e pakufishme. Mirëpo, Maria heshti prapë.

— Ç'është — pyeta. — Pse nuk po flisni?

Unë, gjithashtu — bëlbëzoi.

— Çka, unë — gjithashtu? — pyeta me dëshirim.

— Unë gjithashtu vetëm mendoja...

— Po, për çka pasket menduar? — pyeta edhe mëtutje me pa durim.

— Për krejt...

— Qysh, për krejt? Për çka?

— Si është kjo e çuditshme... Ajo me pikturën tuaj... takimi i djeshëm... pastaj ky i sotmi... ku ta di...

Pacaktueshmëria më zemëronte gjithmonë.

— Po, por unë ju thashë se nuk pushova së menduari.... mendjen e kam gjithnjë te ju — u përgjigja. — Ju nuk po thuani se keni menduar për mua...

Kaloi një çast, pastaj u përgjigj:

— Po ju them se mendova për krejt...

— Po thuani pa asnjë veçanti.

— Krejt kjo ishte e çuditshme, është aq e çuditshme... aq jam e hutuar... Nuk do mend se e kam pasur mendjen te ju..

Zemra më rrihte. Kisha nevojë për detaje, detajet më nxisin e jo gjërat e përgjithshme.

— Mirëpo, si, qysh?.. — pyeta me flakë dëshirimi. — Unë mendova për çdo tipar të fytyrës suaj, për profilin tuaj, duke e shikuar pemën, për flokët tuaja të gështenjta, për sytë tuaj të mbërthyer, të cilët dinë të ëmbëlsohen menjëherë, për mënyrën e ecjes suaj ...

— Duhet ta ndërprejmë ... — më ndërpreu menjëherë — po hyjnë e po dalin njerëzit.

— Ju thërras në mëngjes, heret — mëzi ia dola t'i them në dëshpërim.

— Mirë — u përgjigj.

XI

Kalova një natë të stuhishme. Nuk munda as të vizatoj as të pikturoj. Edhe pse disa herë provova të bëj diçka. Dola të shëtis dhe, nuk di se si, e pashë veten në Rrugën Korientesi. Më ndodhte diçka fort e çuditshme: tërë botën e shikoja me simpati. Kujtoj se thashë se kam ndërmend këtë ta shtroj objektivisht, dhe tash do t'ju jap një dëshmi duke e pranuar një ndër dobësitë e mia më të mëdha: njerëzit i shikoja gjithnjë me një antipati dhe gati me neveri, sidomos në turmë, plazhe, nuk i doja fare verës, ndeshjet sportive, vrapimet, manifestimet. I doja shumë vetëm ca meshkuj e gra të vetmuara, ndaj disave ndjeja admirim (nuk jam ziliçar, ndaj të tjerëve ushqeja simpati të vërtetë se, në fund, do të bëhen njerëz si të gjithë të tjerët); por, e urreja gjininë njerëzore, kryesisht. Nuk kam asgjë kundër që të pohoj se, ndonjëherë, tërë ditën nuk shtija gjë në gojë, ose tërë javën pikturoja për arsye se e vëneroja ndonjë tipar karakteri; është e pabesueshme se deri në ç'shkallë mund të shihen në fytyrë të një personi zilia, lakmia, pafytyrësia, palevallëku, grykësia dhe, përgjithësisht, këto veti bashkë e bëjnë të pafat gjininë njerëzore. Më duket se është e natyrshme që pas një takimi të tillë,

nuk kam dëshirë të ha, të pikturoj, madje edhe të jetoj. Ndërkaq, dua të them, nuk krenohem me këtë veti. E di se kjo është dëshmi e kryelartësisë: dhe e di, poashtu, se shpirti i bënte shpesh strehim zilisë, pafytyrësisë, grykësisë dhe palevallëkut. Paj, thashë se këtë rrëfim e kam ndërmend ta kallëzoj me objektivitet të plotë dhe kështu do të veproj.

Atë natë, pra, urrejtja ime ndaj njerëzve qe ndryshuar ose, të paktën, treti përkohësisht. Hyra në kafenenë Marsoto. Supozoj se e dini se njerëzit shkojnë atje të dëgjojnë tango apo të dëgjojnë ashtu si dëgjojnë disa dashamirë të muzikës ose fetarët *Pasinë* sipas Matheut.

XII

Të nesërmen në mëngjes, rreth orës dhjetë, e thirra në telefon. U paraqit prapë ajo femra si dje. Kur pyeta për zonjushën Maria Iribarneo, më tha se ajo po atë ditë në mëngjes kishte shkuar në fshat. U ftoha.

— Në fshat? — pyeta.

— Po, zotëri. Ju jeni zotëri Kasteli?

— Po, unë jam Kasteli.

— Këtu e la një letër për ju. Tha që ta ndjeni, por nuk e kishte adresën tuaj.

Aq u jetësova me mendimin se qysh atë ditë do ta shoh dhe prej atij takimi pritja aq gjëra me rëndësi, sa ky lajm më vrau. I bëra vetes një varg pyetjesh: Pse paska vendosur të shkojë në fshat. Ishte e qartë se këtë vendim e mori pas bisedës sonë telefonike, sepse do të thoshte, përndryshe, në bisedën tonë telefonike do të më kishte thënë diçka për udhëtimin e, përveç kësaj, nuk do ta pranonte sugjerimin tim që nesër të bisedojmë me anë të telefonit. Po, mirë, nëse ky vendim pasoj mbas bisedës sonë telefonike, a mund të jetë ky *rrjedhim poashtu i kësaj bisede?* Nëse është rrjedhim, pse dëshiroi të ikën edhe njëherë prej meje? A mos i frikësohej takimit të pashmangshëm si atë ditë?

Ky udhëtim i papritur e dëshmoi dyshimin e parë. Si ndodh gjithmonë, zura të kërkoj detaje të dyshimta që nga koha e mëparshme, të cilëve nuk u jepja rëndësi. Nga i erdhi ndryshimi i zërit ditën e parandejshme në telefon? Kush ishin ata njerëz që „hynin e dilnin" dhe që e pengonin të flasë natyrshëm? Aq më tepër, *kjo tregonte se ishte e aftë të simulojë.* Dhe pse u ndërdy ajo grua të përgjigjej kur e pyeta për zonjushën Iribarneo? Mirëpo, një fjali më është ngulitur sidomos thellë: „Kur ta mbyll derën, e dinë se nuk duhet të më trazojnë". Më thoshte mendja se rreth Marisë sillen shumë hije.

Hera e parë që më shkrepi kjo ide, ndërsa ngutesha për në shtëpi të saj. Ishte e çuditshme se ajo nuk e gjeti adresën time, kurse unë, qe, e dija adresën e saj dhe numrin e telefonit. Banonte në Rrugën Pasandos, gati në bërryl të Rrugës Seaver.

Isha shumë i shqetësuar kur e gjeta në katin e pestë dhe kur i rashë ziles.

Derën e hapi shërbëtori, i cili ishte me siguri polak ose i tillë disi, e kur ia thashë emrin, më shtiri në njëfarë salloni përplot libra, muret ishin të veshur me rafte deri në tavan, ndërsa libra të shpërndarë kishte edhe mbi dy tavolina madje edhe mbi kulltuqe. Vërejtjen ma tërhoq një numër i madh librash në vëllime.

Hyra t'ia hedh një sy bibliotekës, Papritmas pata përshtypjen se dikush po më vështronte pas shpine. U ktheva dhe pashë një njeri në anën tjetër të sallonit. Ishte i gjatë, i ajthëm, fytyra syret me sy, buzagaz shikonte kah unë, por *kryesisht* në manyrë të pacaktueshme. Përkundër kësaj që i kishte sytë çelur, vënerova se është i verbër. Atëherë m'u bë e qartë pse ishin ata libra aq të mëdhenj.

— Ju jeni, Kasteli, apo jo? — më pyeti me përzemërësi duke ma zgjatur dorën.

— Po, zotëri Iribarneo — u përgjigja duke e shtrirë dorën pacaktueshëm dhe, më shkoi mendja, në ç'lidhje farefisnore janë Maria e ai?

Në të njëjtën kohë kur më dha shenjë që të ulem, buzëqeshi me një fije ironie dhe shtoi:

— Nuk quhem Iribarneo dhe mos më thirrni zotëri. Unë quhem Alende, burri i Marisë.

I mësuar të vlerësojë e ndoshta edhe të shpjegojë heshtjen, shtoi përnjëherë:

— Maria e përdor gjithmonë mbiemrin e vajzërisë.

Unë qëndroja si trupc.

— Maria më ka folur shumë për pikturat tuaja. Si u verbova, para disa vitesh, ende mund t'i parafytyroj mjaft mirë gjërat.

Dukej si të donte të arsyetohej për shkak të verbërisë së vet. Nuk dija ç'të them. Sa dëshiroja të jem vetëm, në rrugë, që të mendoj për çkado.

E nxori letrën prej xhepit dhe ma shtriu.

— Ja, letra — tha trup e shkurt sikur ajo nuk përmbante asgjë.

E mora letrën dhe desha ta shtij në xhep, kur i verbëri, sikur të kishte parë ç'desha të bëj, tha:

— Lexojeni. Edhe pse ju shkruan Maria, mendoj se nuk është urgjente.

Dridhesha. E çela zarfin, kurse ai, mbasi më ofroi mua cigaren, e ndezi një. E nxora letrën. Ishte e shkruar vetëm një fjali:

Unë gjithashtu e kam mendjen te ju.

Maria

Kur i verbëri hetoi se po paloja letrën, pyeti:

— Asgjë urgjente, supozoj.

Me mund të madh u përgjigja:

— Jo, asgjë urgjente.

Duke e parë të verbërin se si qeshej, ndihesha si përbindësh. Ai më shikonte me sy gapërr.

— E tillë është Maria — tha si të fliste me vetveten. —

— Shumëkush i ngatërron impulset e saj me urgjencën. Si t'ua shpjegoj?

Shikonte si i hutuar në dysheme dhe të kërkonte shpjegim sa më të qartë. Pastaj tha:

— Si njeriu që rri shumë kohë në shkretëtirë dhe e ndërron përnjëherë vendin. Kuptoni? Shpejtësia është me rëndësi, je gjithmonë në të njëjtin vend.

E thithi një tym dhe u thellua prapë si të mos isha unë i pranishëm. Pastaj shtoi:

— E, megjithatë, nuk e di a është kjo me të vërtetë? Nuk më flejnë aq metaforat.

Mëzi e pritja çastin që të ikë prej atij salloni të mallkuar. Mirëpo, i verbëri, duket, kishte mjaft kohë. Ç'komedi e urryer ishte kjo? — mendova.

— Tash, për shembull, — vazhdoi Alende — çohet heret dhe më thotë se po shkon në qiflig.

— Në çaflig? — pyeta krejt pa vetëdije.

— Po, në çifligun tonë. Thënë më saktë, në mylkun e gjyshit tim. Por, tash e ka në duar kushëriri im i parë, Hunteri. Supozoj se e njihni?

Ky zbulim i rri më mbushi me drashje dhe njëkohësisht me urrejtje. Ç'të mirë gjeti Maria në atë gabërrosh feminist dhe cinik? Provova të qetësohem duke menduar se Maria nuk shkonte në çiflig për shkak të Hunterit, por për shkak se i pëlqente qetësia e fushave dhe pse çifligu ishte i familjes. Mirëpo, u mjerova.

— Kam dëgjuar për të — thashë me indinjim.

Para se i verbëri ta merrte fjalën, shtova me të shpejtë:

— Duhet të shkoj.

— Djall o dreq, bash po më vjen keq — tha Alende. — Shpresoj se do të shihemi prapë!

— Po, dorëmenjë, po — thashë.

Më përcolli deri te dera. Ia shtriva dorën dhe dola turr e vrap. Ndërsa zbritja me ashensor, përsëritja me tërbim:" Ç'komedi e urryer është kjo"?

XIII

U desh të përmblidhem dhe të mendoj qetazi. Ecja Rrugës Posadas ndaj Rokoleti.

Kryet më vlonte, kaos: mendime të panumërta, ndjenja e dashurisë dhe e urrejtjes, vuajtjet, fyerjet dhe kujtimet përziheshin dhe paraqiteshin njëra pas tjetrës.

Çfarë ishte, për shembull, ideja që të më shtyjë të shkoj në shtëpi për të kërkuar letrën dhe atë të ma japë në dorë burri i saj! Dhe qysh nuk më tha se është e martuar? Dhe, ç'dreqin, ka të bëjë në çiflig me atë të pafytyrë, Hunterin? Dhe pse nuk priti ta thërras me anë të telefonit? Dhe ai i verbëri, çfarë lloj bubërreci është? A thashë se kam përfytyrim të pakëndshëm për njerëzit, tash duhet të pranoj se *nuk i dua aspak të verbërit* dhe se para tyre kam përshtypjen sikur kur gjendem para dofarë kafshësh të ftohta, jargoshe dhe heshtjeruese si gjarpërinjtë. Nëse kihet parasysh bamunia se para tij e lexova letrën e gruas së tij, në të cilën shkruante EDHE UNË E KAM MENDJEN GJITHASHTU TE JU, nuk është vështirë të hetohet se çfarë përshtypje neveritëse kisha në atë çast.

U përpoqa të vë pak në rend atë kaos të mendimeve e të ndjenjave dhe, në atë rast, të jem

metodik si bëj rëndom. U desh të nisem pej fillimit, ndërsa fillimi (më së paku i drejtpërdrejtë) është biseda telefonike. Në atë bisedë pat shumë pika të errta.

Në radhë të parë, nëse në atë shtëpi qe e natyrshme ajo të mbajë kontakte me njerëz, si tregon e dhëna e dorëzimit të letrës nga ana e burrit të saj, pse foli me ton aq zyrtar derisa nuk e mbylli derën? Pastaj ç'është shpjegimi: „kur është dera e mbyllur, e dinë se nuk duhet të më trazojnë"? Dhe, duket se, ajo po u mbyllka shpesh që të bisedojë me anë të telefonit? Mirëpo, nuk është aspak e besueshme se mbyllej për të bërë biseda të zakonshme me miqtë e shtëpisë: u desh të supozoj se mbyllej kështu që të bënte biseda të ngjashme si ato tonat. Domethënë, në jetën e saj paska pasur edhe persona të tjerë si jam unë. Sa i paska pasur? Dhe kush janë ata?

Më parë më shkoi mendja te Hunteri, por e hodha poshtë menjëherë, pse të flasë me të me anë të telefonit kur mund ta shihte në çiflig kur të donte! Në atë rast, kush ishin ata të tjerët?

Ma mori mendja se me këtë e hoqa çështjen e bisedave telefonike. Jo, nuk e hoqa. Mbeti edhe më tutje çështja e përgjegjies së saj pyetjes sime. Konstatova me indinjim se, kur e pyeta a i shkoi mendja tek unë, pas sa ndërdyshjeve, vetëm tha: „Pse a nuk ju thashë se kam menduar për krejt"? T'u përgjigjesh pyetjeve nuk obligohesh shumë. Në fund, dëshmia se kjo përgjegje nuk qe e qartë, ishte kjo se ajo të nesërmen (ose po atë natë) e konsideroi të nevojshme të përgjigjet me letër në formë shumë të qartë.

„Ta marrim letrën" — mendova. Letrën e nxora prej xhepit dhe e lexova përsëri.

Edhe unë e kam gjithashtu mendjen te ju

Maria

Nga dorëshkrimi shihej edhe nervoziteti i saj ose, të paktën, ky ishte dorëshkrim i një personi

nervoz. Kjo nuk është njësoj, sepse nëse është supozimi i parë i saktë, atëherë tregon shqetësim momental dhe për aq indiçe të volitshme për atë që më përkiste mua, le të jetë si të jetë, më shqetësoi nënshkrimi: *Maria.* Trup e shkurt *Maria.* Kjo njajzesi më përftonte mendim të pacaktuar të përkatësimit, mendim i pacaktuar se vajza i përkiste tashmë jetës sime, dhe se më përkiste në njëfarë mënyre të caktuar.

Medet! Ndjenja ime e lumturisë qe aq jetëshkurtër ... Kjo mbresë, për shembull, nuk i qëndronte asnjë analize: pse a nuk e quajti edhe burri i saj Mari? E, edhe Hunteri e quan me siguri ashtu, po si do ta quante ndryshe? Edhe personat e tjerë me të cilët bisedon me dyer të mbyllura? Supozoj se askush nuk flet me dyer të mbyllura me dikë, të cilit i thotë me nderim „zonjusha Iribarneo"?

„Zonjusha Iribarneo"? Tash m'u kujtua hutimi i shërbëtores kur thirra herën e parë me telefon. Sa çudi! Kur të mendoj pak më mirë kjo është dëshmi se ky lloj i thirrjes nuk ishte krejt i ri: fare qartë, kur dikush pyet për „zonjushën Iribarneo" shërbëtorja e befasuar, e shtrënguar nga rasti, duhet ta korrigjojë, duke theksuar atë *zonja.* Mirëpo, mbasi kjo përsëritej, natyrisht, shërbëtorja ishte e shtërnguar t'i rrudhë supet dhe të pandehë se është më mirë të lërë pas dore kërshërinë. Kuptohet, u ndërdysh, por nuk më korrigjoi.

Duke e marrë përsëri letrën në shqyrtim, mendova se kam arsye të nxjerr një varg përfundimesh. U nisa prej faktit më të përjashtueshëm: mënyra si të ma dorëzojë letrën. Më kujtohet arsyeja, të cilën ma përcoll shërbëtorja" „Ta ndjeni, sepse nuk e kishte adresën", Kjo është e saktë: as që ajo ma kërkoi adresën, as që mua më ra ndërmend t'ia jap adresën time; mirëpo, gjëja e parë që do të bëja, sikur të kisha qenë në vend të saj, do ta kisha kërkuar në regjistër të telefonave. Ishte e pamundur këtë veprim të saj

t'ia mbathësh përtacisë së pakuptueshme e, pastaj, dilte përfundimi i pashmangshëm: *Maria pat dëshirë të vija në shtëpi të saj për t'u parë me të shoqin.* Pse? Aty u krijua një situatë shumë e ndërlikuar: ndoshta ajo ndiente kënaqësi që burri i saj t'i shërbente si ndërmjetës; ndoshta kjo gjë i përftonte kënaqësi vetë burrit? Përveç këtyre mundësive patologjike, ekzistonte një e natyrshme: Maria deshi të më bëjë me dije se ishte e martuar, në mënyrë që të shoh se nuk ishte e pëlqyeshme që të shkoja mëtutje.

Jam i sigurt se shumica prej atyre që i lexojnë tash këto faqe, do të deklarohen për këtë supozim të fundit dhe do të vlerësojnë se vetëm një njeri si unë mund të zgjedhë ndonjë tjetër. Në kohë kur kisha miq, qesheshin me teket e mia, duke zgjedhur gjithmonë rrugën më të gabueshme. Po pyetem *pse realiteti duhet të jetë i njajzesishëm?* Përvoja më tregoi se ai, përkundrazi, nuk është kurrë dhe, kurdo që diçka duket jashtëzakonisht qartë, ndonjë veprim që sy e faqe duket i njajzesishëm, fsheh gati gjithmonë nxitës shumë të ndërlikuar. Qe një shembull i përditshëm: njerëzit që japin lëmoshë mendojnë gjithmonë për veten e tyre se janë dorëdhënë dhe më të mirë se ata që nuk japin. Do të jem i lirë që këtë teori të thjeshtë ta trajtoj me neverinë më të madhe, Gjithkush e di se çështja e një lypësi (të një lypësi plangçor) nuk zgjidhet me dhjetë qindarka ose me një copë buke: me këtë zgjidhet vetëm problemi psikologjik i zotërisë që blen në atë mënyrë gati për asgjë prehjen shpirtërore dhe titullin e vet dorëlirë. Vetëm merrni me mend sa është ajo botë koprrace ndërsa nuk mund të xjerrë nga xhepi më shumë se dhjetë qindarka në ditë për të siguruar prehjen e vet shpirtërore dhe për të kënaqë krenarinë për mirësinë e vet. Sa duhet pastërti më e madhe shpirtërore dhe guxim për ta ndihmuar mjerimin njerëzor dhe pa këtë operacion të hipokrizisë së rëndomtë.

Por, le t'i kthehemi letrës.

Vetëm ndonjë zemërngushtë do të mund të kapej për supozimin e njëjtë, sepse ai shembet me analizën më të vogël. „Maria deshi të më bëjë me dije se është e martuar, që të shihja se nuk ishte në terezi t'i bie mbrapa mëtytje". Fort mirë. Mirëpo, në atë rast, pse të preferojë një veprim të tillë aq mizor dhe egërsues? Pse a nuk mundi të më thotë personalisht, madje edhe me anë të telefonit? Mbetet edhe mëtutje edhe një e dhënë e tmerrshme: pse në letër nuk tha në atë rast se është e martuar, si mund ta dija dhe, as që lutej ta pranoj lidhjen tonë në kuptim më fashitës? Jo, zonjë. Përkundrazi, letra i dedikohej forcimit të marrëdhënieve tona dhe kurajimit që ato t'i përshkojnë udhët me të rrezikshme.

Mbetën, pra, supozimet patologjike. A është e mundur, pra, që Maria të ndjejë kënaqësi kur e përdor Alenden si ndërmjetës? Ose mos kërkonte ai vetë raste të tilla? Ose fati u tall duke i bashkuar dy qenie të njëjta?

Përnjëherë u trullosa si m'u imponuan këto ekstremitete nga shprehia e zakonshme që t'i analizoj deri në pakufi veprat dhe fjalët. M'u kujtua shikimi i Marisë i ngulur në pemë të Sheshit ndërsa dëgjonte persiatjet e mia, m'u kujtua turpërimi i saj, ikja e saj e parë. Zuri të më kapë njëfarë sensibiliteti i pakufishëm ndaj saj. Më bëhej se ajo është qenie e thyeshme, joreale midis kësaj bote mizore përplot shemti dhe mjerim. Ndjeja atë që ndjeja shpesh prej atij çasti në sallon: se ajo është qenie që më përngjet mua.

I harrova persiatjet e mia të pafrytshme dhe përfundimet e mia mizore. Nisa të sjell ndërmend fytyrën e saj, shikimin e saj — atë shikim që më kujtonte diçka që nuk mund ta caktoja — mënyrën e saj të thellë e melankolike të rezonimit. Ndjeva se dashuria e panjohur, të cilën e ushqeva vite me radhë të vetmisë, u përqëndrua në Marinë. Si munda të mendoj në gjëra aq absurde?

Por, përpiqesha t'i harroj të gjitha konkluzat e mia të gabueshme përkitazi me telefonin, letrën, çifligun, Hunterin.

Mirëpo, nuk munda.

XIV

Ditët vijuese qenë shumë të stuhishme. Nga ngutia as që pyeta kur kthehet Maria prej çifligut; po atë ditë kur isha për vizitë. thirra me anë të telefonit për të marrë vesh, shërbëtorja më tha se nuk dinte, pastaj nga ajo kërkova adresën e çifligut.

Po atë natë i shkrova një letër dëshpëruese, e pyetja për ditën e kthimit të saj dhe i lutesha të më thërrasë me anë të telefonit kur të vijë në Buenos Aires ose të më shkruajë. Shkova deri në Postën kryesore dhe e dërgova të porositur, që t'i ikë edhe rrezikimit më të vogël.

Si thashë, i kalova disa ditë të stuhishme dhe nëpër krye më silleshin me mijëra herë mendime të zymta, të cilat më shkaktonin dhembje pas vivitës që i bëra në Rrugën Posadas. Pashë ëndërr se natën po vizitoja një shtëpi të vogël krejt të lënë. Ishte kjo shtëpi të cilën e kisha parë në njëfarë mënyre dhe dëshiroja pa masë që nga fëmijëria të më përkiste, ashtu që nëpër të më pritnin do ndjenja Mirëpo, hera-herë humbja në terr ose kisha përshtypjen se pas shpine mund të më sulën armiqtë e fshehur apo njerëzit që pështërisnin diçka ose më çinonin mua dhe naivitetin tim. Kush ishin ata dhe çka kërkonin?

Por, ndjeva, pa pikë dyshimi, e përkundër kësaj, se po në atë shtëpi lindi përsëri dashuria e hershme rinore me dridhtim dhe atë trullim të ëmbël, me drashje dhe gëzim. Kur u zgjova, e kuptova se ajo shtëpi e ëndrrës është Maria.

Atë ditë, para se ta merrja letrën e saj, më patën tretur mendimet si hulumtuesi në vise të veshura me mjergull; ia dilja aty-këtu me mundim të madh të ajgtoj hije të pacaktuara të njerëzve e të personave, kontura të pacaktuara greminash e rreziqesh. Kur arriti letra, si të kishte shkrepur dielli.

Mirëpo, *ky diell ishte dielli i zi,* dielli i natës. Nuk e di a duhet të thuhet, por, edhe pse nuk jam shkrimtar dhe nuk jam i sigurt në qëndrimin tim, nuk do ta kisha nënvizuar fjalën *i natës:* kjo fjalë është ndoshta më adekuate për Marinë nga të gjitha fjalët prej të cilave përbëhet gjuha jonë e papërkryer.

Më shkroi më sa vijon:

I kalova tri ditë të çuditshme: deti, bregdeti, rrugët, krejt këto më kujtonin kohëra të tjera. Jo vetëm pikturat, por edhe zëret, britmat dhe qetësia e thellë e atyre ditëve. Është për t'u çuditur, por jeta është krijim i kujtimeve të ardhshme; këtë moment, këtu, buzë detit e di se po gatis ndjenja të holla, të cilat do të sjellin një ditë melankolinë dhe dëshpërimin.

Ndërsa po shikoj me ngulmë detin, këtu është deti prore dhe i tërbuar, klithja ime e dikurshme, nuk shërben më për asgjë; e poashtu nuk shërben më për asgjë as pritja ime në bregdetin e shkretë. A e zbërtheve dhe a e pikturove këtë ndjenjë time, ose i pikturove kujtimet e shumë qenieve siç jemi unë e ti?

Ndërsa tash më shfaqet fytyra jote: ti je ndërmjet meje e detit. Sytë e mi piqën me sytë tu. I qetë, pak i pikëlluar, më shikon si të kërkoje ndihmë.

Maria

Si e kuptova dhe ç'ndjenjë të mrekullueshme më zgjoi kjo letër! Madje edhe ajo që më shkruante me „ti" më bindi se Maria ishte imja. Vetëm imja: „ti je ndërmjet meje e detit": atje nuk ekzistonte më askush, ishim vetëm ne të dy, ashtu si parandjeja atë ditë kur ajo e shikonte skenën në dritarezë. Njëmend, pse të mos më thoshte „ti" mbasi njihemi kahmot, para më se njëmijë vjetësh? Kur u ndal ajo para pikturës sime dhe e shikonte atë skenë të vogël, e nuk e shihte dhe nuk e dëgjonte atë mori njerëzish që më rrethonte, më bëhej se qysh atëherë qemë në „ti", dhe e hetova menjëherë se çfarë është, kush ishte, sa më duhej dhe sa i duhesha unë asaj.

Oh, megjithatë, të vrava! Unë të vrava, unë, që ta shikoja si nëpër mur qelqi fytyrën tënde memece e të mallshme dhe nuk munda as ta prek! Unë, gabërrosh i tillë, aq i verbër, aq vetjak, aq mizor!

Mjaft më me shqyrtime. Ju thashë se do t'ju rrëfej këtë ndodhi në dritë të vërtetë dhe do të veproj ashtu.

XV

Marinë e desha pa mend, megjithatë nuk e përdorëm kurrë fjalën dashuri. e pritja me dëshirim kthimin e saj prej çifligut që t'i them.

Mirëpo, ajo nuk kthehej. Ashtu si kalonin ditët, mua më rritej ashtu trenia. Ia shkrova letrën e dytë në të cilën i thashë trup e shkurt: „Të dua, Mari, të dua"!

Pas dy ditësh, më në fund, e mora përgjegjen me këto fjalë: „Druaj se do të të shkaktoj shumë të këqia". Po atë çast iu përgjigja; „Nuk e marr në dorë ç'mund të më bësh. Do të kisha vdekur sikur të kisha mbetur pa dashurinë tënde. Kur nuk të shoh, çdo sekondë është mundim i pakufishëm

Kalonin ditë të tmerrshme, por përgjegjia e Marisë nuk mbërrinte. I dëshpëruar, i shkrova: „Po ma prredh shpirtin".

Të nesërmen dëgjova me anë të telefonit zërin e saj që i dridhej prej së largu. Përveç fjalës Mari, të cilën e përsëritja pandërprerje, nuk ia dola të them asgjë, por kjo gjë as që ishte e mundur: fyti më shtrëngonte aq shumë sa nuk munda për një kohë të shqiptoj asnjë fjalë. Ajo tha:

— Nesër kthehem në Buenos Aires. Të lajmëroj para se të mbërrij.

Të nesërmen pas dreke m'u lajmërua prej shtëpisë.

— Dua të të shoh menjëherë. — thashë.

— Po, shihemi brenda ditës — u përgjigj.

— Të pres në Sheshin Shën Martini — i thashë.

Dukej se Maria ndërdyshej. Pastaj u përgjigj:

— Do të doja më shumë në Sheshin Rekoleta. Më prit atje në tetë.

Sa e pritja atë çast, si ecja rrugëve pa qëllim, që koha të kalojë sa më shpejt! Sa ëmbëlsi ndjeja në shpirt, sa e mrekullueshme më dukej bota, pasdreke e verës, fëmijët që luanin në trotuar. Tash po shoh se deri në ç'shkallë verbëron dashuria dhe ç'fuqi magjika ka të transformimit. Bukuria e botës! Oh, të plasësh prej gazit!

Ishte tetë dhe disa minuta kur e vënerova Marinë duke u afruar e duke më kërkuar në terr. Ishte tepër vonë që të mund t'ia shihja fytyrën, por e njohta nga mënyra e ecjes.

U ulëm. Ia shtrëngova dorën dhe ia përsërita disa herë pa mend emrin; nuk dija çka të them tjetër, ndërsa ajo heshte.

— Pse shkove në çiflig? — më në fund e pyeta me të shpejtë. — Pse më lë vetëm? Pse e lë atë letër në shtëpinë tënde? Pse nuk më tregove se je e martuar?

Ajo nuk përgjigjej: Ia shtrëngova dorën. Klithi.

— Po më shkakton dhembje, Huan Pablo — tha ëmbëlsisht.

— Pse nuk thua diçka? Pse nuk po përgjigjesh?

Nuk tha asgjë.

Pse? Pse?

Më në fund u përgjigj:

— Ç'duhen përgjegjet për çdo gjë? Të mos flasim për mua; të flasim për ty, për punimet tua, për preokupimet tua. Gjithë kohën mendova për pikturat tua, për atë që më pate folur në Shën Martin. Dua të di ç'po punon tash, ç'mendon, a pikturove apo jo?

— Jo — iu përgjigja. — Nuk dua të flas për veten, dua të flasim për ne, të dyve. Duhet ta di a më do. Vetëm këtë: ta di a më do.

Trishtimi nga heshtja e terri, i cili nuk më bënte të mundur nga shikimi t'ia zbërthej mendimet, e ndeza një fije shkrepse. Ajo e ktheu kryet shpejt për ta fshehur fytyrën. Me dorën tjetër ia ktheva kryet dhe e detyrova të më shikoj: qante ngadalë.

— Oh... pra, nuk po më dashke — thashë me indinjim.

Mirëpo, derisa shkrepsa u fik, e pashë se më shikonte me sensibilitet. Ndërsa pastaj, në terrin e plotë, ndjeva se si me dorë më lëmonte kryet. Më tha ëmbëlsisht:

— Dihet se të dua... Pse të flitet për ca gjëra?

— Po — iu përgjigja. — Por si më do? Mund të duash në disa mënyra. Mund të duhet ashtu edhe klyshi edhe ndonjë vocërrak. Desha të them: dashuria, dashuria e njëmendët, kupton?

Kisha një ndjenjë të çuditshme: e ndeza shpejt fijen tjetër. Mu ashtu si ndjeja, Marisë i qeshte fytyra. Domethëne, nuk i qeshej më, por i qeshi dhjetë sekonda më parë. Hera-herë më ndodhte të kthehem nga përshtypja mos po më përgjojnë dhe nuk pashë askë e, megjithatë, ndjeja se vetmia që më rrethonte ishte pak më e hershme e se treti disi si shpejt, ndërsa një dridhtimë e lehtë vezullonte ende në hapësirë. Ishte ashtu disi.

— Qeshe — i thashë bukur idhshëm.

— Qesha — pyeti e habitur.

— Po, qesh: mua nuk mund të më mashtrosh aq lehtë. Unë i vë re qartë detajet.

— Çfarë detajesh vënerove? — pyeti me athtim.

— Diçka nuk t'u çlye nga fytyra. Gjurmët e gazit.

— Për çka do të qeshesha? — pyeti prapë me athtim.

— Naivitetin tim, pyetjes sime se a më do përnjëmend ose më do si ndonjë vocërrak, ku ta di... Mirëpo, u qeshe dhe nuk dyshoj aspak.

Maria u çua përnjëherë.

— Ç'u bë — pyeta i befasuar.

— Po shkoj — u përgjigj me athtim.

Kërceva si jaji.

— Qysh ashtu, po shkon?

— Po... shkova.

— Qysh ashtu? Pse?

Nuk u përgjigj. Thuajse e shkunda me të dy duart.

— Pse po shkon?

— Druaj se ti nuk po më kupton.

U tërbova.

— Qysh? Po të pyes për diçka që për mua është çështje e jetës apo e vdekjes e ti, në vend që të më përgjigjesh, ti po qeshesh dhe po hidhërohesh. Eshtë e qartë se nuk mund të të kuptoj.

— T'u bë se u qesha — tha tharbët.

— Jam i sigurt.

— E, pra, po mashtrohesh. Dhe po më dhemb pa masë që mendove ashtu.

Nuk dija ç'të mendoj, isha tepër i goditur. Menjëherë pastaj e hetova se ajo më kapi dashunisht për dore e, mandej, ia dëgjova edhe zërin, tash të qetë dhe plot dhembje:

— Mirëpo, si mund të mendosh ashtu?

— Nuk e di, nuk e di — u përgjigja thuaja se duke qarë.

Prapë më uli në bankë dhe m'i lëmoi flokët, ashtu si bëri në fillim.

— A ta tërhoqa vërejtjen se do të të shkaktoj shumë të këqia — më tha mbasi heshti disa çaste. — po sheh se kam të drejtë.

— Po ndodhi me fajin tim — u përgjigja.

— Jo, ndoshta, faji është imi — tha mendueshëm, si të fliste me vetveten.

„ Sa çudi" — mendova.

— Ç'është e çuditshme? — pyeti Maria.

U tmerrova, madje edhe më shkoi mendja (pas aq ditësh) ishte e aftë t'ua qëllojë mendimeve të mia. As sot e asaj dite nuk e di a pata folur me zë dhe nuk e kam hetuar.

— Ç'është e çuditshme? — pyeti përsëri, sepse unë nga tmerrimi nuk isha përgjegjur.

— Me vitet tua.

— Me vitet e mia?

— Po, me vitet tua. Sa vjet i ke?

Buzëqeshi.

— Ç'mendon? Sa vjet i kam?

— Kjo është për t'u çuditur — u përgjigja. — Herën e parë kur të pata parë, m'u pate dukur si vajzë njëzet e gjashtë vjeçe.

— Kurse tash?

— Jo, jo.... që në fillim u pata hutuar, sepse diçka jo materiale më shtyri të mendoj...

— Ç' të mendosh?

— Se ke shumë vjet, Hera-herë para teje po ndihem si fëmijë.

— Sa vjeç je ti?

— Tridhjetë e tetë.

— Njëmend qenke i ri.

U hutova. Jo pse isha i bindur se kam shumë vjet, por pse, përkundër të gjithave, isha më i vjetër se ajo; sepse nuk ishte e mundur kurrsesi që ajo të jetë më shumë se njëzet e gjashtë vjeçe.

— Shumë i ri — përsëriti duke ia qëlluar se isha habitur.

— Po ti: sa vjet i ke? — insistova.

— Ç'rëndësi ka? — u përgjigj me seriozitet.

— E pse pyete sa vjeç jam? — thashë thuaja i nxitur nga ajo.

— Kjo bisedë është absurde — u përgjigj. — Krejt këto së bashku janë marrëzi. Më habit si merresh me gjëra të tilla.

Unë nuk merrem me gjëra të tilla. Paj, ne të bëjmë asofarë bisedash? Në të vërtetë, si na ndodhi kështu? Isha aq i habitur saqë pata harruar pse e bëra pyetjen i pari. Jo, më mirë të them, nuk e kërkova shkakun e pyetjes së parë. Tek këtu, në shtëpi, pas disa orësh, e kuptova domethënien e thellë të kësaj bisede, sy e faqe të thjeshtë.

XVI

Më shumë se një muaj u pamë gati për çdo ditë. Nuk dua të kujtoj përsëri në hollësi krejt çka ndodhi për atë kohë të mrekullueshme dhe njëkohësisht të tmerrshme. Ndodhen aq shumë gjëra të dhembshme sa nuk kisha dashur t'i ngjall përsëri në kujtime.

Maria nisi të vijë në atelie. Skena me shkrepsa u përsërit dy apo tri herë me variacione të vogla dhe unë jetoja i xhindosur në bindje se dashuria e saj ishte në shtegun më të mirë dashuri nëne ose motre. Kështu që lidhja trupore më dukej si kufi i dashurisë së njëmendtë.

Tash e tutje do të them se kjo bindje ishte një prej shumë naiviteteve të mia, një prej atyre naiviteteve për shkak të të cilëve Maria qeshej pas shpine. Dashuria trupore, larg qoftë të më qetësojë, më çrregulloi edhe më tepër, më përftoi dyshime të reja të mundimshme, skena përplot dhembje nga pakuptueshmëria, eksperimente mizore me Marinë.

Orët që i kalonim në atelie, janë orët, që ndoshta, nuk do t'i harroj kurrë. Ndiesitë e mia në atë periudhë oscilonin ndërmjet dashurisë së çiltërt dhe urrejtjes më të flakët për shkak të kundërthënieve dhe të sjelljes së përgjithshme të Marisë. Përkundër asaj që dorëzohej plotësisht, e tëra, menjëherë më kapte dyshimi se krejt kjo

ishte e shtirë. Në momente, më bëhej, si ndonjë çupëlinë e turpshme e, menjëherë, prapë, si të ishte grua e gjithfarshme, ndërsa atëherë më defilonin një varg dyshimesh nëpër krye: Ky? Qysh? Me kë? Kur?

Në raste të atilla nuk mundja t'i ikë mendimit se Maria luante komedinë më suptile e të tmerrshme dhe se unë isha në duart e saj vocërrak naiv, i cili mashtrohet lehtë me përralla që të hajë ose të flejë. Hera-herë më pushtonte turp i tmerrshëm, brrofja të vishëm, ndërsa pastaj dilja vrap në rrugë që të kthjellesha dhe t'u dilja në skaj dyshimeve dhe frikësimeve të mia. Ditëve të tjera, pra, reaksioni im bëhej pozitiv dhe brutal: hidhesha në të, e kapja për duar si me dana, ia dredhja, ia ngulja shikimin në sy, duke u përpjekur t'ia nxjerrë dëshminë e dashurisë.

Mirëpo, krejt këto nuk janë ato që dua të tregoj. Duhet të pranoj se as vetë nuk e di ç'desha të them me atë „dashuri të njëmendtë"; dhe është interesant se, ndonëse e përdora shpesh këtë shprehje në pupuritje, kurrë nuk e kam analizuar deri tash plotësisht kuptimin e saj. Ç'do të thotë dashuria që përfshin epshin ndijimor. Ndoshta në këtë dëshpërim e kërkoja atë për t'u lidhur edhe më fort me Marinë? Isha i sigurt se, në disa raste, ia dilnim të lidhemi, por në një mënyrë të atillë suptile, aq të kalueshme, ashtu taman, sa që ndihesha më vonë edhe më pa shpresë i vetmuar sesa më parë, me atë pakënaqësi të pacaktuar që ndjejmë kur duam t'i rikonstruktojmë sërish disa dashuri. E di se duke shikuar ndonjë park para muzgut ose ndonjë anije të marinës tregtare me emër të çuditshëm, përjetonim, papritmas, dofarë çastesh të përbashkëta. Dhe, ajo që ishim bashkë, e zvogëlonte melankolinë, e pasqyrohej në ndiesi, sigurisht e shkaktuar nga thelbi i pakuptimtë i këtyre bukurive që tretnin shpejt. Mjaftonte të shikoheshim që të dinim ose, thënë më mirë, se po ndienim njësoj.

Eshtë evidente se i paguanim shtrenjt këto çaste, sepse krejt çka ndodhi më vonë, dukej e thjeshtë dhe zvetnuese. Krejt çka bënim (bisedonim, pinim kafe) ishte e dhembshme, sepse tregonim sesa qenë të rralla ato çaste të mirëkuptimit. Dhe, çka është edhe më keq, shkaktonin distanci-me të reja, sepse unë e detyroja nga dëshira që të forcojmë në njëfarë mënyre këtë bashkim — që të bashkohemi fizikisht; vetëm ia dilnim të vërtetojmë se ishte e pamundur t'i vazhdojmë ose t'i forcojmë me ndonjë akt material. Mirëpo, ajo e ndërlikoi situatën, ndoshta, prej dëshirës që të më lirojë nga kjo fikside, shtihej se ndiente përnjëmend, thuaja, kënaqësi të jashtëzakonshme; dhe atëherë më ndodhte të vishem shpejt dhe të dal në rrugë ose, duke ia shtrënguar brutalisht duart, doja ta nxjerr të vërtetën për ndjenjat e saj të njëmendta. Dhe, krejt kjo gjë ishte aq e tmerrshme, sa që ajo, kur e ndiente se po i afrohemi dashurisë fizike, përpiqej t'i bënte bisht. Në fund ra plotësisht në skepticizëm dhe përpiqej ta kuptonte se kjo ishte jo vetëm e padobishme për dashurinë tonë, por edhe e dëmshme.

Me qëndrim të këtillë vetëm ia doli të ma shtojë dyshimin në pikëpamje të llojit të dashurisë së saj, sepse unë e pata pyetur a mos po tallej ajo që të mundte të dëshmonte se dashuria fizike është e rrezikshme dhe në këtë mënyrë të ikte në të ardhmen, meqenëse ishte e vërtetë se që nga fillimi e urrente dhe për këtë arsye shtihej se kënaqej me të. Natyrisht, lindnin edhe zënka të tjera dhe ishte e padobishme të provojë të më bindte, duke më folur për parqe dhe anije. Vetëm ia dilte të më trenojë edhe më shumë me dyshime të reja më suptile dhe, kështu, më përtërihesin prapë shqyrtimet e reja më të ndërlikuara.

Gjëja që më pezmatonte më së shumti në ato mashtrime eventuale qe se i isha dorëzuar pa kurrfarë mbrojtjeje, si ndonjë voc.

— Nëse dyshoj ndonjëherë se më ke mashtruar — i flitja me hidhërim — të vras si qenin.

Ia lidhja duart dhe e shikoja ngultas në sy, mos po zbuloja farë dëshmie, ndonjë shkëlqim të dyshimtë, ndonjë shkëndijë të pakapshme të ironisë.

Mirëpo, ajo, ndërsa vishej në heshtje në ato raste, më shikonte frikësueshëm si fëmija ose dhembshëm me rezinjim.

Një ditë biseda qe më me vrer sesa zakonisht. Unë e lëshova një fjalë të tmerrshme. Marisë iu nda fryma dhe u shtang. Pastaj nisi ngadalë e në heshtje të vishet pas paravanit të modeleve, ndërsa unë shtyhesha midis urrejtjes e pendimit, u çova vrap t'i kërkoj ndjesë, ia pashë fytyrën e larë në lotë. Nuk dija ç'të bëja: ia putha sytë dashunisht, i kërkova me përulësi ndjesë, qajta para saj, e akuzova veten se jam përbindësh mizor, i padrejtë dhe hakmarrës. Dhe kjo gjë zgjati derisa i shiheshin gjurmët e dëshpërimit, mirëpo, sapo ajo qetësohej dhe i ravizohej buzëqeshja e gëzueshme, zuri të më dukej se ishte e panatyrshme që nuk i zgjati edhe më pikëllimi: mundi të fashitet, por ishte gjë krejtësisht e dyshimtë që ajo përqafoi menjëherë gëzimin, mbasi ia thashë, më bëhej, atë fjalë, çdo grua do të ndihej e poshtëruar sikur ta kualifikonte ashtu, madje edhe vetë lavirja, andaj asnjë femër nuk do të mund ta ndërronte disponimin, të bëhej e hareshme, vetëm *nëse nuk është e vërtetë ajo që thashë për të.*

Skena të njëjta përsëriteshin gati çdo ditë. Hera-herë përfundonin me paqje relative dhe atëherë dilnim të shetitnim në Sheshin Franca si dy të rinj të dashuruar, duke biseduar për artin figurativ, muzikë dhe nuk ndodhte rrallë që ajo të më këndonte ngadalë ndonjë ajri. Mirëpo, çastet e tilla të sensibilitetit ishin për herë e më të rralla e më te shkurtëra, si reflekset e kalueshme të diellit në qiellin për herë e më të stuhishëm e të errët. Dyshimet dhe provat e mia, mbështillnin çdo gjë, si ndonjë liken që mbështjell dhe i prredh drunjtë e ndonjë parku me rrjetin monstruoz.

XVII

Pyetjet e mia bëheshin për ditë e më të shpeshta, më të zvetnuara për shkak të heshtjes së saj, shikimeve, fjalëve që nuk i zinin vend, se shkonte në çiflig, të dashurive të saj. Një herë e pyeta pse thirrej ende „zonjusha Iribarneo", në vend të „zonja Alende". Buzëqeshi e tha:

— Sa fëmijë që je! A është me rëndësi?

— Kjo është, për mua, shumë me rëndësi — u përgjigja duke e shikuar ngultas në sy.

— Ky është zakon familjar — u përgjigj duke e ndërprerë gazin.

— Herën e parë kur thirra në shtëpinë tënde — ia ktheva — e nuk ka dyshim dhe pyeta për „zonjushën Iribarneo", shërbëtorja u ndërdysh për një çast para se të më përgjigjej,

— Të është dukur.

— Mund të jetë; mirëpo, pse nuk më korrigjoi?

Maria zuri prapë të qeshë, por më fort.

— Po, a të tregova — tha — se ky është zakoni ynë, andaj edhe shërbëtorja e di këtë. Të gjithë më thërrasin Maria Iribarneo.

— Maria Iribarneo më duket më natyrshëm. Mirëpo, më duket më pak e natyrshme që shërbëtorja habitet aq pak kur të thërrasin „zonjushë"?

— Oh ... nuk e kam vëneruar se kjo gjë të ka befasuar. Mirë, kjo gjë nuk është e zakonshme dhe me këtë, ndoshta, shpjegohet ndërdyshja e shërbëtores.

U zhyt në mendime thuajse hera e parë që e hetoi problemin.

— Por, megjithatë, nuk më përmirësoi — vazhdova.

— Kush? — pyeti si duke ardhur më vete.

— Shërbëtorja. Nuk më korrigjoi përkitazi me atë „zonjushë"!

— Por, Huan Pablo, krejt këto nuk kanë kurrfarë rëndësie dhe nuk di ç'po do me këtë?

— Dua të të tregoi se ajo nuk ishte hera e parë që të thërrasin „zonjushë"! Sikur të ishte hera e parë, shërbëtorja do të më korrigjonte.

Maria nisi të qeshë.

— Po kjo është fantastike — tha hareshëm, duke më përgëdhelur dashunisht.

Isha serioz.

— Përveç kësaj — vazhdova — kur m'u përgjigje herën e parë, zërin e kishe të pacaktueshëm, thuaja, zyrtar, derisa nuk e mbylle derën. Pastaj vazhdove të bisedosh me zë të ëmbël. Nga erdhi gjithë ky ndryshim?

Por, Huan Pablo — u përgjigj duke mbledhur seriozitetin — po si mund të flisja ashtu me ty para shërbëtores?

— Po, kjo është e kuptueshme; por pate thënë: „Kur ta mbyll derën, e dinë se nuk duhet të më trazojnë". Kjo fjali nuk kishte të bëjë me mua, sepse unë fola atëherë për herë të parë me ty. Poashtu nuk kishte të bëjë as me Hunterin, sepse atë mund ta shohesh sa herë që të duash në çiflig. Më bëhet, qartë, se ti bisedon ose do të kesh biseduar edhe me persona të tjerë. A nuk është kështu?

Maria më shikoi me dhembshuri.

— Do të bëje më mirë të më përgjigjesh sesa të më shikosh me dhembshuri — shtova idhshëm.

— Por, Huan Pablo, krejt këto që po thua janë dokrra fëmijësh! Është e qartë se flas edhe me persona të tjerë: kushërinj, dashamirë të familjes, me nënën, ku ta di...

— Mirëpo, për biseda të asaj natyre nuk ka nevojë të fshihesh!

— E kush të lejon ty të thuash se po fshihem !— u përgjigj me athtim.

— Mos u trazo! Ti më tregove vetë në një rast për njëfarë Rikardi, të cilin nuk e ke as kushëri, as dashamir të familjes, as nëna jote...

Maria ishte si e vrarë.

— I mjeri Rikard — tha ëmbëlsisht.

— Pse i mjeri!

— Ti e di fort mirë çka i ndodhi dhe edhe unë jam deri-diku fajtore. Më pat shkruar letra të tmerrshme, por nuk kam mundur kurrë as kaq të bëj për të. Rikardi i mjerë!

— Kisha dashur të ma lexosh ndonjë prej letrave të tij.

— Ç'e do, ndërsa është i vdekur.

— Nuk është me rëndësi, megjithatë, kisha dashur.

— Të gjitha i kam djegur.

— Pse nuk më the menjëherë se i ke djegur? Jo, por më the: „Ç'e do, ndërsa është i vdekur"? Gjithmonë njësoj. E, përveç kësaj, nëse i ke djegur përnjëmend, më trego pse? Një herë më pate thënë në besim se i ruan të gjitha letrat e dashurisë sate. Letrat e atij Rikardit ndërsa i dogje do të kenë qenë tepër kompromituese. Apo jo?

— Nuk i dogja pse ishin kompromituese, por pse ishin të dhembshme. Më deprimonin. Nuk e di... Rikardi ka qenë njeri depresiv. Të përngjante bukur shumë ty.

— Ke qenë e dashuruar në të?

— Të lutem...

— Çka të lutem?

— Mos, Huan Poblo, çdo mendim i yti...

— Nuk po shoh se është i paarsyeshëm. U dashurua, të shkroi letra aq të tmerrshme sa ko-

nsideron se është më mirë t'i djegësh, vritet, ndërsa ti mendon se mendimi im është i paarsyeshëm. Pse?

— Sepse, përkundër kësaj, nuk kam qenë kurrë e dashuruar në atë.

— Pse nuk ke qenë?

— Nuk e di, përnjëmend nuk e di. Ndoshta pse nuk ka qenë tipi im.

— Po ti the se më përngjante mua.

— Për hatër të zotit, desha të them se të përngjante ty në njëfarë dore, por nuk ishte edhe identik. Ai ka qenë njeri i paaftë të krijojë — çkadoqoftë, ka qenë destruktiv, ka qenë nihilist, me inteligjencë shkatërrimtare. Diqysh si ana jote negative.

— Mirë. Por, nuk po e shoh edhe më tutje arsyen pse i dogje letrat.

— Po të them prapë se i dogja pse më deprimonin.

— Mirëpo, a nuk munde t'i ruash e të mos i lexosh. Kjo vetëm tregon se i ke lexuar shumë herë derisa nuk i dogje. E, nëse i ke lexuar aq shumë herë, dorëmenjë, jo pa arsye. Për shkak të diçkasë së tij që të ka tërhequr.

— Nuk thashë se nuk më ka tërhequr.

— Po a the se nuk ka qenë tipi yt?

— O zot! O zot! Rikardi më tërhiqte siç më tërheq vdekja ose asgjësia. Dhe, besoj, se njeriu nuk duhet t'u dorëzohet ndjenjave të tilla pasivishi. Ndoshta, nuk e kam dashur për këtë arsye. Prandaj i dogja letrat e tij. Kur vdiq, vendosa të zhduk çdo gjë që e vazhdonte ekzistencën e tij.

Ndonëse ishte trazuar nuk ia dola të nxjerr assesi asnjë fjalë për Rikardin. Mirëpo, duhet të shtoj se ai nuk më mundonte shumë, sepse, fundi i fundit, për të mësova mjaft. Më mundonin personat e panjohur, hijet që nuk i zuri kurrë ngoje e, të cilat, ndjeja se po silleshin lehtë e gjithqysh nëpër errësirë, në jetën e saj. Për Marinë pandehja gjërat ma të liga, shi me këto hije anonime. Më

mundonte, po edhe tash më mundon ende fjala që i shpëtoi prej goje në një çast të dashurisë fizike.

Mirëpo, ndër të gjitha këto pupuritje të ndërlikuara, ishte një që hodh dritë të tmerrshme në Marinë dhe dashurinë e saj.

XVIII

Ishte logjike të pandehej se ndonjëherë do të ketë ndjerë diçka edhe për Alenden, ndërsa ishte martuar për të. Duhet të them se ky problem, të cilin do të mund ta quaja „problemi Alende", ishte një prej atyre që më tundonte më së shumti. Ishin një varg enigmash që dija t'i sqaroja e, sidomos këto dy: a e deshi ndonjëherë? A e do ende? Këto dy çështje nuk bënte të merreshin ndaras; këto lidheshin me çështje të tjera: nëse nuk e ka dashur Alenden, kë e ka dashur? Mua? Hunterin? Ndonjërin prej atyre personave misteriozë që e thërrisnin me anë të telefonit? Kjo ishte. ndoshta, e mundur se do më shumë persona në mënyra të ndryshme, ashtu si u ndodh ca njerëzve, tek e mbramja. Mirëpo, ishte, po ashtu, e mundur se *nuk e donte askë* dhe se secilit prej nesh, vocëve, djajve të mjerë, na thotë: ti je *i vetmi,* kurse të tjerët janë hije të zakonshme, qenie me të cilat mbante kontakte sipërfaqësore ose të dukshme.

Një ditë vendosa ta sqaroj problemin Alende. E ngava me pyetjen pse u martua me Alenden?

— E kam dashur — u përgjigj,

— Domethënë se tash nuk e do më?

— Nuk thashë se tash nuk e dua më — u përgjigj.

— Po the: „e kam dashur". Nuk the: „e dua".

— Ti e zë gjithnjë fjalën në zgrip dhe e shtrembëron deri në relativitet — protestoi Maria. — Kur thashë se u martova pse e desha, nuk desha të them se tash nuk e dua.

— Oh, atë po e dashke, pra! — thashë me të shpejtë si të doja ta zë në gabim përkitazi me deklaratat e dhëna gjatë pupuritjeve të mëvonshme.

Heshte. Dukej si e vrarë.

— Pse nuk po përgjigjesh — pyeta?

— Sepse po më bëhet se nuk ka tagër. Këtë bisedë e bëmë shpesh gati në mënyrë të njëjtë.

— Jo, kjo nuk është si të mëparshmet. Të pyeta a e do tash Alenden dhe më the: po. Më duket se më kujtohet, në një rast tjetër, më pate thënë, në liman, se unë jam personi i parë të cilin e do.

Maria heshte prapë. Më zemëronte jo vetëm pse ishte plot kundërshti, por edhe pse duhej mund për t'ia nxjerrë çfarëdo deklarate.

— Ç'thua për këtë? — pyeta prapë.

— Ka shumë mënyra për të dashuruar dhe për të dashur — u përgjigj dërmueshëm. — Ndoshta kujton se Alenden nuk mund ta dua në mënyrë të njëjtë si para disa vitesh, kur u kurorëzuam.

— Në ç'mënyrë?

— Qysh, në ç'mënyrë? E di ç'dua të them!

— Nuk di asgjë.

— Po të kam treguar shpesh.

— Për të folur, po... po shpjegua, jo.

— Shpjegua! — klithi me indinjim. — Po ti vetë më ke thënë nja njëmijë herë se ka shumë sende që nuk lënë shteg për t'u shpjeguar, kurse tash më thua ta shpjegoj një gjë aq të ndërlikuar. Të kam thënë më se njëmijë herë se Alenden e kam shok të mirë, shumë të ngushtë; se e dua si vëlla, se kujdesem për të, se ndiej ndaj

tij shumë suptilitet, se admiroj seriozitetin e spiritualitetit të tij, se më duket superior në çdo pikëpamje ndaj meje, se para tij ndihem si qenie e mjerë dhe mëkatare. Si po mundesh, pra, të pandehësh se nuk e dua?

— Nuk jam unë ai që tha se nuk e do. Ti vetë the se tash nuk je njësoj si kur je martuar, Ndoshta, është dashur të konkludoj se e ke dashur kur je martuar, si tha tash se më do mua. Në anë tjetër, para disa ditësh më the në liman se unë jam përsoni i parë të cilin e do përnjëmend.

Më shikoi me dhembshuri.

— Mirë, ta lëmë anash këtë kundërthënie — vazhdova, — Por, ta marrim punën e Alendes. Po thua se e do si vëlla.. Tash dëshiroj t'i përgjigjesh vetëm kësaj pyetjeje: a ke marrëdhënie fizike me të?

— A është nevoja t'i përgjigjem kësaj pyetjeje?

— Po, është më se e nevojshme — thashë prerazi.

— Më duket gjë e tmerrshme që po më pyet në këtë mënyrë.

— Kjo është fare thjesht: duhet të thuash „po" ose jo".

— Përjegjia nuk është aq e thjeshtë: mund të kem ose të mos kem.

— Shumë bukur — konkludova ftohtazi. — Kjo do të thotë: po.

— E, pra, mirë: po.

— Kjo do të thotë se e dëshiron.

I thashë kështu duke e shikuar me kujdes ndër sy; këtë e bëra qëllimkeqazi, sepse ishte mënyra më e mirë për të nxjerrë një varg konkludimesh. Nuk besoja se e dëshironte përnjëmend (ndonëse edhe kjo ishte e mundur duke e pasur parasysh temperamentin e Marisë), por doja ta detyroj ta shpjegojë atë „e dua si vëlla". Maria ngurronte, ashtu si pritja, të përgjigjej. Sigurisht kërkonte fjalën më të përshtatshme.

Më në fund, tha:

— Thashë se me të kam marrëdhënie, por jo se e dëshiroj.

— Oh! — klitha triumfalisht. — Kjo do të thotë se ke marrëdhënie edhe pse nuk e dëshiron, por e mban me bindje se e dëshiron.

Maria u shtang, Lotët i rridhnin nëpër faqe. Shikimi i gjasonte qelqit të thyer.

— Nuk thashë ashtu — nënëriti ngadalë.

— Andaj, kjo është evidente — vazhdova pa mëshirë — sepse të kishte dhënë farë shenje se nuk ndien asgjë, se nuk e dëshiron, të kishe treguar si bashkimi fizik është sakrificë që po bën për hatër të dashurisë së tij, nder e admirimit ndaj spiritualitetit të tij sublim e tjera kësisoj. Alende nuk do të kishte rënë kurrë me ty. Me fjalë të tjera: fakti se po bën edhe më tutje tregon se ti je në gjendje ta mashtrosh jo vetëm në pikëpamje të emocioneve tua, por madje edhe në pikëpamje të sensibilitetit tënd, dhe se je në gjendje ta luash në mënyrë të përkryer kënaqësinë.

Maria, duke qarë ngadalë, as që e ngriti kryet.

— Ti je jashtëzakonisht mizor — në fund ia doli të thotë.

— Ta lëmë anash shqyrtimin e formës: mua më intereson thelbi. Është themelore se ti je në gjendje ta mashtrosh vite me radhë burrin tënd jo vetëm në pikëpamje të ndjenjave tua, por edhe në pikëpamje të sensibilitetit tënd. Do të kisha mundur, madje, të nxjerr përfundim: pse të mos më mashtrosh edhe mua? Tash e kupton pse e pupuris shpesh intimitetin e suptilitetit tënd. Më kujtohet vazhdimisht si ia tërheq babai i Dezdemonës Othellos vërejtjen se një grua që e mashtron babanë, mund ta mashtrojë edhe një njeri tjetër. Ndërsa mua asgjë nuk mund të ma qesë nga mendja faktin se ti po e mashtron vite me radhë, pandërprerje Alenden.

Për një çast më pushtoi dëshira të bëhem mizor deri në skaj, andaj shtova, sigurisht do të kem qenë i vetëdijshëm se kjo ishte vullgare dhe fjalërende.

— Një të verbër!

XIX

Edhe para se ta shqiptoja këtë fjalë, u pendova thuaja se pak. Në veten time — ajo që deshi ta shqiptojë këtë fjalë dhe të përftojë kënaqësi perversive — ajo qenia tjetër më e pastërt dhe sensibile, ishte e gatshme të marrë iniciativën nëse mizoria e fjalisë e bën efektin e vet, dhe ishte, në njëfarë mënyre, pahetueshëm në anën e Marisë para se ta shqiptoja këtë fjali gabërruese e të panevojshme (çka munda në të vërtetë të mbërrij me atë). Kështu që, kjo qenie i dëgjonte prej së brendshmi me tmerr sapo zunë të dalin prej gojës sime, përkundër kësaj, si të mos besonte seriozisht se ishte e mundur që qenia tjetër i përdori. Dhe, duke dalë ashtu, filloi ta sundojë ndërgjegjen e vullnetin tim e, thuajse, vendimi i saj arriti ta pengojë me kohë fjalinë të dalë komplete. Sapo e shqiptova (sepse, përkundër kësaj, e kreva fjalinë), ushtroi pushtetin e vet plotësisht në mua dhe kërkoi prej meje të lypë ndjesë, të poshtërohem para Marisë, ta pranojë gabërrinë dhe mizorinë time. Sa e sa herë qe kjo dasi e mallkuar e ndërgjegjes shkaktare e ngjarjeve të tmerrshme! Ndërsa një anë më shtynte të bëja vepra të mrekullueshme, tjetra më padiste për mashtrime, dyfytyrësi dhe

mirëbërësi të rrejshme; ndërsa njëra më shtynte të fyejë ndonjë qenie njerëzore, tjetrës i dhimbsej dhe më padiste po për atë gjë që unë i akuzoja të tjerët: ndërsa njëra më bënte të mundur të shoh sa është bota e mrekullueshme, tjetra më tregonte sa është ajo e shëmtuar dhe se është qesharake çfarëdo ndjenje e lumturisë. Dhe, se ishte, përkrye të kësaj, tepër vonë që në shpirtin e Marisë të shërohej plaga e hapur (e këtë ma dëshmonte pa zë, si nga largësia, ai uni im tjetër i kënaqur me dashaligësi, i cili ishte zhytur në njëfarë strofulli kundërmues), po, ishte tepër vonë. Maria u drejtua, krejtësisht e dërmuar, pa thënë asnjë fjalë, ndërsa shikimi (sa mirë e njihja) e çonte urën e lëvizshme, të cilën e lëshonte hera-herë ndërmjet shpirtërave tonë: ishte ky shikim i krodhshëm i syve të papërshkueshëm. Megjithatë më pushtoi mendimi se kjo urë u ngrit përgjithmonë dhe në valën e papritur të dëshpërimit nuk u ndërdysha t'u nënshtrohem poshtërimeve më të mëdha: për shembull, t'ia puth këmbët. Ia dola vetëm që të më shikojë me dhembshuri dhe shikimi t'i zbutet vetëm për një çast. Mirëpo, vetëm prej mëshirës, prej mëshirës. Derisa doli prej ateliesë, u përpoq të më bindë edhe një herë se ajo nuk mori hidhërim në mua, ndërsa unë u krredha në inprezencën e plotë të vullnetit. Nuk dija ç'të bëja, rrija në mjedis të ateliesë dhe shikoja si i lafituri në një pikë. Ndërkaq përnjëherë, nuk e kuptova se është dashur të bëj një varg sendesh.

— Dola vrap në rrugë, por Maria nuk ishte askund. U nisa shpejt me taksi kah shtëpia e saj, sepse pandehja se ajo nuk do të shkojë drejt në shtëpi e, prandaj, pritja se do ta takoj në të ardhur. Prita kot më se një orë. E thirra me anë të telefonit prej një kafeneje; më thanë se nuk ishte në shtëpi dhe se nuk u kthye prej orës katër, në të vërtetë qysh kur ishte nisur në atelienë

time). E prita edhe disa orë. Pastaj thirra prapë me anë të telefonit: më thanë se Maria nuk do të kthehet në shtëpi deri natën vonë.

I tmerruar dola ta kërkoj në të gjitha anët, desha të them në vendet ku takoheshim ose shetisnim rëndom: Rekoleta, Avenida Sentanario, Sheshi Franca, Lamani i Ri. Nuk e pashë askund; e kuptova se ishte më se e besueshme se tash shetiste kahdo, vetëm jo në vendet që ia kujtonin çastet tona më të bukura. Prapë u nisa vrap deri te shtëpia e saj, por ishte tepër vonë dhe ajo ishte kthyer me siguri. Prapë e thirra me anë të telefonit: njëmend ishte kthyer, por më thanë se kishte rënë dhe se ishte e pamundur të vijë deri te telefoni. Megjithatë, e lashë emrin

Diçka u thye midis nesh.

XX

U ktheva në shtëpi i kapluar nga ndjenja e vetmisë së plotë. Kjo ndjenjë, se je vetëm në botë, paraqitej kryesisht e përzier me ndjenjën e krenarisë së superioritetit: i zhvleftësoj njerëzit, më duken të ndyrë, të shëmtuar, të paaftë, ziliqarë të thjeshtë, koprracë; nuk më frikëson vetmia ime, ajo është, thuaja, olimpike.

Mirëpo, në atë çast, si dhe në çastet e tjera kësijoj, ndihesha i vetmuar për shkak të vjetëve të mia, për shkak të veprave të pamira. Në raste të tilla më bëhet se bota është e denjë për urrejtje, por e kuptoj se edhe unë jam pjesë e saj. Në momente të tilla më pushton tërbimi i vetëzhdukjes, përkundem në sprovim të vetvrasjes, dehem, kërkoj prostitutat ... Dhe ndiej njëfarë kënaqësie duke dëshmuar poshtërsinë personale, duke vërtetuar se nuk jam më i mirë se përbindëshit e ndyrë që më rrethojnë.

Atë natë u deha në një pijetore të zakonshme. Isha bërë dardhë kur ndjeva neveri të hatashme ndaj femrës që ishte me mua dhe me marinarë që më rrethonin, andaj dola vrap në rrugë. Ecja nëpër Viamonte dhe zbrita deri në liman. Atje u ula dhe ia plasa vajit. Uji i ndyrë poshtë më vinte pandërprerje në sprovim. Për

ç'vuajtja? vetëvrasja e vë njeriun në sprovim për shkak të asgjasimit të lehtë: për një çast e tërë kjo botë absurde shembet si ndonjë hije gjigande, si të ishte forcë e rrokaqiejve të saj, e luftanijeve të saj, e tankeve, e burgjeve vetëm një iluzion në të cilën janë të fortë vetëm rrokaqiejtë, luftanijet, tanket dhe burgjet nga ndonjë ankth.

Jeta në dritën e përsiatjeve të këtilla si ndonjë ankth i gjatë prej të cilit njeriu nuk mundet, megjithatë, të lirohet me vdekje, e cila do të ishte si njëfarë zgjimi. Mirëpo, pse zgjimi? Kjo luhatje që të rreknehem në asgjë prore dhe absurde më ndalte në të gjitha planet e vetvrasjes. Përkundër kësaj, njeriu është aq shumë i lidhur për atë që ekziston, sa, në fund, do ta durojë papërsosmërinë dhe shembjen e saj që sjell shëmtia sesa të zhdukë iluzionin me një akt të vullnetit personal. E poashtu ndodh shpesh që — kur të arrijmë deri në zgrip të dëshpërimit, i cili i paraprin vetëvrasjes, mbasi ta kemi shterrur krejt atë që është e keqe dhe kur mbërrijmë deri te pika që nuk mund të zotërohet — çfarëdo qoftë elementi i së mirës, madje sado i vogël që të jetë, fiton vlerë të pamatshme, bëhet vendimtar dhe kapemi për të, ashtu si kapet i dëshpëruari për çfarëdo barishte kur të jetë në rrezik të rreknehet në ndonjë humnerë.

Thuaja gati ishte gdhirë kur vendosa të kthehem në shtëpi. Nuk di se qysh, por, përkundër këtij vendimi (i cili më kujtohet shumë mirë) papritmas u gjenda para shtëpisë së Alendes. Është interesant — nuk më kujtohet fare — ç'ndodhi në ndërkohë. Në liman, shikoja ujin e ndyrë dhe mendoja: „tash duhet të shkoj të fle", dhe, krejt papritmas, u gjenda para shtëpisë së Alendes, ku ia kisha ngulur sytë katit të pestë. Pse shikoja? Është marrëzi edhe të pandeh se në atë kohë do të kisha mund ta shoh. Shumë kohë ndenja ashtu i trallisur, ndërsa nuk më shkrepi ideja: të zbres deri në aveny, ta gjej

ndonjë kafene dhe prej andej ta thërras me anë të telefonit. Kështu edhe veprova, por pa menduar fare çka të them për t'u arsyetuar që po thërras në atë kohë. Kur u përgjigj dikush pas pesë minutash të cingërrimës, u shtanga dhe nuk bëra as vër me gojë. Në atë frikësim paniku e vera rezeptorin, dola prej kafenesë dhe u nisa ku këmbët kryet. Papritmas u gjenda prapë në kafene. Për të mos rënë në sy, porosita një raki dëllinje dhe, ndërsa e piva, vendosa të kthehem në shtëpi.

Pas një kohe bukur të gjatë, dikur, arrita në atelie. Si isha i veshur, u hodha në shtrat dhe më zuri gjumi.

XXI

U zgjova dhe, në përpjekje e sipër që të bërtas, papritur u gjenda në këmbë, midis ateliesë. Pashë këtë ëndërr: disa vetë u desh të shkonim në shtëpi të një zotërie, i cili na kishte ftuar. Erdha para shtëpisë, e cila dukej nga jashtë si çdo shtëpi tjetër, dhe hyra brenda. Po në atë moment kur hyra, isha i sigurt se nuk ishte ashtu. Ndryshonte prej shtëpive të tjera. Pronari më tha:

— Juve ju pritja.

Hetova se rashë në njëfarë kurthe dhe desha të ikë. U përpoqa me të madhe, por ishte vonë: trupi nuk ma donte dëgjesën. U pajtova me këtë për të parë se ç'do të ndodhë, si të ishte diçka për mes që nuk kishte të bëjë me mua. Ai njeriu zuri të më shndërrojë në zog, zog të madh sa njeriu. Nisi prej këmbëve: pashë se këmbët më shndërroheshin pak nga pak në këmbë gjeli apo diçka asisoj. Kjo gjë vazhdoi edhe në transformimin e krejt trupit prej këmbëve deri në maje të kresë ashtu si kur të vijë uji në basen. Tash e vetmja shpresë që më kishte mbetur ishin miqtë, të cilët, nuk e di për çfarë arsye, nuk vinin kurqysh. Kur arritën, më në fund, diçka ndodhi që më shastrisi: ata nuk vëneruan se isha

transformuar. Silleshin ndaj meje si rëndom, çka ishte dëshmi se më kishin parë gjithmonë të atillë si isha. Duke menduar se magjistari i kishte hipnotizuar që më shihnin ashtu si person normal, vendosa t'u tregoj se ç'më kishte bërë. Ndonëse e kisha ndërmend t'ua tregoj qetas këtë fenomen, për të mos e nxitur magjistarin me reaksion tepër të fortë (gjë që do ta nxiste të bëjë diçka edhe më të zezë) nisa të flas me tërë zërin. Atëherë i vënerova dy sende të pabesueshme: fjalia që desha ta them u shndërrua në krokatje të vërtetë, krokatje dëshpëruese dhe të çuditshme, ndoshta për shkak se ngërthente më vete diçka njerëzore e, çka ishte edhe më keq, miqtë e mi nuk e dëgjuan atë krokatje, ashtu si nuk e vëneruan trupin tim në formë të zogmadhit; përkundrazi, dukej se dëgjonin zërin tim të zakonshëm, zërin e të folurit të zakonshëm, sepse nuk treguan në asnjë çast as shenjën më të vëgël të shastrimit. Heshta i frikësuar. Pronari i shtëpisë më shikoi atëherë me shkëlqim çinimi ndër sy, thuaja të pakuptueshëm, të cilin munda ta ajgtoj vetëm unë. Në atë çast e kuptova se *askush* nuk do ta marrë vesh *kurrë* se u shndërrova në zog. Isha i humbur përgjithmonë, ndërsa fshetësinë do ta marr bashkë me vete në varr.

XXII

Si thashë, kur u zgjova, u gjenda në midis të dhomës në këmbë, i tëri i kapluar nga djersa e ftohtë.

Shikova orën: ishte dhjetë para dreke. Nxitova te telefoni. Më thanë se kishte shkuar në çiflig. Isha si i vrari. Bukur shumë kohë nuk u çova prej shtratit, nuk mund të vendosja për asgjë, ndërsa nuk vendosa, më në fund, të shkruaj një letër.

Tash nuk më kujtohen saktë fjalët e asaj letre fort të gjatë, por i shkrova përafërsisht për ndjesë, se jam pleh, se nuk e meritoja dashurinë e saj, se jam i denuar me të drejtë të vdes në vetminë më të madhe.

Kalonin ditë të tmerrshme, kurse përgjegjia as që mbërrinte. I dërgova letrën e dytë, edhe të tretën, mandej të katërtën, duke i thënë gjithnjë të njëjtën gjë, por edhe çdo herë e më pak ngushëlluese. Në letrën e fundit vendosa t'i tregoj krejt çka ndodhi atë natë mbasi u ndamë. Nuk lash as detajet pa përfshirë, as poshtërsitë, ashtu si nuk lashë pa i pranuar se isha në sprovim të bëj vetëvrasje. Më vinte turp këtë ta përdor si mjet, megjithatë e përdora. Duhet të shtoj se më kapi një suptilitet ndaj vetvetes de-

risa shkruaja për ato poshtërësi që i kisha bërë dhe dëshpërimin tim që rridhte nga vetmia atë natë para shtëpisë së saj në Rrugën Posadas, se kisha qarë madje nga vetëmëshira. Kisha shpresë se Maria, duke e lexuar këtë letër, do të ndjejë diçka kësisoj, dhe kjo shpresë më kthjelloi bukur shumë. Thënë sinqerisht, kur e dërgova letrën rekomande, isha optimist.

Si përgjegje të Marisë mora letrën plot sensibilitet. Ndjeja se diçka do të përsëritet nga çastet e dashurisë sonë, po qe se jo me atë tejdukshmëri të mrekullueshme origjinale, atëherë, pra, me dofarë veçori qenësore, përafërsisht si është fundi gjithmonë fund, edhe pse aktet e pabesë e përfidë e tradhtuan dhe e ndyrën.

Kërkonte të shkoj në çiflig, E përgatita shpejt valixhen dhe kutinë me ngjyra dhe u nisa vrap si i trentë në stacion Konstitusion.

XXIII

Stacioni Alende është ndër ata stacione të fshatrave me nga disa njerëz, me shefin në këmishë, një makinë dhe ca teneqe me qumësht.

Më zemëruan dy gjëra: prania e shoferit dhe imprezenca e Marisë.

Mbasi zbrita m'u afrua shoferi dhe më pyeti:

— Ju jeni zotëri Kasteli?

— Jo — u përgjigja seriozisht. — Nuk jam zotëri Kasteli.

Më shkoi ndërmend se do të jetë vështirë ta pres trenin në stacion për t'u kthyer: mund të vonohej gjysmë dite ose aq përafërsisht. Vendosa, çartaqejt, ta pranoj identitetin tim.

— Po — shtova thuaja me një frymë. — Unë jam zotëri Kasteli.

Shoferi më shikoi i llahtarisur.

— Mbajeni — i thashë, duke ia dhënë valixhen dhe kutinë e ngjyrave . . .

Erdhem deri tek automobili.

— Zonja Maria nuk ndihej mirë — më shpjegoi shoferi.

„Nuk qenka ndier mirë" — nënërita ngadalë. Ih, si i dija pretekset e tilla! Prapë më pushtoi mendimi që të kthehem në Buenos Aires, por

tash, pos që duhej ta pritja trenin, ishte edhe një punë tjetër: nevoja që ta bind shoferin se unë nuk jam përnjëmend Kasteli, ose, ndoshta, nevoja që ta bind, edhe pse jam Kasteli se nuk jam i trent. I shoshita shpejt e shpejt mundësitë e ndryshme që më ranë në mend dhe nxora përfundimin se do të ishte kryekëput vështirë ta bind. Vendosa të hip dhe të më çojë në çiflig. Tekembramja, ç'do të ndodhte në rast se kthehesha? Nuk ishte vështirë të supozohej se kjo do të ishte përtëritje e shumë situatave të mëparshme: do të isha mbushur tërbim edhe më të madh për shkak se nuk do të mund ta zbrazja në Marinë, do të kisha vuajtur që nuk e pashë, nuk do të mund të punoja dhe krejt këto për nder që ta mundoj eventualisht Marinë. Po them *eventualisht*, sepse nuk më shkoi kurrë për dore të konstatoj se a e mundonin represaljet e këtilla.

Hunteri kishte njëfarë gjasimi me Alenden (më duket se thashë janë kushërinj të parë), ishte i gjatë, zeshkan, më shumë i thatë, por me shikim të pazënë vend. „Ky njeri është pa vullnet dhe dyfytyrësh" — mendova. Ky konstatim më kthjelloi (kështu mendova, të paktën, në atë çast).

Më priti me njerëzi ironike dhe ma prezentoi një grua të thatë, e cila pinte duhan me cigarallëk shumë të gjatë. Kishte diksion parisien, quhej Mimi Alende, ishte e krahejtë dhe dritëshkurtër.

Po, ku dreqin, ishte Maria? A përnjëmend nuk ndihej mirë? Aq shumë e dëshiroja sa, thuaja, harrova praninë e këtyre qenieve. Mirëpo, kur më shkoi papritmas ndërmend pozita ime, u ktheva shpejt kah Hunteri për ta *vështruar*. Kjo është metodë që jep sado-kudo rezultate me persona të tillë.

Hunteri më vështronte me shikimin e tij ironik, të cilin u përpoq ta ndërrrojë shpejt.

— Maria nuk po ndihet mirë, andaj shkoi e ra — tha. Mirëpo, besoj se do të zbresë së shpejti.

Mallkoja veten që isha trullosur: ndaj këtyre njerëzve duhet të jesh gjithnjë syçelët; vërveç kësaj, pata vendosur rrast që ta njoh mënyrën e tyre të të menduarit, mahitë e tyre, reaksionet e tyre, emocionet e tyre: krejt këto do të më ndihmonin tepër për Marinë. Nisa, pra, *të dëgjoj e të sodis* dhe përpiqesha këtë ta bëj në disponim të mundshëm e sa më të mirë. Mendova prapë se më gëzonte dukja e përgjithshme hipokrite e Hunterit. Por, megjithatë, disponimi im ish i zymtë.

— Ju jeni, pra, piktor? — tha gruaja dritëshkurtër, duke më shikuar me sy gati të mbyllur, ashtu si picërrohen kur era sjell pluhur. Ky gjest, i shkaktuar dorëmenjë nga nevoja që të zvogëlojë dritëshkurtësinë pa syze (sepse me syze do të dukej edhe më e vështirë), kontribuojë që të duket edhe më tepër krenare dhe dyfytyrëshe.

— Po, zonjë — u përgjigja idhshëm. Isha i sigurt se ishte e pamartuar.

— Kasteli është piktor i rrallë — ndërhyri Hunteri. Pastaj shtoi një sërë marrëzish si lavdërime, duke përsëritur gabërritë që kishin thënë kritikët gjithnjë për mua kur ekspozoja: „solid" e kështu diqysh. Nuk mund të mohoj se, duke i përsëritur këto mendime të përputhshme, vinte e shihej trilli i tij për humor. E vënerova se Mimi më vështronte me sytë e saj gati të mbyllur dhe u bëra bukur nervoz duke pritur se do të flasë për mua. Nuk e njihja ende mirë.

— Cilët piktorë i doni më së shumti? — pyeti si farë hetuesi.

Jo, tash më kujtohet, për këtë më pyeti mbasi zbrita, sapo Hunteri ma prezentoi këtë femër, e cila rrinte në kopsht, pranë një tavoline, në të cilën ishte shtruar çaji, Hunteri më shtiri brenda, në dhomë që e kishin caktuar për mua. Du-

ke u ngjitur (shtëpia ishte në dy kate), më tregoi se shtëpia, me ca modifikime, ishte krejt njësoj si e kish ndërtuar i gjyshi në çifligun e stërgjyshit. „Aq më bënte mua"! — mendova. Ishte qartë se më këtë deshi të më tregojë se është joformalist dhe i sinqert, edhe pse nuk e di pse? Ndërsa ai fliste diçka për orën, për diellin ose diçka përkitazi me diellin, unë mendjen e kisha te Maria se është, ndoshta, në ndonjërën prej dhomave lart. Për shkak të shikimit tim pyetës, Hunteri, ndoshta, më tha:

Këtu janë disa dhoma të fjetjes. Shtëpia është, në të vërtetë, mjaft komode, edhe pse u ndërtua në një stil mjaft tërheqës.

M'u kujtua se Hunteri ishte arkitekt. Duhej të shihej se ç'kuptonte me atë konstruksion tërheqës.

— Kjo është dhoma e fjetjes e vjetër e gjyshit, të cilën e përdor tash unë. — Më kallëzoi duke më treguar atë në midis, përballë shkallëve.

Pastaj hapi derën e një dhome të fjetjes pranë.

— Kjo është dhoma juaj — më tregoi.

Më la vetëm në dhomë dhe më tha se do të më presë poshtë të pijmë çaj. Sapo mbeta vetëm, zemra filloi të më rrahë fort duke menduar se Maria mund të jetë në ndonjërën prej këtyre dhomave të fjetjes, ndoshta edhe në atë pranë. Duke qëndruar në midis të dhomës, nuk dija ç'të bëj. Më shkrepi ideja: u afrova te muri që ndante dhomën time prej dhomës pranë (jo të Hunterit) dhe nisa t'i bie lehtë me llerë. Pritja përgjegjen, por nuk u dëgjua gjë. Dola në mesore, shikova a mos ishte kush, u afrova te dera anash dhe, ndërsa ndjeja një trazim të tmerrshëm, çova dorën të trokas. Më mungoi guximi dhe u ktheva vrap në dhomën time. Më vonë vendosa të zbres në kopsht. Isha shumë i lumtur.

XXIV

Në një çast, pranë tavolinës, ajo femra e ajthme më pyeti cilët piktorë i dua. I rendova ngathshëm ca emra: Van Gog. El Greko Më shikoi ironikisht dhe tha për vete:

— *Tiens.*[1])

Pastaj shtoi:

— Nuk i dua njerëzit tepër të mëdhenj. Mund të them — vazhdoi duke iu drejtuar Hunterit — se ata tipa, si Mikelangjelo ose El Greko, m'i dërmojnë nervat. Aq është agresive madhësia dhe dramatizmi! A nuk të dukej se kjo është mungesë e edukatës? Unë mendoj se artisti duhet t'i vërë vetes për detyrë që të mos tërheqë kurrë e për asgjë vëmendjen. Më fyejnë ekceset e dramatizmit dhe të origjinalitetit. Pse, të jesh origjinal a nuk do të thotë në të njëjtën mënyrë të publikosh mesataren e të tjerëve, kurse kjo, mendoj, tregon shije fort të dyshimtë. Mendoj se unë, sikur të merresha me pikturë, do të krijoja vepra që nuk do të tërheqin me asgjë e në asnjë moment vëmendjen.

---

[1]) Shih

— Nuk dyshoj aspak — tha Hunteri me shpirtligësi.

Pastaj shtoi:

— Jam i sigurt se nuk do të kishe dashur të shkruash, për shembull, *Vëllezërit Karamazovë.*

— Quelle horreul![1]) — Mimi klithi duke i çuar sytë kah qielli. Pastaj e kreu mendimin e vet:

— Duket se të gjithë intelektualët janë *nouveaux-riches*[2])... duke përfshirë edhe atë *moiine*[3]) a si quhet.. Zozime.

— Pse nuk thua Zozimo, Mimi: Vetëm nëse do ta thuash atë rusisht.

— A ia fillove tash me ato gabërrimet tua puritanë. Ti e di se emrat rusë mund të shqiptohen në shumë mënyra. Si thotë ai personazhi në një *farce*[4]).

— Tolstoj ose Tollstoji", cila prej këtyre dy mënyrave mund dhe duhet të përdoret".

— Sigurisht për atë — tha Hunteri — në një përkthim spanjisht, i cili më ra ta lexoj (sipas botuesit përkthimi direkt prej rusishtes) përdoret Tolstoi, duke vënë dy pika mbi i-në.

— Ah, i adhuroj — tha Mimi hareshëm. — Një herë më ra të lexoj Çehovin, në përkthim frëngjisht, ku mund ta gjeje fjalën, për shembull, si *ichvochnik* (ose disi kësisoj) me yll përmbi. Shikoj shpjegimin në fund të faqes dhe e gjej se ajo në atë rast domethënë *porteur*[5]). Merre me mend, njeriu, në atë rast, nuk është në gjendje t'ia shpjegojë vetes pse nuk vënë edhe në rusishte poashtu edhe fjalët *malgre*[6]) ose *avant*[7]).

---

[1]) çfarë tmerri!
[2]) ronxhobonxho.
[3]) murg
[4]) farsë
[5]) hamall
[6]) përkundër
[7]) para, përpara

Apo jo? Përkthyesit e tillë, po të them, më joshin, sidomos kur është fjala për romanet rusë. A ju pëlqejnë romanet rusë?

Këtë pyetje të fundit ma drejtoi pa paraparë mua, por nuk priti t'i përgjigjem dhe vazhdoi duke shikuar përsëri Hunterin.

— Merre me mend, kurrë nuk ia kam dalë të lexoj deri në fund ndonjë roman rus.. Aq janë të rëndë... Kanë me nga njëmijë personazhe dhe, në fund, del se janë katër ose pesë. Kuptohet, sa zë të mësohesh me ndonjë zotëri, i cili quhet *Alexandre,* del se thirret *Sacha,* e pastaj *Stachka* e *Sachenka* e pastaj në mënyrë grandioze *Aleksandre Aleksandrovich Bunine,* e më vonë thjesht *Aleksadre Aleksandrovitch.* Taman sa mësohesh, ata të hutojnë prapë. Kjo gjë nuk ka as fillim as mbarim: çdo personazh duket si një familje e tërë. Nuk thua, ndoshta, se kjo gjë nuk të lodh edhe ty.

— Prapë po të them, Mimi, se nuk ke arsye emrat rusë t'i shqiptosh frëngjisht. Pse në vend të Tchekhov nuk thua Çehov, gjë që është më afër origjinalit? Përveç kësaj, ajo „njësoj" është galicizëm i hatashëm.

— Mirëpo, për hatër të zotit, Luisito — lutej Mimi — mos u bën aq i mërzitshëm! Kur do të mësohesh ta fshehësh dijen tënde? Aq je i rëndë, aq *epuisant*[1]) ... a nuk ju duket? — e kreu fjalën duke m'u drejtua mua.

— Po — përgjigja, pa qenë madje i vetëdijshëm çka thashë.

Hunteri më shikoi ironikisht.

Isha shumë i pikëlluar. E këtej thonë se jam shumë i padurueshëm. Ende po mrekullohem si munda të dëgjoj me aq kujdes gjithë ato marrëzi e sidomos që më kujtohen me aq përpikëri. Është për t'u çuditur se, derisa i dëgjoja, përpiqesha të kthjellohem duke menduar: „këta qen-

[1]) rraskapitës, dërmues

kan të thjeshtë, të cekët. Njerëzit e këtillë vetëm mund t'ia shtojnë Marisë ndjenjën e vetmisë. *Njerëzit e këtillë nuk mund të jenë shemër*". E, megjithatë, nuk ia dola të kthjellohem. Ndjeja se dikush më porosiste nga thellësia mërzinë, u bëra tukeq, nervoz; aq më tepër, përpiqesha të fashitem, duke i premtuar vetes se kur të jem vetëm do ta analizoj këtë fenomen, Mendova poashtu se shkaku i kësaj mërzie mund të ishte mungesa e Marisë, por e hetova se kjo mungesë më zemëronte më shumë sesa që më mjeronte. *Jo, nuk ishte kjo.*

Tash zënë të flasin për romanet policore. Krejt pa dashur më ra në vesh kur ajo femra pyeti Hunterin a kish lexuar romanin *„Rrethimi i shtatë"?*

— Pse — pyeti Hunteri? — Të gjitha romanet policore janë të njëjtë. Mjafton të lexosh një në vit. Mirëpo, një në javë më duket se tregon varfërinë imagjinative të lexuesit tanë.

Mimi u hidhërua. Desha të them se *u shtir se u hidhërua.*

— Mos fol marrëzi — tha. — Ky është vetëm lloj romanesh që mund ta lexoj tash. Po të them se ata më magjepsin. Krejt, fund e krye, konflikte, kurse dedektivët aq të mrekullueshëm dhe nuk ka gjë që nuk dinë: artin e epokës Ming, grafologjinë, teorinë e Ajnshtajnit, *baseball*[1]), arkeologjinë, hiromantinë, ekonominë politike, statistikën e kultivimit të lepujve në Indi. E, përveç kësaj, aq janë të pagabueshëm, kënaqësi. A nuk është kështu? — pyeti duke m'u drejtua mua përsëri.

U tranda aq papritmas sa nuk dita ç't'i përgjigjem.

— Po, ashtu është — thashë vetëm sa për të thënë diçka.

Hunteri më shikoi prapë me ironi.

---

[1]) bezboll, lojë amerikane me top.

— Dua t'i tregoj Martinit se romanet policore të bëjnë të tërqethesh — shtoi Mimi, duke e shikuar rreptë Hunterin.

— Nuk thashë se nuk më bëjnë të tërqethesh, por thashë se i ngjajnë njëri-tjetrit.

— Sido që të jetë, do t'i tregoj Martinit se është fat i madh se e gjithë bota nuk është cikërrimtare si ti. Zotëri Kastelit i pëlqejnë, apo jo?

— Mua? — pyeta i tmerruar.

— Dihet — vazhdoi Mimi pa pritur që t'i përgjigjem, duke e kthyer kryet kah Hunteri — sikur e gjithë bota të ishte *savant*[1]) si ti, nuk do të mund të jetonte. Jam e bindur se ke teori të plotë për romanet policore.

— Ashtu është — u pajtua Hunteri, duke qeshur.

— A nuk ju thashë? — komentoi Mimi me rreptësi, duke m'u drejtuar prapë mua si të më merrte dëshmitar. — Ah, unë këtë e njoh mirë. Pa le të shohim si do të shkëlqesh pa kurrfarë skrupulash! Sigurisht po digjesh flakë nga dëshira që ta shtrosh.

Hunteri, njëmend, nuk priti shumë që talusë.

— Teoria ime është sa vijon — shtoi ai. — Romani policor në shekullin njëzet paraqet atë që romani kalorsiak në kohën e Servantesit. Aq më tepër, jam i bindur se do t'ia vlente të bëhej diçka që i përngjet Don Kishotit: satirë e romanit policor. Merrni me mend një person që e kalon tërë jetën duke lexuar romane policore dhe përqafon idenë e marrëzishme të besojë se bota funksionon ashtu si në romanet e Nikollas Blejkut ose Eleri Kuinit! Merrni me mend, ai i mjerë fillon në fund të zbulojë krimet dhe të sillet në jetë si *dedektiv* i ndonjërit prej këtyre romaneve. Besoj se mund të bëhet diçka qesharake, tragjike, simbolike, satirike dhe e mrekullueshme.

---

[1]) i dijshëm, i ngritur shkencërisht.

— Pse nuk e bën ti? — pyeti Mimi përkidhshëm.

— Nga dy arsye: e para, nuk jam Servantes; e dyta, jam për hata i përtueshëm.

— Më duket se mjafton arsyeja e parë — shtoi Mimi.

Pastaj, mjerisht, m'u drejtua mua:

— Ky njeri — tha duke treguar anash me sigarallëkun e saj të gjatë Hunterin, po flet kundër romaneve policore, sepse është i paaftë ta shkruajë një, madje çfarëdoqoftë, e madje edhe romanin më të mërzitshëm në botë.

— Ma jep një cigare — tha Hunteri duke iu drejtuar kushërirës së vet.

Pastaj shtoi:

— Kur do të pushosh së tepruari? E para, unë nuk fola kundër romaneve policore: vetëm thashë trup e shkurt se mund të shkruhet diçka si Don Kishoti i kohës sonë. E dyta, gabon se jam absolutisht i paaftë për punë të tilla. Njëherë, në një rast, më shkrepi ide e mirë për një roman policor.

— Sans blegue![1]) — vetëm ashtu tha Mimi.

— Po, po të them përnjëmend. Shih: një njëri ka nënën, gruan dhe një djalë. Një mbrëmje vritet në mënyrë misterioze nëna. Hetimet policore nuk qesin në dritë kurrfarë rezultatesh. Pak më vonë vritet edhe gruaja: e njëjta gjë. Në fund vritet edhe djali. Njeriu vetëm që nuk luan mendsh, sepse i donte të gjithë posaçërisht djalin. I dërmuar, vendos t'i bëjë hetimet për krimin për hesap të vet. Me metoda të zakonshme — induktive, deduktive, analitike, sintetike e të tjera kësisoj — të atyre gjenive të romaneve policore, nxjerr konkludimin se krimineli duhet të bëjë edhe vrasjen e katërt, po atë ditë, po në atë orë, po në atë vend. Përfundimi i tij është se vrasësi duhet ta vrasë tash atë. Ai njeri vjen,

[1]) mos more.

ditën dhe në orën e caktuar, në vendin ku duhet të bëhet vrasja e katërt dhe e pret vrasësin. Mirëpo, vrasësi nuk vjen. Ai i revidon konkluzionet e veta: ndoshta e llogariti keq vendin, jo, vendi ishte mirë; ndoshta e llogariti keq kohën; jo, edhe koha ishte mirë. Përfundimi ishte i hatashëm: *vrasësi duhej të ishte tashmë në atë vend.* Me fjalë të tjera: vrasës ishte ai vetë, ai i bëri vrasjet e tjera në gjendje të pavetëdijshme. *Dedektivi* dhe vrasësi janë një personazh.

— Tepër origjinale për shijen time — tha Mimi. — Por qysh përfundon? A nuk the se duhet të bëhet edhe vrasja e katërt?

— Përfundimi është i qartë — tha plogësht Hunteri. — Ai bën vetëvrasje. Mbetet dilema a vritet nga shili i ndërgjegjes, ose „uni" i vrasësit e vret „unin" e dedektivit si në ndonjë vrasje të zakonshme. Nuk po të pëlqen?

— Më duket interesant. Mirëpo, një gjë është ta tregosh kështu, e tjetër ta shkruash romanin.

— Kjo është e vërtetë — u përgjigj qetas Hunteri.

Pastaj ajo filloi të flasë për një hiromant[1]), të cilin e kishte njohur në Mar de Plato dhe për një zonjë *kiaro di xhenti.* Hunteri e bëri një barcoletë dhe Mimi u hidhërua.

— Më beso, kjo është gjë serioze — tha. — I shoqi ishte profesor i fakultetit teknik.

Mandej folën për telepatinë, kurse unë i dërmuar që nuk po dukej Maria. Kur ua fala atyre prapë kujdesin, flisnin për pozitën e çifqinjve.

— Po, qe çka — fliste Mimi, duke e mbajtur cigarallëkun si shkop dirigjimi — ata nuk duan të punojnë më.

Kah fundi i bisedës diçka më shkrepi papritmas dhe ma treti mërzinë e pashpjegueshme: e hetova se Mimi sapo kishte ardhur dhe Maria

[1]) Aftësi për të parë me vegull.

nuk zbriste që të mos dëgjonte kopallat e Mimit e të kushëririt të saj të parë (të cilat i dinte, dorëmenjë, aq mirë, sa që ia shtonin mërzinë), Mirëpo, tash më kujtohet, kjo ndjenjë e ime nuk ishte krejt iracionale, por rrjedhim i asaj që më tha shoferi duke ardhur për në çiflig, kurse unë nuk ia vura aspak mendjen: diçka përkitazi me kushërirën e zotërisë, e cila sapo kishte ardhur prej Mar de Platos, në çaj. Ishte qartë: Maria e dëshpëruar nga ardhja e papritur e kësaj femre, ishte mbyllur në dhomën e saj me preteks se nuk ndihej mirë; ishte evidente se nuk i duronte dot personat asisoj. Dhe ndjenja se mërzia ime po tret me këtë konkludim, ma zbuloi aty për aty arsyen e kësaj mërzie: kur erdha këtu dhe pashë se Hunteri dhe Mimi ishin hipokritë e primitivë të zakonshëm, pjesa më e cekët e shpirtit m'u kthjellua, sepse e pashë në këtë mënyrë se Hunteri nuk mund të më jetë rival, kurse shtresa më e thellë m'u mjerua nga të pandehurit (thënë më mirë nga dërmimi) se edhe Maria ish përbërëse e këtij rrethi dhe se mund të kishte, në njëfarë dore, vite të ngjashme.

XXV

Kur u çuan prej tavoline, me qëllim që të shëtisnin nëpër kopsht, pashë se në atë çast na bashkohej Maria dhe kjo gjë i jepte dorë supozimit tim: kishte pritur këtë çast për të na u bashkuar, për t'i ikur bisedave të pakuptimta rreth tavolinës.

Kurdo që Maria më afrohej e rrethuar nga njerëzit e tjerë, mendoja: „Ndërmjet meje e kësaj qenie të mrekullueshme ekziston një lidhje e fshehtë", e pastaj, kur i analizova ndiesitë e mia, zbulova se ajo m'u bë më se e domosdoshme (si dikush që njeriu e gjen në ujdhesë të shkretë), në mënyrë që, më vonë, kur t'i kalojë frika prej vetmisë së plotë, të shndërrohet në njëfarë luksi, me të cilin krenohesha, isha në atë fazën e dytë të dashurisë sime, në të cilën zënë të qesin krye njëmijë sprovime; kjo është përafërsisht ashtu si kur dikush vdes prej urisë, pranon pakusht çkadoqoftë në mënyrë që, më vonë, kur t'i plotësojë ato më të nevojshmet, të fillojë të ankohet për herë e më shumë për të metat dhe dëmin e saj. Vitet e fundit më ka rënë të shoh emigrantët, të cilët vinin me përulësi si ata që ikin prej kampeve të përqëndrimit, pranojnë çkadoqoftë vetëm për të dalë në skaj, kryejnë

edhe punët më të ndyra, mirëpo, është mjaft çudi se njeriut nuk i mjafton që kur u ikën mundimeve dhe vdekjes, të jetojë i kënaqur: sepse sapo nis të ndihet prapë i sigurt, qet përnjëherë krye krenaria, mburrja, madhështia, gjë që duken, sy e faqe, përgjithmonë të çlyera, zënë të duken përsëri si kafshët kur janë të frikësuar që ikin në të katër anët; e se duken prapë në një mënyrë të caktuar me pak më shumë sherri, si t'iu vinte turp që ranë aq poshtë. Nuk është vështirë që, në ato raste, të shfaqet pamiradija dhe të mohohet mirënjohja.

Tash që mund t'i analizoj ndiesitë e mia, mendoj, se diçka prej kësaj, kishte në marrëdhëniet e mia me Marinë dhe, më bëhet se, e kuptoj në njëfarë dore treninë që nuk isha i kënaqur me Marinë, e cila më shpëtoi (momentalisht) nga vetmia. Ky gaf i krenarisë sime dhe dëshira që më rritej për të pasur kryekëput Marinë, më tregonin dorëmenjë se isha në rrugë të keqe, sipas këshillës së krenarisë dhe mburrjes.

Në atë çast, kur e pashë Marinë duke ardhur, kjo ndjenjë e krenarisë treti para ndjenjës së turpit e të fajësisë, për shkak të skenës në atelienë time, të akuzës sime të marrëzishme, mizore, madje edhe vullgare se po e „mashtron një të verbër". Ndjeja se nuk do më mbanin këmbët dhe se akulli e të zbetit po ma mbërthenin fytyrën. Dhe të gjendemi kështu të rrethuar nga këta njerëz! Dhe, duke mos mund të bie përulësisht para saj në gjunj që të më falë dhe, me këtë, të ma zvogëlojë tmerrin dhe urrejtjen që ndjeja ndaj vetvetes!

E, megjithatë, dukej se Maria nuk e kishte humbur pushtetin ndaj vetes dhe mua, thuaja, po në atë çast nisi të më kapë prapë njëfarë malli i pa caktuar.

Më përshëndeti me njëfarë maturie, si të kishte dashur që, para kushërinjve, të tregojë se midis nesh nuk kishte gjë, pos miqësisë së zakonshme. M'u kujtua sa qesharak dola para ca

ditësh ndaj saj. Në njërin prej atyre vërshimeve të dëshpërimit i pata thënë se do të kisha dashur një herë të vizitoj me të molet e Senës në perëndim të diellit ose të sodisnim nga ndonjë kodër pyrgjet e Shën Heminianit. Më pat shikuar me zjarr e pat thënë: „Mrekulli. Huan Pablo?! Mirëpo, kur i thashë po atë natë të ikim, u frikësua, fytyra iu ngrys dhe tha si zymshëm „Nuk kemi të drejtë të mendojmë vetëm për veten, tonë. Bota është shumë e ndërlikuar". E pyeta ç'deshi me këtë të thotë? M'u përgjigj edhe më me zymti: „Fati është i rrethuar me dhembje". Ika me të shpejtë, e lashë pa e përshëndetur. Atëbotë ndjeva, më shumë se kurrë ndonjëherë tjetër se nuk do të bashkohem kurrë plotësisht me të dhe se duhej të pajtohesha se do të kem vetëm lidhje të pikëllueshme, të thyeshme të çastit, si kujtim i ndonjë ëndrre ose të ca pasazhave të hareshme muzikore.

Ndërsa tash që erdhi, kishte në kontroll çdo lëvizje, e maste mirë çdo fjalë, gjestimimikë të fytyrës, madje edhe t'i falë buzëqeshje asaj femre.

Më pyeti a i solla skicat?

— Cilat skica? — klitha idhshëm, duke ditur se duhej të pritja ndonjë manavër të ndërlikuar, edhe pse ai na shkonte neve për shtat.

— Skicat që premtova se do të m'i tregosh — insistoi krejtësisht e qetë. — Skicat e limanit?

E shikova me urrejtje, por ajo i qëndroi e qetë këtij shikimi dhe sytë që ia veshi ëmbëlsia për një të dhjetën e sekondës, si të më thoshin: „Më kurse nga gjithë ato". E dashur, Mari e dashur! Sa vuajta për atë çast të lutjes e të poshtërimit! E shikova me lëmonti dhe iu përgjigja:

— Kuptohet se i solla. I kam në dhomë.

— Mëzi s'po pres t'i shoh — tha prapë ftohtas si më parë.

— Mund t'i shohësh menjëherë — thashë duke ia qëlluar se ç'mendonte.

U dridha nga dyshimi se Mimi mund të na vihej pas. Mirëpo, Maria e njihte më mirë se unë, ashtu që shtoi menjëherë e, me ato ca fjalë-ia bëri të pamundur të na vihet pas.

— Po kthehemi menjëherë — tha.

Dhe, sapo tha kështu, më kapi fort për krahu dhe u nisëm kah shtëpia. I shikova tinez ata që i lamë dhe m'u duk se hetova njëfarë shkëlqimi dashakeqës ndër sy të Mimit kur e shikoi Hunterin.

XXVI

Mendova të rri disa ditë në çiflig, por ndenja vetëm një natë. Të nesërmen, fill sa lindi dielli, ika këmbë me valixhe dhe kutinë në dorë.

Ky veprim mund të duket si marrëzi, por, do të shihet, se deri në ç'masë ishte i arsyeshëm.

Mbasi u ndamë prej Mimit dhe Hunterit, hymë në shtëpi, hipëm lart për t'i kërkuar gjoja skicat dhe, dikur, zbritëm me kutinë time për ngjyra dhe një dosar vizatimesh, i cili duhej të simulonte skicat.

Kushërinjtë kishin tretur. Marisë nisi t'i kthehet disponimi dhe ndihej për mrekulli, ndërsa, duke kaluar nëpër kopsht kah bregdeti, ishte e ngazëllyer. Ishte grua krejt tjetër nga ajo që njihja deri në atë çast në brenga të qytetit: më aktive, më e gjallërishme. Poashtu më bëhej se tek ajo po dukej njëfarë senzualiteti, të cilin nuk e kisha njohur, sensibilitet ndaj ngjyrave dhe erëndjeve: ngazëllehej çuditërisht (çudi për mua që jam retrospektivisht senzual, thuaja për arsye të imagjinacionit tim të thjeshtë) nga ngjyra e ndonjë trungu, ndonjë gjethi të thatë, dofarë bubërrecash, era e eukaliptusit të përzier me erëndjen e detit. E, kjo gjë jo vetëm që nuk më gëzonte, por edhe më pikëllonte dhe më sillte dësh-

përimin, sepse ndjeja se Maria e këtillë më ishte plotësisht e huaj dhe, si e tillë, i përkiste një-farë dore Hunterit ose dikujt tjetër.

Pikëllimi rritej shkallë-shkallë, ndoshta edhe për shkak të ushtimës së valëve. e cila dëgjohej për herë e më shumë. Kur u ngjitëm në maje të Kodrës dhe kur m'u shtri para syve qielli mbi bregdet, ndjeva se ky pikëllim ishte i pashmangshëm, ishte ky pikëllim prore para bukurisë ose, të paktën, para një lloji të bukurisë. A e ndjejnë këtë të gjithë ashtu ose kjo është edhe një e metë e natyrës sime të pafat?

U ulëm në shkëmbinj dhe dëgjuam një kohë bukur të gjatë valët duke u përplasur tërbueshëm dhe i ndjenim stërpikat e shkumbës në fytyrë, të cilat mbërrinin, kohë pas kohe, deri lart te shkrepat. Qielli, i cili kishte mbledhur buzët, ma kujtonte Tintoretin në shpëtimin e Saracenëve.

— Sa herë kam ëndërruar që të sodis me ty këtu detin dhe qiellin — tha Maria.

Pas një copë herë shtoi:

— Ndonjëherë më bëhet se këtë pamje e përjetuan gjithnjë bashkë. Kur e pata parë atë gruan e vetmuar në atë dritarezën tënde, pata ndjerë se edhe ti je si unë se edhe ti po kërkon dikë me ngulmë, njëfarë bashkëbiseduesi memec. Prej asaj dite nuk pushova së menduari për ty, shpesh të shihja në ëndërr këtu, po në këtë vend, ku i kalova aq orë të jetës sime. Një ditë prej ditësh pata vendosur të të kërkoj dhe të ta them këtë. Mirëpo, droja mos po mashtrohem, ashtu si u pata mashtruar një herë, andaj pritja që ti të jesh në njëfarë mënyre ai që do të më kërkojë. Dhe unë të ndihmoja instiktivisht, të thirrja çdo natë dhe isha aq e sigurt se do të të gjej, ashtu që, kur ndodhi kjo tek ai ashensori gabërrues, u pata shtangur prej frikës, kështu që, pos ndonjë marrëzie, nuk ia dola të them asgjë. Ndërsa kur ike ti i pikëlluar nga se besova se e ke gabim, u pata nisur vrap pas teje si e marrë. Pastaj erdhen

ato çaste në Sheshin shën Martini, kur konsideroje se duhej të m'i shpjegosh ca gjëra, kurse unë përpiqesha të të hutoj, duke u luhatur ndërmjet dëshirës që të të mos humb përgjithmonë dhe të frikës se po të shkaktoj dhembje. E, megjithatë, përpiqesha të të dekurajoj, që të lë me bindje se nuk i kuptoja fjalët tua të pakryera, porosinë tënde të shifruar.

Unë nuk thashë asgjë, Ndërsa dëgjoja zërin e saj, zërin e saj të mrekullueshëm, në krye më vlonin e gërshetoheshin ndjenja të çiltërta dhe mendime të zymta. Më kapte njëfarë magjie. Perëndimi i diellit ndezi në retë e prarimit vravashka të mëdha. Ndjeja se ky çast magjik nuk përsëritet kurrë. „Kurrë më, kurrë më", mendova, ndërsa filluan të më merren mend nga lartësia e shkrepave dhe do të ishte lehtë ta tërhiqja me vete në humnerë.

Dëgjova pjesët e fjalisë: „O zot.. me sa gjëra jemi bashkë në këtë përjetësi... gjëra të tmerrshme... jo vetëm që e përbëjnë pjesën e këtij ambienti, por jemi qenie të imta prej mishi e gjaku, të pavlefshme plot shëmti..."

Deti shndërrohej në përbindësh të zymtë. Dhe, hë për hë, u terratis plotësisht, ndërsa ushtima e valëve atje poshtë, u bë edhe më kobshëm tërheqëse! Pandeha se kjo është lehtë! Ajo tha se jemi qenie të pavlefshme e plot shëmti; sado që e dija se deri në ç'shkallë jam i aftë për poshtërësi, më tmerronte mendimi se edhe ajo mund të jetë, se ishte *me siguri*, Qysh? — mendova — me kë; kur?. Dhe, mua më rritej në veten time dëshira tinzake të hidhem në të, ta shqyej me thonj, t'ia zë frymën në grykë derisa ta mbys dhe ta hedh në det. Po në atë çast dëgjova pjesën e fjalisë tjetër: fliste për fëmijërinë në fshat, m'u bë se dëgjova diçka për: „ngjarje të neveritshme e mizore", të cilat i ndodhen atij kushëririt tjetër. M'u duk se Maria po më bënte një pranim të vlefshëm, kurse unë, si ndonjë i trent, e lëshoi ja teposhtë.

— çfarë ngjarje e dhembshme e mizore — brita.

Mirëpo, për çudi, duket nuk më dëgjoi. Edhe ajo ishte poashtu në trans, si të ishte edhe ajo vetëm me vetveten.

Kaloi bukur shumë kohë, ndoshta gjysmë ore.

Pastaj hetova se si ma përgëdhelte fytyrën, ashtu siç bënte përndryshe në çaste të tilla. Nuk mundja fjalë të qes prej goje. Kryet ia mbështeta në gjoks, ashtu si dikur nënës kur isha i vogël, duke e ndalur fëmijërinë dhe vdekjen.

Qfarë dëmi për këto bamuni të pashpjegueshme e të dyshimta. Sa doja të mos kem të drejtë, sa kisha dëshirë Maria të jetë vetëm në atë çast. Mirëpo, ishte e pamundur. Ndërsa i mbështetur në atë mënyrë dëgjoja të rrahurat e zemrës së saj, derisa ajo m'i lëmonte flokët, në krye të trullosur më silleshin, si në ndonjë bodrum plo llucë, mendime të zymta dhe prisnin shtegun të dalin duke zhapëlluar e duke e çarë lehtë baltën.

XXVII

Ndodhen gjëra të çuditshme. Kur u kthyem në shtëpi, e hasem Hunterin tepër të shqetësuar (edhe pse ishte njëri prej atyre që konsiderojnë se nuk është njerëzishëm të tregohen ndjenjat); u përpoq ta fshehë këtë, por ishte e qartë se diçka po ndodhte. Mimi ishte kthyer, ndërsa krejt ishte shtruar për darkë. Sapo mbërrijtëm, shërbëtorët nisen të lëvizin shpejt e në mënyrë të shpërdhinjtë. Gjatë darkës, thuaj, nuk ndërruam asnjë fjalë. Ua vëja mendjen fjalëve dhe lëvizjeve të Hunterit, sepse ndjeja se, me anë të tyre, do të mundem të zbuloj shumë gjëra që më binin ndërmend e, për më saktë, ato mendime që zinin për herë e më shumë rrënjë. Ia vëja mendjen edhe Marisë, posaçërisht nuk ia ndaja sytë nga fytyra: e cila i ishte mbërthyer. Maria për të zvogëluar tendimin tha se po lexonte një roman të Sartrit. Hunteri, evident, i padisponuar, tha:

— Roman në këtë kohë? Për të shkruar, hajde de!.... Por, për të lexuar!

Na heshtem, ndërsa Hunteri nuk bëri as kaq për ta zvogëluar efektin e kësaj fjalie. Nxora përfundim se ai kishte diçka kundër Marisë. Mirëpo, mbasi para se të shkonim në bregdet, nuk ndodhi asgjë e pazakonshme, kunkludova se kjo diç-

ka kundër Marisë u krijua gjatë bisedës sonë të dytë; ishte shumë vështirë të mos pandehja se nuk ishte për shkak të asaj bisede ose, thënë më mirë, për shkak se në bregdet u ndalëm bukur shumë kohë. Konkludimi ishte: Hunteri ish xheloz e kjo tregon se midis tij dhe Marisë ekzistonte diçka më e madhe sesa marrëdhënie e zakonshme e miqësisë dhe lidhja farefisnore. Natyrisht, nuk ishte nëvoja Maria të ndiente dashuri ndaj tij; përkundrazi, ishte më lehtë Hunteri të hidhërohej duke parë Marinë se po u kushton më shumë kujdes personave të tjerë. Le të jetë si të jetë, nëse Hunteri hidhërohej prej xhelozisë, duhej të tregonte armiqësi ndaj meje, ndërsa nuk kishte asgjë tjetër midis nesh. Sikur të mos kishin qenë detaje të tjerë, do të mjaftojë që Hunteri më të shikojë herë shtrembët për shkak të një fjalie që tha Maria përkitazi me shkrepat.

Sapo u çuam prej tavolinës, me preteks se jam i lodhur, shkova në dhomën time. Kisha për qëllim të mbledh sa më shumë elemente të arsyeshme për problemin. U ngjita shkallëve, hapa derën e dhomës sime, ndeza dritën, përplasa derën gjoja se po e mbyll dhe u ndala në prag të përgjoj. Dëgjova zërin e Hunterit duke thënë diçka rreptë, ndonëse nuk munda t'i kuptoj qartë fjalët; Maria nuk përgjegji. Hunteri zu ngoje edhe një fjali, shumë më të gjatë e shumë më rreptë se atë pak më parë; Maria zuri ngoje disa fjalë krejt ngadalë duke i lidhur me fjalët e fundit të Hunterit, të cilat i përcolli kërkëllima e karrigeve dhe, në atë rast, dëgjova hapat e dikujt nëpër shkallë. Mbylla shpejt derën, por përgjoja edhe më tutje nëpër gavër të çelësit; pas disa çastesh dëgjova hapat para dhomës sime. Ishin hapa femre. Ndejta deri vonë zgjut duke menduar për ato që ndodhen dhe u bëra tërë veshë mos po dëgjoj farë fërfërshi. Mirëpo tërë natën nuk dëgjova gjë.

Nuk munda të fle... zënë të më mundojnë një varg mendimesh që më parë nuk më patën rënë në mend. Përnjëherë konstatova se konkludimi im i parë ishte naiv: mendova (kjo është me vend) nuk ishte nevoja që Maria të ndjejë dashuri ndaj Hunterit që ai të jetë xheloz; ky konkludim më fashiti. Tash e pashë se, po qe se kjo nuk ishte e nevojshme, nuk kishte as pengesa. Maria mund ta donte Hunterin e ky të jetë, megjithatë, xheloz.

E, pra, mirë: a kishte motive për të menduar se Maria kishte diçka me kushëririn e saj? Tash besoj se kishte motive! E para, nëse Hunteri e kishte mërzitur me xhelozinë e vet, e ajo nuk e donte, pse atëherë vinte orë e ças në çiflig? Në çiflig nuk jetonte rëndom askush, pos Hunterit, i cili ishte vetëm (nuk e di a ishte i pamartuar, vejan ose i çkurrorëzuar, ndonëse, më duket, Maria më pat thënë se ishte ndarë nga gruaja; por, fundja, ishte me rëndësi se ai zotëri jetonte vetëm në çiflig). E dyta, motiv për dyshim ishte edhe kjo që Maria më fliste për të me pa interesim, sikur kur të flitet për një anëtar të familjes; por nuk e zuri kur ngoje ose, madje, të më kishte bërë me dije se Hunteri ishte i dashuruar në të e aq më pak se është xheloz. Dhe, e treta, Maria më foli këtë pasdreke për dobësitë e veta. Ç'deshi të thotë? Unë i zbulova në letrën time një varg sendesh, të cilat janë për t'u pranuar (për dehjet e mia dhe atë për mantenutat), ndërsa ajo tash më thoshte se më kupton dhe se tek ajo nuk ishin vetëm anijet që shkonin dhe parqet në muzg. Ç'deshi me atë të thotë, pos se në jetën e saj kishte pasur gjëra aq të errta dhe të urryera si dhe në jetën time? Pse edhe kjo me Hunterin nuk mund të ishte ndonjë epsh i llojit të tillë?

I përtypja këto konkludime dhe tërë natën i shoshita nga këndvështrimi i ndryshëm. Përfundimi im i fundit, të cilin e konsideroja të rreptë, ishte: *Maria është dashnorja e Hunterit.*

Fill sapo agoi zbrita shkallëve me valixhe dhe kutinë time për ngjyra. E takova njërin prej shërbëtorëve, i cili sapo kishte nisur të çelë dyert e dritaret për t'i fshirë, iu luta që, në emër tim, të përshëndesë zotërinë dhe t'i thotë se m'u desh të kthehem urgjent në Buenos Aires. Shërbërtori më shikoi me habi e sidomos kur i thashë, mbasi iu përgjigja vërejtjes së tij, se deri në stacion do të shkoj këmbë.

Në stacionin e vogël m'u desh të pres disa orë. Kohë pas kohe mendoja se do t'ia behë Maria; pritja këtë mundësi me kënaqësi të idhët, kënaqësi që ndien fëmija kur të mbyllet diku, sepse konsideron se i është bërë njëfarë e padrejte dhe pret të vijë dikush i rritur që ta kërkojë dhe të pranojë fajin. *Por, Maria nuk erdhi.* Kur mbërrijti treni, shikova edhe një herë kah rruga, me shpresë se ajo do t'ia behë në çastin e fundit, e kur nuk e pashë duke ardhur, u pikëllova pa masë. Ndërsa treni grabiste kah Buenos Airesi, unë shikoja nëpër dritare. Kaluam pranë një rançi; një grua nga nënstreha shikonte trenin. Më shkrepi një mendim i marrëzishëm. „Këtë grua po shoh për herë të parë e të fundit. Nuk do ta shoh kurrë më në jetën time". Mendimet më notonin si tapa në lumë të panjohur. Një copë herë u sollën rreth asaj gruaje në nënstrehë. Ç'më duhej? Përse të më bënte për atë grua? Mirëpo, nuk munda t'i heq qafës mendimet se ajo ekzistoi në një çast për mua dhe nuk do të ekzistojë më kurrë; kjo është, nga pikëpamja ime, njësoj si të kishte vdekur: pak vonesë e trenit, një thirrje nga rançi dhe ajo grua as që do të ekzistonte në jetën time.

Djithçka më dukej e pakapshme, e kalueshme, e padobishme. e pacaktuar. Kryet si të mos e kisha në vend dhe Maria më shfaqej prore si diçka ireale dhe melankolike. Vetëm disa orë më vonë mendimet m'u bënë të sakta, të epura si edhe më parë.

XXVIII

Ditët që i paraprinë vdekjes së Marisë qenë ditët më të vështira të jetës sime. Eshtë e pamundur të përshkruaj saktë krejt ç'ndjeja dhe ç'bëra, sepse, ende më kujtohen mirë, në hollësi të pabesueshme shumë ngjarje, çaste, madje edhe ditë të tëra që më përhihen si ëndrra të paqarta e të deformuara. Më duket se ditë të tëra kam kaluar nën ndikimin e alkoolit i shtrirë në shtratin tim ose në ndonjë bankë të Limanit të Ri. Kur arrita në stacionin Konstitusion, më kujtohet fort mirë se hyra në bar dhe porosita uiski pas uiskit, pastaj më kujtohet si prej së largu, se u çova, thirra taksin dhe shkova në bar në Rrugën 25 Maj ose në Leandro Alem. Mandej vetëm renditeshin do tinguj, muzika, klithjet, gazi nga i cili shtangësha, shishe të thyera, drita të depërtueshme. Pastaj më kujtohet mundi dhe dhembja e tmerrshme e kresë në burg të komesariatit, roja që çilte dyert, oficeri që foli diçka e, pas kësaj, bredhja nëpër rrugë dhe kroma e hatashme. Më duket se kam hyrë prapë në një bar. Disa orë (ose ditë) më vonë dikush më solli në atelienë time. Pastaj pata do ankthe, në të cilët ecja nëpër kulmin e njëfarë katedraleje. Më kujtohet poashtu zgjimi në dhomën time, në terr dhe me

përshtypje të tmerrshme se dhoma ishte, bërë pa masë e madhe e se, sado të ngarendja, nuk do t'ia gjeja skajin. Nuk e di sa kohë pat kaluar derisa shkulmat e para të agimit nuk hynë nëpër dritare. Pastaj u rrokadyla deri në banjo dhe i veshur hyra në kadë. Uji i ftohtë ndikoi fashitshëm, ndërsa në mbamendje zënë të më shfaqen ngjarje të izoluara, edhe pse të ndërprera e të palidhura, si kur gjësendet e para shpërthejnë prej ujit pas ndonjë vërshime të madhe: Maria te shkrepat; Mimi duke mbajtur cigarallëkun e vet! stacioni *Alende,* dyqani tregtar përballë stacionit, i cili thirrej *Besimi* ose ndoshta *Çifligu;* Maria duke më pyetur për skicat, unë duke bërtitur: „Çfarë skicash"? Hunteri që më shikonte idhshëm; unë duke e pritur me dëshirë dialogun midis kushërinjve; marinari që hodhi shishen; Maria që më afrohej me shikim të mbërthyer; Mimi duke shqiptuar *Tchekhov,* një grua flliqane që më puthte, kurse unë ia kthej me goditje të hatashme; pleshtat ma hanë trupin, Hunteri duke folur për romanet policore, shoferi i çifligut. M'u përhiheshin poashtu pjesë të ëndrrave: prapë katedralja në terr të natës, dhoma tepër e madhe.

E pastaj, ashtu si freskohesha, në atë mënyrë ngjiteshin edhe ato fragmente me fragmentet e tjerë që shpërthenin nga vetëdija ime dhe pejzazhi formësohej, edhe pse në atë përdëllim e shkretërim që janë veçori të pejzazheve që shpërthejnë prej ujit.

Dola prej banjos, u zdesha, vesha teshat e terura dhe u ula t'i shkruaj Marisë. Më parë i shkrova se dëshiroj t'i shpjegoj për ç'shkak ika prej çifligut (e korrigjova fjalën „ikje" dhe vura „largim") Shtova se e çmoj shumë interesimin që tregoi për mua (e korrigjova atë „për mua" dhe vura „për personin tim"). E kuptova se ajo është tepër e përzemërt dhe plot ndiesi të çiltërta, edhe pse, siç më dha të kuptoj, ndonjëherë ia merrte anën „epshi. I thashë se e çmoj me vle-

rën e vërtetë çështjen e largimit të ndonjë anijeje ose praninë memece në ndonjë park ose muzg, por që kjo, ashtu si mundi të pandehë edhe vetë (e korrigjova „të pandehë" dhe vura „të llogarisë") nuk mjaftonte që të ruhej ose të dëshmohej dashuria: nuk mund të kuptoj edhe mëtutje si është e mundur që një grua, si ishte ajo, ishte e aftë t'i flasë për dashuri burrit e mua dhe të bjerë njëkohësisht me Hunterin (e korrigjova „Hunterin" dhe vura „zotëri Hunterin", kombinimi i fjalës „bjerë" me konsideratë e papritur formale ndaj atij personi më dukej shumë efikas). Kurse rrethanë vështirësuese ishte — shtova — se kishte rënë në shtrat me burrin dhe me mua; e kreva letrën duke përveçuar se veprimet e këtilla, si kishte mund të vënerojë edhe ajo, më shtynin të mendoj, e kështu me radhë.

Letrën e lexova përsëri dhe më dukej se, me ndryshimet e bëra, është mjaft therëse. E mbylla, shkova në Postën kryesore dhe e dorëzova rekomande.

XXIX

Sapo dola prej poste, i vënerova dy gjëra: në letër nuk i thashë nga e nxora përfundimin se ajo është dashnorja e Hunterit; dhe nuk e dija ç'desha me atë që e thera aq mizorisht: ndoshta për ta ndërruar mënyrën e vet të jetës, në rast se supozimet e mia ishin të sakta? Kjo gjë ishte evidente, qesharake. Që të më vijë pas? Nuk ishte e besueshme se këtë do ta arrija në atë mënyrë. Mendoja se, megjithatë, kisha nga thellësia e shpirtit dëshirë që Maria të më kthehet. Mirëpo, pse nuk e thashë në atë rast direkt, pa e therur, duke ia shpjeguar se ika nga cifligu, sepse e zbulova papritmas se Hunteri ishte xheloz. Në fund të fundit, përfundimi im se ajo ishte dashnorja e Hunterit, përveç që e godiste, ishte plotësisht arbitrar: le të jetë si të jetë, ky ishte vetëm supozim, të cilin mund ta formuloja me një qëllim për t'i orientuar analizat e mia të ardhshme. Bëra, pra, edhe një herë marrëzi nga shprehia ime gabërruese që të shkruaja letra tepër spontane e t'i dërgoi menjëherë. *Letrat me rëndësi duhet të mbahen më së paku një ditë, derisa të mos shihen qartë të gjitha rrjedhimet e mundshme.*

Më mbeti edhe një ilaç pikëllimi, dëftesa! E kërkova në të gjithë xhepat, por nuk e gjeta: duhet ta kem hedhur atje diku. U ktheva, megjithatë, vrap në postë dhe hyra në rresht për letrat rekomande. Kur erdha në radhë, ndërsa e pyeta nëpunësen, u orvata këtej me mundim dhe hipokrizi të buzëqesh:

— Nuk po më njihni?

Ajo më shikoi habitshëm: sigurisht mendoi se nuk jam më vete. Për t'ia flakur njimtinë, i thashë se unë jam personi që dorëzoi, në të vërtetë, letrën për çifligun *Los Ambues*. Befasia e kësaj gabërroshe dukej se u bë edhe më e madhe dhe, ndoshta, duke dashur këtë befasi ta përcjellë ose të kërkojë këshill për diçka që nuk ishte në gjendje të kuptojë, ajo u kthye kah një koleg dhe prapë më shikoi mua:

— E humba dëftesën — iu përgjigja.

Nuk u përgjigj

— Desha të them se letra më duhet, e nuk kam dëftesë — shtova.

Femra dhe ai nëpunësi u shikuan për një çast si dy partnerë në lojë letrash. Në fund më pyeti me klithje tërbimi të thellë.

— Ju kërkoni që t'ju kthejmë letrën?

— Ashtu.

— E nuk keni as dëftesë?

U desh të pranoj se nuk e kisha atë dokument të rëndësishëm. Tmerri i femrës erdhi e u rrit deri në kulm. Bëlbëzoi diçka që nuk e kuptova dhe e shikoi përsëri kolegun e vet.

— Po kërkon t'ia kthejmë letrën — nënëriti ai.

Buzëqeshi torrollakqe, por me qëllim që t'i tregonte se është mendjeprehtë. Femra më shikoi e tha:

— Është krejt e pamundur.

— Mund t'ju tregoj dokumentet — u përgjigja duke nxjerrë do letra.

— Ç'e do. Rregulli e do qartë.

Rregulli duhet të jetë, këtë ndoshta e kuptoni, në përkim me logjikën — brita idhshëm, ndërsa nisi të më ngacmojë një beng që kishte ajo femra në fytyrë.

— Ju e dini rregullin? — më pyeti ngathshëm.

— Nuk ka nevojë ta di, zonjë — u përgjigja ftohtas, duke e ditur se fjala zonjë do ta fyejë për jetë.

Sytë e kësaj shkrape i shndritën prej hidhërimit.

— Ju, zonjë, e dini se rregulli nuk mund të jetë jo logjik: duhet ta ketë shkruar ndonjë person normal, e jo ndojë i marrë. Nëse uuë e dorëzoj letrën dhe kthehem mënjëherë e kërkoj të më kthehet, sepse harrova diçka me rëndësi, është logjike të ma plotësoni kërkesën. Ose posta përpiqet, ndoshta, të dërgojë letrat jo të plota e të gabuara. Eshtë krejt e qartë dhe afër mendjes se posta është mjet i komunikacionit, e jo mjet urdhërimi; posta nuk mund të na detyrojë po qe se ne nuk duam.

— Mirëpo, ju vetë deshet — u përgjigj.

— Po — brita — por po ju përsëris se tash nuk dua!

— Mos bërtitni, mos u bëni i pasjellshëm. Tash është vonë.

— Nuk është vonë, sepse letra është atje — thashë, duke treguar shportën me letra të gatshme për ekspedim.

Njerëzit nisen të protestojnë me zë. Fytyra i dridhej prej hidhërimit leneshës. Ndjeja se e tërë urrejtja ishte përqëndruar me neveri të njëmendtë në beng.

— Unë mund ta dëshmoj se jam personi që dërgoi letrën — përsërita duke ia treguar do dëshmi të identitetit personal.

— Mos bërtitni, nuk jam e shurdhët — përsëriti — unë nuk mund ta marrë një vendim të tillë.

— Pyeteni, pra, shefin.

— Nuk mundem. Shumë palë po presin — tha.

— A po shihni sa punën e kemi! Kuptoni.

— Edhe kjo hyn në punë — ndërhyra.

Disa nga palët që pritnin, propozuan që të ma kthejnë letrën dhe të vazhdojnë punën. Ajo femra, ndërsa shtyhej se po punonte diçka tjetër, u ndërdysh një çast, në fund, hyri brenda dhe, pas një copë here, u kthye e tërbuar si qeni. Kërkoi nëpër shportë.

— Cili çiflig? — pyeti duke kujisur si bushtra.

— Çifligu Los Ambues — u përgjigja me fash të dukshme.

Mbasi u ngatërrua me qëllim në të kërkuar, nxori letrën dhe nisi ta rrotullojë nëpër duar, si t'ia ofronte kujt në shitje dhe të dyshonte në dobinë e vlerës.

— Ka vetëm inicialet në adresë — tha në fund.

— Ani?

— Me ç'dokument mund ta dëshmoni se ju jeni personi që dërgoi letrën?

— Me koncept — thashë duke ia tregua.

E mori, e shikoi dhe ma kthei.

— E si mund ta dimë se ky është koncepti i letrës?

— Fare thjesht: ta hapim zarfin dhe deshmojmë.

Ajo u dymend një çast, e shikoi zarfin e ngjitur dhe më tha:

Si mund ta çelim letrën nëse nuk e dimë se letra është e juaja? Unë nuk mund ta bëj këtë.

Palët nisen prapë të protestojnë. Isha ha-ha të bëj kërdinë.

— Ky dokument nuk vlen — përfundoi shrapa.

— Ju merr mendja se letërnjoftimi mjafton? — pyeta me përzemërësi ironike.

— Letërnjoftimi?

U mendua pak, shikoi përsëri zarfin, mandej tha:

— Jo vetëm letërnjoftimi, jo, sepse këtu janë vetëm inicialet. Do të jetë nevoja të më tregoni edhe qertifikatën e vendbanimit. Nëse nuk e keni atë, atëherë librezën e ushtrisë, sepse në të është i shkruar vendbanimi.

Mendoi edhe një çast e shtoi:

— Ma merr mendja se është e pamundur që nuk keni ndërruar vendbanimin prej të tëtëmbëdhjetave. Pra, është e qartë se nuk do t'ju duhet as çertifikata e vendbanimit.

Në fund shpërtheva me tërbim dhe ndjeva se ai e kapte edhe Marinë e, ç'është për t'u çuditur, edhe Mimin.

— Dërgjojeni, ju marrtë dreqi — brita duke dalë.

Dola prej poste i tërbuar si luqerrbulla, madje ma hëngër mendja se do ta kisha ndezur, mbasi u ktheva në sportel, edhe shportën me letra. Por, qysh? Ta hedh shkrepsen? Do të fikej në ajër. Ta vë pak më parë në naftë, kështu do t'ia dal sigurisht; por kjo do ta komplikonte punën. Sido që të jetë, më shkonte mendja të pres derisa të mbarojë orari zyrtar i këtij turni, e ta fyej mirë e mirë atë leneshë.

XXX

Mbasi prita një orë, vendosa të heq dorë. Ç'do të kisha fituar në fund me atë që do ta fyeja atë budallaqe? Në anë tjetër, atë kohë e kalova në të menduar. Kjo gjë, zatën, edhe më fashiti: letra ishte e mirë dhe ishte mirë t'i binte në dorë Marisë (më ndodhte shpesh: që ta mposhtë me mundim ndonjë pengesë, e cila nuk linte të bëj atë që konsideroja se është e nevojshme ose e mirë, pastaj ta pranoj i tërbuar dështimin dhe, më në fund, të bindem diçka më vonë se fati kish të drejtë). Kur fillova, në të vërtetë, ta shkruaj letrën, atë e bëra pa e vrarë mendjen shumë, madje, në atë çast duke menduar për krejt atë që i paraprin letrës, aty për aty m'u kujtua ëndrra që pashë në njërën prej atyre netëve të ahengjeve të mia; duke qitur kryet prej një pusie, pashë veten duke ndenjur në një karrige midis lokalit të errët. të pamobiluar e të zbukuruar, kurse pas shpine dy persona më shikonin me shprehje të ironisë djallëzore: njëri ish Hunteri e tjetri Maria.

Kur m'u kujtua kjo ëndërr më kapi një përdëllim i pangushëllueshëm. Dola prej derës së postës dhe u nisa me hap të plogësht.

Pak më vonë e pashë veten duke ndenjur në një bankë pranë një lisi tepër të madh në Rekoleta. Vendet, drunjtë, shtigjet e çasteve tona më të bukura, nisën të m'i ndërrojnë mendimet. Ç'është ajo, fundi i fundit, që kisha unë konkretisht kundër Marisë? Çastet më të bukura të dashurisë sime (fytyra e saj, shikimi sensibil, përkitjet e dorës së saj nëpër flokët e mi) zënë të ma pushtojnë ëmbëlsisht shpirtin, po me atë kujdes me të cilin kapet qenia e dashur që pëson fatkëqësi dhe që nuk mund të durojë as lëvizjen më të vogël të shpejtë. Pak nga pak vija më vete, përdëllimi nisi të shndërrohet në përmallim, urrejtja ndaj Marisë kaloi në urrejtje ndaj vetes sime, ndërsa mortësia ime në nevojë të papritur që të shkoj vrap në shtëpi. Sa më shumë që i afrohesha ateliesë, aq më shumë e kuptoja ç'po dua: të flas, ta thërras me anë të telefonit në çiflig, menjëherë, pa humbur aspak kohë. Si nuk m'u kujtua më heret kjo mundësi?

Kur ma dhanë lidhjen, thuaja, nuk pata fuqi të flas. U lajmërua një shërbëtor. I thashë se duhej të flitja menjëherë, pa humbur aspak kohë, me zonja. Marinë. Pak më vonë, po ai zë m'u lajmërua e më tha se zonja do të më thërrasë përafërsisht pas një ore.

Pritja m'u bë e pafund.

Nuk më kujtohen saktë fjalët e asaj bisede telefonike, por më kujtohet se, në vend se t'i kërkoja ndjesë për shkak të letrës (shkak për të cilin desha të bisedoja) e kreva bisedën me atë që i thashë gjëra edhe më të rënda se ato në letër. Ishte evidente se ky ishte rrjedhim jo pa arsye; nisa, njëmend, të flas përulshëm e ndjelishëm, por më zemëroi më tepër toni i zërit të saj plot dhembshuri dhe, sipas shprehisë, nuk iu përgjigj asnjërës prej pyetjeve të mia të qarta. Dialogu, thënë më mirë, monologu im bëhej më i zëshëm dhe sa më shumë që bëhej i rrëmbyeshëm, ajo dukej për herë e më e mjerueshme, kurse kjo gjë më tërbonte edhe më tepër,

sepse isha plotësisht i vetëdijshëm dhe e dija se është krejt pa vend dhembja e saj. Mbarova bisedën duke i britur se një ditë do të më mbysë, se ajo është komediste dhe se duhej ta shihja menjëherë në Buenos Aires.

Nuk iu përgjigj asnjërës prej pyetjeve të mia, ndërsa me insistimin dhe kërcënimin tim se do ta vras veten, në fund, premtoi se të nesërmen do të vijë në Buenos Aires, „ndonëse nuk e dinte pse".

— Të vetmen gjë që do ta mbërijmë —shtoi me zë krejt të ulët — është se do të fyhemi mirë e mirë pa mëshirë.

— Nëse — nuk vjen, do të vritem — përsërita në fund. — Mbaje mend mirë para se të marrësh çfarëdo vendimi.

E vara receptorin pa shtuar asnjë fjalë dhe është e vërtetë se, në atë çast, po qe se ajo nuk do të vinte, kisha vendosur të vritem për ta sqaruar situatën. Ndjeva kënaqësi të çuditshme kur vendosa ashtu. „Do të shohë ajo", mendoja, si të ishte fjala për farë hakmarrjeje.

XXXI

Ajo ditë qe e denjë të mallkohet.

Dola idhshëm prej ateliesë sime. Përkundër asaj që do ta shihja të nesërmen, nuk ngushëllohesha dot, ndjeja asi urrejtje të pacaktuar e tinzake. Tash jam i prirur të besoj se ajo gjë ishte kundër vetvetes. sepse e dija, në të vërtetë, se fyerjet e mia mizore ishin pa mbështetje. Mirëpo, më zemëronte që nuk mbrohej, kurse zëri i saj i dhembshëm përulës, as që më fashiste

E urreja vetveten. Atë pasdreke nisa të pi tepër dhe e kreva në një bar në Leandro Alem, duke kërkuar zënkë. E kapa një femër, e cila m'u bë më e prishur se të tjerat, pastaj e provokova një marinar për t'u rrahur, sepse e hodh një fjalë palevale. Nuk më kujtohet se ç'u bë mëtutje, përpos se filluam të rrahemi dhe se na ndanë ca vetë që kënaqën tepër të ndajnë zënqarët. Pastaj më kujtohet se me atë femër dola në rrugë. Freskinë ma kishte ëndja. Në të gdhirë e çova në atelie. Kur hymë nisi të qeshet për një pikturë që ishte në shtafelaj. (Nuk di a thashë se që nga skena me dritarezës krijimtaria ime transformohej gradualisht, sikur qeniet e gjesendet e pikturave të mia më të hershme të

kishin përjetuar një kataklizëm kosmike. Për këtë do të flas më vonë, sepse tash dua të shtroj ç'ndodhi në ato ditë fatale). Ajo femra, duke qeshur e shikonte pikturën, e pastaj mua, si të kërkonte farë shpjegimi. Si do të pandehni, aq më kishte mbetur për mendimin që mund të ketë formuar kjo e mjerë për krijimtarinë time, sa për një kokërr bathi të krimbur. I thashë që të mos humbim kohë për marrëzi.

Ishim në shtrat dhe, aty për aty, më shkrepi një mendim i tmerrshëm, shprehja e rumunes i përgjante shprehjes që kisha vëneruar hera-herë të Maria.

— Lavirja! — brita si i shkalluar, duke u ndarë me neveri — Kuptohet se është lavire!

Rumunia brofi si gjarpëri dhe më kafshoi në dorë deri në asht. Mendoi se kjo fjalë i dedikohej asaj. Plot urrejtje e përbuzje ndaj mbarë botës e qita me shqelma prej ateliesë dhe i thashë se do ta vritsha si qenin nëse nuk dëliret sa çel e mbyll sytë. Përkundër shumës që ia hodha pas, doli duke britur e duke vjellë fyerje e sharje.

Ndenja shumë kohë shtang midis ateliesë, pa ditur ç'të bëja e nuk ia dilja dot t'i mbarshtroj ndiesitë e mendimet. Më në fund, vendosa: shkova në banjë, mbusha kadën më ujë të ftohtë, u zdesha dhe hyra. Desha t'i kthjelloi mendimet, nuk dola prej kade derisa nuk u freskova mirë, truri filloi të funksionojë për mrekulli. U rreka që mendimeve t'ua kthej sa më shumë mprehtësinë, sepse e hetova se arrita deri në pikën vendimtare. Cili ishte mendimi nismëtar? Gulfë mendimesh gufuan pas kësaj pyetjeje që ia shtrova vetes, Ato qenë: rumunia, Maria. lavirja, kënaqësitë, simulimi. Mendova: këto fjalë duhet të paraqesin bamuninë themelore, të vërtetën e idhët nga e cila duhej të nisesha. Angazhimi i vazhdueshëm që t'i mbarshtroja, derisa nuk ia dola të formuloj mendimin në këtë trajtë të tmerrshme e të pamëdyshtë: Maria dhe mantenuta

kishin shprehje ngjasuese; mantenuta simuloi kënaqësinë, Maria, pra, simuloi kënaqësinë, Maria është mantenutë.

— Lavire, lavire, lavire! — brita duke dalë prej kade. Truri më funksiononte me liciditet mizor të ditëve më të mira: e pashë qartë se kësaj duhej t'i jepja fund dhe të mos lejoj të më mashtrojë edhe një herë zëri i saj i dhembshëm dhe shpirti komedist. Duhej t'i dorëzohesha vetëm logjikës që të më prijë dhe t'i shkoqitsha pa drashje rrjedhimet deri në skaj të fjalive, veprimeve dhe heshtjeve ndërdyshëse të dyshimta të Marisë.

Ishte kjo si kur pamjet defilojnë nga ndonjë ankth me shpejtësi marramendëse në dritën e një shkëndije të çuditshme. Derisa u vesha shpejt, para syve më përhiheshin çastet e dyshimit: biseda e parë me anë të telefonit, me aftësi të hatashme të shtihimit e të ushtrimit të gjatë që zbulohej me ndërrimin e zërit të saj; hijet e zeza rreth Marisë që zbuloheshin nëpërmjet aq fjalive enigmatike; dhe ajo flaka e saj që të mos „shkaktoi dhembje", e cila mund ta kishte këtë kuptim: „do të të shkaktoj dhembje me rrenat e mia, inkosekuencat e mia, me vepra të mia të fshehta, me simulime ndijore e sensuale", mbasi mua mundi të më përftojë dhembje ngase më donte përnjëmend; dhe skena e dhembshme me shkrepsa, e ngase që në fillim u bënte bisht madje edhe puthjeve të mia, e ngase e pranoi dashurinë fizike shi kur e vura para alternativës që të pranojë neverinë ndaj dashurisë fizike ose, për krye të kresë, që të pranojë dashurinë e amësisë ose të vëllazërisë; e, kjo gjë, kuptohet, më pengonte t'i besoj shfrimit të kënaqësive të saj, fjalëve dhe fytyrës së saj në dalldi; përveç kësaj, përvoja e saj thjesht seksuale, të cilën vështirë do ta ketë mbledhë me një filozof stoik si ishte Alende; dhe përgjegjet për dashurinë e saj ndaj të shoqit, gjë që lejonte të diktohet aftësia e saj mashtruese me ndiesi të rrejshme e sensibilitet

të rrejshëm; dhe rrethi familjar, të cilin e përbënte një koleksion hipokritësh dhe gënjeshtarësh; dhe serioziteti dhe efikasiteti me të cilën mashtroi dy kushërinjtë e saj me kuazi skica të limanit; dhe skena gjatë darkës në çiflig, biseda poshtë, xhelozia e Hunterit dhe ajo fjali që iu përvodh te shkrepat: „Si u pata mashtruar një herë" — me kë, kur, qysh? dhe „ngjarjet e neveritshme mizore" të atij kushëririt tjetër, që i rrëshqiti prapë pa vetëdije nga goja, ashtu si e zbuloi, kur nuk iu përgjigj kërkesës sime që të shpjegojë — sepse nuk më dëgjoi, nuk më dëgjoi njajzesi, sepse ishte kthyer në fëmijërinë e vet — ndoshta në pohimin e vetëm autektik që bëri në praninë time; dhe, në fund, kjo skenë e tmerrshme me rumunen ose rusën apo çkado që të jetë. Dhe ajo dosa e ndyrë që qeshi me pikturat e mia dhe qenia plot sensualitet që më frymëzoi t'i pikturoj, kishin shprehje të njëjtë në ndonjë çast të jetës së tyre? O zot, si të gjej ngushëllim për shkak të natyrës së njerëzve kur më shkon mendja se ekzistojnë ndërmjet ca çasteve të Shumanit ose Bramsit dhe ndonjë shtëpie publike korridore të fshehta e të errta.

XXXII

Shumë prej këtyre konkludimeve që i nxora nga kjo analizë lucide, por aventime, qenë supozime që nuk munda t'i dëshmoj, edhe pse isha i sigurt se nuk gaboja. Mirëpo, vënerova aty për aty se e humba deri në atë çast mundësinë me rëndësi për analizë: mendimin e personave të tjerë. Hera e parë që më shkoi mendja me kënaqësi egërsimi (e kurrë me aso qartësie intesive) për veprimin dhe personin e përshtatshëm: Lartigon. Ishte mik i Hunterit, mik intim. Njëmend, ky njeri ish për t'u urryer: shkroi një përmbledhje vjershash për kryelartësinë të gjithmbarshme njerëzore, por ankohej që nuk ia dhanë shpërblimin nacional. Nuk e kisha ndërmend t'u qasem skrupullave. E thirra me anë të telefonit me neveri të dukshme, por i vendosur, i thashë se duhet ta shoh urgjent. Shkova në shtëpi te ai për ta vizituar, ia lavdërova përmbledhjen e vjershave dhe ia trusa (pa e përfillur kënaqësinë e tij, sepse deshi ta vazhdojë bisedën) pyetjen e përgatitur që më parë:

— Sa kohë është Maria Iribarneo dashnorja e Hunterit?

Nëna ime kurrë nuk pyeste a e ngrënëm mollën, sepse e mohonim, pyeste sa, duke u shti-

rë se, kishte konstatuar atë që donte të dije, a ngrënëm pemët ose jo; kurse na përgjigjeshim të nxitur pa hetueshëm prej këtij theksimi të kualitetit, e ngrënëm vetëm nga një mollë.

Lartigo ishte mendjemadh, por jo edhe budalla: dyshoi se diçka po fshihej në pyetjen time dhe ia mori mendja se do t'i bëjë bisht duke u përgjigjur:

— Për atë punë nuk di gjë.

Dhe nisi të flasë për librin dhe shpërblimin. Brita me neveri të vërtetë:

— Ç'padrejtësi për librin tënd!

Dola vrap jashtë.

Lartigo nuk ishte budalla, por nuk e vëneroi se fjalët e tij qenë plotësisht të mjaftueshme.

Ishte ora tre pasdreke. Maria duhej të ishte në Buenos Aires. E thirra me anë të telefonit prej një kafeneje: nuk kisha durim të shkoj deri në atelie. Kur u lajmërua, i thashë:

— Duhet të të shoh, menjëherë.

Përpiqesha të fsheh urrejtjen time, sepse drashta se do të dyshojë gjë dhe s'do të vinte në takim. U morëm vesh të shihemi në pesë te Rekoleta, në vendin tonë të vjetër.

— Megjithatë, nuk po shoh se do të arrijmë gjë — shtoi dhembshëm.

— Shumë — u përgjigja — shumë.

— Beson? — pyeti me një fije habie,

— Natyrisht.

— Ndërsa unë besoj se vetëm do t'i shkaktojmë dhembje më të madhe njëri-tjetrit, do ta rrëzojmë edhe më urën e dobët që na bashkon, se do të theremi edhe më me shumë mizori. Hunteri është i sëmurë.

„Edhe një rrenë" — mendova.

— Falemnderit — u përgjigja thatë, — E lamë, pra, të shihemi taman në pesë.

Maria u pajtua me psherëtimë.

XXXIII

Para pesëve isha te Rekoleta, në bankë ku gjendeshim zakonisht. Kur shpirti im i zymtë rrëshqiti në dërmim të plotë, duke i pasë drunjt, shtigjet e bankat, dëshmitarët e dashurisë sonë, i kujtoja me melankoli dëshpërimi momentet që i kaluam në kopshtin Rekoleta dhe në Sheshin Franca. E si besoja atëherë e, më dukej jashtëzakonisht larg, përjetësia e dashurisë sonë. Krejt ishte për mrekulli, si vegulli, kurse tash ishte krejt e terratisur, e ftohtë, në këtë botë idiferente të zhveshur nga ndiesitë, Për një sekondë u përkunda në frikë ta asgjësoj edhe atë grimë që kish mbetur nga dashuria jonë dhe të mbetem përfundimisht vetëm. Më shkoi mendja se, ndoshta, është e mundur t'i lë anash të gjitha dyshimet që më mundonin. Ç'më hynte mua në punë se ç'ishte Maria jashtë këtyre marrëdhënieve tona? Duke i shikuar ato banka, ata drunj, më tha mendja se nuk do të isha pajtuar kurrë që ta humb përkrahjen e saj, madje edhe në ato çaste të bashkimit, të dashurisë së fshehtë që na bashkonte. Sa më thellë që dilja në fushë të kësaj persiatjeje, më imponohej përherë e më shumë mendimi që ta pranoj dashurinë e saj ashtu, pa kushte, dhe aq më shumë më frikësonte se do të mbes pa asgjë, absolutisht pa asgjë. E nga kjo frikë më lindi dhe u rrit përvuajturia, të cilën e kanë vetëm njerëzit që nuk kanë çka të zgjedhin. Më në fund nisi të më pushtojë gëzimi kur pashë se nuk hu-

mba asgjë dhe prej atij çasti të ndritshëm mund t'ia filloja një jete të re.

Mjerisht, Maria më tradhtoi edhe një herë. Në pesë e tridhjetë, i frikësuar, si i trent, e thirra me anë të telefonit. Më thanë se ishte kthyer papritmas në çiflig. I bërtita shërbëtores pa e hetuar fare:

— Mirëpo, u morëm vesh të shihemi në pesë!

— Unë nuk di gjë, zotëri — u përgjigj diqysh frikësueshëm.

— Zonja doli pak më parë dhe tha se atje do të rrijë më së paku një javë.

Më së paku një javë! M'u duk se bota do të shembet, çdo gjë më bëhej e pabesueshme dhe e padobishme. Dola prej kafenesë si somnabull. Më binin në sy gjësende pa fije kuptimi: femrat, njerëzit që kalonin prej një ane në tjetrën, si të kishte kjo farë funksioni. E sa e luta të shihemi atë pasdreke, sa më duhej ajo! E si isha i disponuar të kërkoj, të lyp krejt pak gjë prej saj!

Mirëpo — më shkoi mendja me indinjim të tmerrshëm — ndërmjet ngushëllimit që do të ma bënte mua në park dhe fjetjes me Hunterin në çiflig, nuk kishte vend dyshimi. Ndërsa mendoja për këtë, në tru më shkrepi një mendim. Jo, të them më mirë, isha i sigurt në diçka: Ua dhashë këmbëve, i kalova vrap ca bërryla rrugësh, sa m'u desh të arrija deri tek atelieja dhe, prej andej, thirra menjëherë prapë shtëpinë e Alendes, Pyeta a kish marrë zonja thirrje telefonike prej çifligut para se të shkonte.

— Po — duke u ndërdyshur pak u përgjigj shërbëtorja.

— Thirrje nga zotëri Hunteri, apo jo?

Shërbëtorja u ndërdysh prapë. Vënerova se u ndërdysh në të dy herat.

— Po — u përgjigj në fund.

Porsi demon më pushtoi idhësi galduese. Shi ashtu si mendoja. Më kaploi një ndiesi e vetmisë së pakufishme dhe e krenarisë së paarsyeshme: krenarisë që nuk u mashtrova.

Më shkoi mendja te Mapelio.

Sa u bëra gati të dal prej ateliesë, kur më ra në mend një ide e re. Shkova në kuzhinë, ia ngjita thikës së madhe dhe u ktheva në atelie. Sa pak punime kishin mbetur nga krijimtaria e dikurshme e Huan Pablo Kastelos! Do të kenë arsye të krenohen me vetveten ata budallenj që më krahasonin me ndonjë arkitekt! Cili prej atyre budallenjve e zgjedhi se brenda për brenda të arkitekturave të mia dhe, „atij intelektualizmi" ishte vullkani i gatshëm të shpërthejë? Asnjëri. Do të kenë mjaft kohë t'i shikojnë këto shtylla në copa, këto shtatore të dëmtuara, këto gërmadha në tym, këto shkallë të mallkuara. Ato qenë si muze detesh të gurëzuar, si ndonjë muze *Dëshpërimi* dhe *Turpi*. Mirëpo, ishte diçka që doja ta arsyetoj, të mos e lë asnjë gjurmë. I shikova për herë të fundit, ndjeja se si më shtrëngonte fyti, por u hamenda: e pashë atë bregdet disi paqartë nëpër lotë se si rrënohej në copa, ajo grua e largët përdëlluese, ajo pritje. I shkela copat e pikturave duke i fërkuar për dysheme derisa nuk u bënë zhele të ndyra. Kurrë nuk do të marrë përgjegjen ajo pritje pa arsye! Tash e dija më tepër se kurrë më parë se kjo pritje ishte plotësisht e padobishme.

Shkova vrap në shtëpi te Mapelio, por nuk e gjeta. Më thanë se duhej të ishte në librarinë Viao. Shkova deri në librari, e gjeta, e kapa për dore, etërhoqa pak në skaj dhe i thashë se më duhej automobili i tij. Më shikoi dhe më pyeti mos ndodhi farë e papritur. Nuk dija si t'ia lidh, por më ra në mend t'i them se babanë e kisha shumë të sëmurë e se, deri nesër, nuk kishte tren. Më propozoi të më vozisë ai, por refuzova: i thashë se do të shkoja më me dëshirë vetëm. Më shikoi prapë hutueshëm, por, megjithatë, m'i dha çelësat.

XXXIV

Ishte gjashtë e gjysmë pasdreke. Llogarita se me automobilin e Mapelios do të arrija për nja katër orë, ashtu që në dhjetë do të isha atje. „Në çastin e duhur" — më tha mendja.

Sapo dola në udhën për Mal de Ploto, t'ia dhashë shpejtësisë njëqind e tridhjetë kilometra dhe fillova të ndiej kënaqësi të çuditshme, të cilën tash ia mvesh sigurisë se do të bëj më në fund diçka konkrete me atë. Ajo që tash ishte si dikush mbrapa ndonjë muri të qelqët të papërshkueshëm, dikush që unë mund ta shihja, por jo ta dëgjoj ose ta përkas; dhe jetuam në këtë mënyrë përdëllyese dhe melankolisht të ndarë nga muri i qelqët.

Në këtë kënaqësi qiste krye dhe trette ndjenja e fajësisë, e urrejtjes dhe e dashurisë: e trillova sëmundjen, e kjo më mjeronte, ia qëllova që thirra për herë të dytë shtëpinë e Alendes, e kjo më indinjonte. Ajo, Maria mund të qeshte me panjerëzi, mund t'i binte në dorë atij ciniku, atij feministi, atij poeti të rrejshëm të shpifur. Çfarë përbuzje ndjeja ndaj saj! Duke e marrë me mend këtë vendim të saj të fundit, kërkoja kënaqësi të dhemshme në formën më të urryeshme: më një anë isha unë, u patëm marrë vesh të

shihemi atë pasdreke, pse? që të bisedonim për gjëra të zymta, për t'u gjendur edhe një herë përballë njëri-tjetrit, ndërmjet murit të qelqët, për t'i përshkuar shikimet tona përdëllyese dhe dëshpëruese, që të rrekemi t'i kuptojmë shenjat tona, që të dëshironim kot të prekeshim, të përkiteshim, të përgëdheleshim nëpër murin e qelqët, që të shihnim edhe një herë atë ëndërr të pamundur. Në anën tjetër ishte Hunteri, të cilit nuk i duhej tjetër pos ta merrte telefonin dhe ta thirrte që ajo të turrej vrap për të rënë në shtratin e tij. Nuk ishte krejt kjo çuditëritëse dhe e dhembshme?

Në çiflig mbërrijta në dhjetë e një çerek. Automobilin e ndala në rrugën kryesore për të mos tërhequr vërejtjen me vramvullimën e motorit dhe u nisa këmbë. Vapa ishte e padurueshme, mbrëtëronte qetësi e thellë dhe dëgjohej vetëm ushtima e detit.

Drita e hënës shpërthente vetëm kohë pas kohe nëpër re, kështu që munda të shkoj pa vështirësi shtegut të hyrjes ndërmjet eukaliptuesve. Kur mbërrijta para shtëpisë së madhe, pashë se drita ishte e ndezur në katin e poshtëm, më shkoi mendja se ishin ende në drekore.

Ndihej ajo zapulli amull kërcënuese që u paraprin shtërngatave të forta të erës. Ishte e kuptueshme të dilnin pas darke. U fsheha në një vend të parkut, prej nga mund të përcillja daljen e njerëzve nëpër shkallë, dhe prita.

XXXV

Ishte kjo pritje kund pa skaj. Nuk e di sa kohë kaloi në orë, të asaj kohe anonime dhe universale të orës, të cilën nuk e përfillin ndiesitë tona, pritja e një vdekjeje. Mirëpo, ishte e madhe dhe e ndërlikuar masa e kohës sime të mëvetishme, përplot gjithçka e kthim në të kaluarën, ishte ngaherë lumë i errët e tinzak, ngaherë çuditërisht i qetë si det i palëvizshëm prore, ku qëndruam fytyrë për fytyrë unë e Maria e shikoheshim pa lëvizur dhe kjo bëhej prapë lumë që na barte si në farë ëndrre të kohës së fëmijërisë dhe unë e shihja duke ngarendur si pa mend në kalin e saj sy shkreptirë, kurse era ia merrte flokët, kurse veten e pashë në fshatin tim, në jug, në dhomën e të sëmurëve, me fytyrë të mbështetur për qelq, duke e shikuar, po ashtu, me sy rrufe borën. E kjo dukej si të jetonim të dytë në kalestra paralele ose zgafella pa e ditur se ecnim pranë njëri-tjetrit, si shpirtër të ngjashëm në kohë të ngjashme, për t'u gjendur në fund të këtyre kalestrave para një skene, të cilën e pikturova unë si shifër që i dedikohej vetëm asaj, si paralajmërim i fshehtë, se unë isha më aty dhe se kalestrat, fundja, u bashkuan e se erdhi çasti i takimit.

Erdhi çasti i takimit! Mirëpo, a u bashkuan kalestrat përnjëmend dhe shpirtërat tona u lidhën? Ç'iluzione gabërruese në krejt këtë? Jo. kalestrat ishin paralele si edhe më parë, ndonëse muri që i ndante ishte si ndonjë mur i qelqët, kurse unë mund ta shihja Marinë si ndonjë figurë memece, të cilën nuk mundja ta përkas... Jo, as ky mur nuk qe, madje, gjithmonë i këtillë: ngaherë ish prapë prej gurëve të zez, dhe unë nuk mund ta dalloja ç'po ndodhte matanë tij, ç'bëhej me të në ato intervale anonime, ç'ngjarje të çuditshme ndodhnin, madje, në ato çaste, pandehja se fytyra e saj ndërronte dhe se e deformonte njëfarë grimase përqeshëse, e se, ndoshta, ua falte buzëqeshjen edhe të tjerëve dhe se i tërë kallëzimi për kalestrat ishte një trillim imi qesharak ose bindje se *ishte, gjithsesi një tunel, i errët e vetmitar: tuneli im, tunel në të cilin kaloi fëmijëria ime, rinia ime, e tërë jeta ime.* E, në njërën prej atyre pjesëve të tejdukshme të qelqit e pashë atë vajzë dhe besova naivisht se shkonte nëpër tunelin tjetër, paralelisht me timin, shi kur i përkiste në realitet botës së gjerë, botës pa kufij, atyre që nuk jetonin në tunele; e, ndoshta, iu afrua nga kërshëria njërës prej dritarezave të mia të çuditshme dhe i ra në sy pamja e vetmisë pa shpresë ose ia zgjoi interesimin gjuha ime memece, shifra e pikturës sime. E, më pastaj, ndërsa unë shkoja për herë e mëtutje nëpër kalestrën time, ajo bënte jashtë jetë normale, jetë të bujshme asi jete që bënin ata njerëz që jetonin jashtë, asi jete të çuditshme e të pakuptimtë të stërmbushur me vallëzime e solmenitete, përgëzime e frivolitete. E, ndodhte ngaherë, kur më qëllonte të kaloja pranë ndonjë dritareze time, ajo më priste heshtas e përdëllyeshëm (pse më priste heshtas e përdëllyeshëm?), por ndodhte ngaherë, ajo të mos vinte me kohë ose ta harronte atë qenie të mjerë të mbyllur, e, atëherë unë e shikoja prej së largu me fytyrë të mbështetur

fort në murin e qelqët se si qeshej ose vallëzonte pa brenga ose, që ishte edhe më keq, nuk e shihja fare, dhe e merrja me mend në vise të pakalueshme ose gabrre. Dhe, atëherë, ndjeja se fati im ishte edhe më pastaj pa skaj, i vetmuar sesa që mund të merrja me mend.

XXXVI

Pas gjithë asaj kohe ankthi e tuneli, zbritën shkallëve. Kur i pashë që mbaheshin për dore, ndjeva se zemra m'u bë gur dhe u ftoh si copë akulli.

Zbritën ngadalë si njerëzve që nuk u ngutet. E, pse të nguteshin? — mendova me idhësi. Ndërsa ajo e dinte, pa pikë dyshimi, se kisha nevojë për të, se atë pasdreke e prita dhe se vuajta tmerrësisht gjatë çdo minute të pritjes së kotë dhe se ajo e dinte gjithqysh se mua do të më pushtojë po në atë çast një ferr mendimesh dhe imagjinacionesh! Oh, ç'mizori mund të fshehë në zemër femra e pandieshme! Ç'kafshë e ndyrë pa dhembje, e ftohtë akull mund të fshihet në zemrën e femrës më sensibile. Ajo ishte në gjendje ta shikojë qiellin e stuhishëm (për dore me atë krijesë groteske) të shetisë ngadalë nëpër park duke e mbajtur për dore, t'u marrë erë me sensibilitet luleve, të ulet pranë tij në bari, edhe pse e dinte se edhe unë e prita kot në atë çast, se kisha thirrur në shtëpi të saj dhe se e kisha marrë vesh se ishte nisur për çiflig, se do të gjendem në shkretëtirë i pushtuar nga brofulli i krimbave të uritur, të cilët ma brenin çdo pjesë të rropullit.

Dhe bisedonte me atë përbindësh qesharak? Dhe mos po më përqesh mua në atë çast? A mos jam unë budalla, njeriu qesharak nga tuneli dhe me porosi të fshehta?

Shetiten bukur një kohë nëpër park. Shtërngata ishte ngritur përmbi ne, e zezë, e shqyer nga vetëtimat dhe bumbullimat. Era frynte fort nga pampa dhe ranë edhe pikat e para të shiut, u shtrënguan t'ia japin vrapit për t'u strehuar në shtëpi. Ndjeja se nga ky strofull ndërmjet drunjve do të jem dëshmitar i zbulimit të fshehtësisë së urryer, të cilën e merrja me mend.

Nuk ia ndava sytë dritës në katin e parë, i cili ishte ende i tëri në terr. Pak më vonë pashë se u ndez drita në dhomën e midisme të fjetjes, në të cilën flinte Hunteri. Deri në atë çast krejt qe normale. Dhoma e Hunterit ishte përballë shkallëve dhe ishte e logjikshme të ndritet e para. Tash duhej të ndizej drita edhe në dhomën tjetër. Për aq sekonda, sa iu deshën Marisë prej shkallëve deri në dhomë, zemra ime i përcolli me të rëna plot vrer e egërsi.

Mirëpo, drita tjetër nuk u ndez.

O zot, nuk kam fuqi të tregoj se qysh ma zbrazi shpirtin ndjenja e vetmisë së paanë. Ndjeva se anija e fundit që mund të më shpëtonte nga ujdhesa më e shkretë, kaloi larg dhe nuk i vëneroi shenjat e mia të hekës. Fuqia nisi të më lëshoi ngadalë, si të isha mplakur shqim.

XXXVII

Duke qëndruar nën drunj, të cilët i përkundte erëmadhja, u laga qull, ndjeja se koha kalonte pamëshirshëm. E pastaj pashë me sy të rritur prej lotëve e shiut se u ndez drita edhe në dhomën tjetër.

Më kujtohet si ndonjë ankth ajo që ndodhi më pastaj. Duke i qëndruar shtërngatës, u ngjita nëpër grila të një dritareje deri në katin e epërm. Mandej kalova nëpër një taracë derisa nuk e gjeta një derë. Hyra në galerinë e brendshme dhe kërkova dhomën e saj të fjetjes; shiriti i dritës nën derë më tregoi më saktësi dhomën e saj. Duke u dridhur e nxora thikën dhe e hapa derën. „Për ta mbyllur me çelës" — isha ende në gjendje të mendoj me idhësi. E kur më shikoi ajo me sytë e saj shkreptirë, unë qëndroja te pragu. U afrova te shtrati dhe, kur isha krejt pranë saj, më tha dhembshëm:

— Ç'do të bësh, Huan Pablo?

Duke ia vënë dorën e majtë në flokë, iu përgjigja:

— Nuk mundem pa të vrarë, Mari. Më ler vetëm.

Mandej, duke qarë, ia ngula thikën në gjoks. Ajo i shtrëngoi nofullat dhe i mbylli sytë. Ndërsa,

kur e nxora thikën, nga e cila pikonte gjaku, ajo i hapi sytë dhe ma nguli shikimin plot dhembje e përulësi.

Një tërknezja e papritur më bëri të pamëshirshëm dhe ia ngula edhe disa herë thikën në gjoks e stomak.

Pastaj dola në taracë dhe brita me nxitim, si të ishte vendosur demoni gjithkund në shpirtin tim. Vetëtimat ma treguan për herë të fundit pejzazhin, të cilin e mbanin tonin.

Ngutesha në Buenos Aires. Mbërrijta në katër apo pesë të mëngjesit Prej një kafeneje telefonava në shtëpi të Alendes, u thashë ta zgjojnë dhe t'i thonë se duhej të shihesha me të, menjëherë. Pastaj shkova vrap në Rrugën Posadas. Polaku më priste te dera. Kur u ngjita në katin e pestë, para ashensorit e pashë Alenden. Kot i qenë hapur sytë gapërr. E kapa për dore dhe e futa brenda. Polaku hyri, si idiot, pas nesh dhe më shikonte i tmerruar. Kërkova ta qesë jashtë.

— Po vij prej çifligut! Maria ka qenë dashnorja e Hunterit.

Alendes iu shtang fytyra si mejtit.

— Budalla! — klithi duke shtrënguar dhembët me urrejtje akulli.

Brita si i trent ngase nuk më besoi:

— Ju jeni budalla! Maria ka qenë dashnorja ime dhe e shumë të tjerëve!

Ndërsa unë ndjeja kënaqësi të madhe, i verbëri, duke qëndruar në këmbë, dukej si guri:

— Po — brita — unë ju kam mashtruar juve, ajo na ka mashtruar të gjithë neve. Mirëpo, tash nuk do të mundet ta mashtrojë askë! Më kuptoni! Askë! Askë!

— I çmendur! — hungëroi i verbëri me zë të bishës dhe u sul në mua me duar që u gjasonin kthetrave. U tërhoqa anash, kurse ai hasi në një tavolinezë dhe u rrëzua. u çua jashtëzakonisht shpejt dhe më ndoq nëpër dhomë, duke

hasur në karrige e mobile, duke qarë pa lotë, lëshonte do klithje të thata dhe uluronte: *i çmendur!*

Mbasi e shtyra shërbëtorin që desh të më ndalë, u lëshova vrap shkallëve dhe dola në rrugë. Më pushtoi urrejtja dhe dhembshuria.

Kur u dorëzova në komesariat, ishte gati gjashtë,

Nëpër dritare të qelisë sime pashë duke lindur dita e re, gati pa re në qiell. Më shkoi mendja se tash do të nisin të çohen shumë burra e gra, e pastaj do të hanë mëngjes, do të lexojnë gazetat dhe do të shkojnë në punë ose do t'i ushqejnë fëmijët ose macet ose do të flasin për filmin e mbrëmshëm.

Ndjeja se në veten time po hapej dhe rritej njëfarë humnere e zezë!

XXXVIII

Gjatë atyre muajve të burgimit u përpoqa shpesh ta sjell ndërmend fjalën e fundit të të verbërit,fjalën *i çmendur!* Rraskapitja ose farë shtytje e errët më pengonte ta bëj këtë gjë. Ndoshta një ditë do të më shkoj për dore ta bëj e, pastaj, do ta analizoj edhe gjënë që e shtyri Alenden të vritet.

Të paktën mund ta pikturoj, edhe pse, ma merr mendja, mjekët do të qeshen pas shpine, ashtu si ma merr mendja, u qeshën edhe në proces kur e përmenda skenën në dritareze.

Ekzistoi vetëm një qenie që e kuptoi artin tim. Ndërkaq, këto piktura do t'ua vërtetojnë me siguri për herë e më shumë pikëpamjet e tyre të marrëzishme. Ndërsa muret e këtij ferri do të mbyllën në këtë mënyrë hermetikisht për çdo ditë e më tepër.

PASTHËNIE

Ernesto Sabato me romanin e tij të parë *„Tuneli"* arriti popullaritet të madh e edhe jashtë Argjentinës. Ky roman i botuar 1948 u ra shpejt në sy Alber Kamysë dhe Gream Grinit të cilët u përpoqën ta përkthejnë në frëngjishte, përkatësisht në anglishte. *„Tuneli"* u përkthye më vonë edhe në gjuhë të tjera.

Rrëfimi për krimin nga dashuria tërhoq vëmendjen jo për shkak të të dhënës se e rrëfen personazhi kryesor — Kasteli, por për shkak se çdo fjali është simbol i rritjes së një çmendie, e cila është, prapë, simbol i një metafizike dëshpërimi dhe pa shpresë. Çmendia e Kastelit ka njëfarë logjike të vet të brendshme, ajo është ngaherë, madje, intelektuale dhe e nxitur nga imposibiliteti i tij të komunikojë me botën, madje edhe me të dashurën e tij, Marinë (Për gjasë: kritikët konsiderojnë se Maria është personazhi i parë i romanit latino-amerikan që lexon Sartrin). Duket se Kasteli është i humbur në një tunel, muret e të cilit bëhen kohë pas kohe të tejdukshëm, duke i bërë të mundur të shohë njerëzit e tjerë si lëvizin e jetojnë. Mirëpo, vetmia e Kastelit, dëshpërimtar, ndryerja e tij më vetvete dhe kjo botë, janë momente që përftojnë dramën. Imagjinata e tij e sëmurë me logjikën e tij ngulmuese krijojnë atmosferë paranoide që arrin kulmin me krimin. Pamja e botës, si shihet në këtë vepër, me sytë e një „un-i" të pëlkyer është ekstremisht subjektive, ajo tregon qartazi sa është Kasteli i paaftë të hyjë në jetë me njerëzit që e rrethojnë. Stili i Sabatos, qartësia e fjalisë së tij, e përfytyrojnë jashtëzakonisht fuqishëm këtë kaos të xhelozisë e të vetmisë.

Ernesto Sabato i lindur më 1911 në Rohan, provinca e Buenos Airesit, në rini u muar me pasion me shkencë. Studioi fizikën dhe matematikën në Universitetin e La Platos, studimet dhe kërkimet i vazhdoi në Paris me bashkëpunëtorët Frederik dhe Irena Zolio-Kyri, pastaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. U bë shkencëtar i ri që premtonte shumë. Shumë ekspertë që e njohën në atë kohë e konsideruan shpresë të madhe të shkencës bashkëkohëse. Sabato pat në rini, përveç ndaj shkencës, edhe një pasion tjetër të madh pasionin ndaj letërsisë. Shkruante me kënaqësi dhe punimet e veta të para i publikoi me insistimin e miqve të tij. Në fund, aty rreth vitit 1941 e la krejtësisht shkencën dhe iu kushtua krejtësisht letërsisë. Këtë vendim të tij shumë shkencëtarë e morën me keqardhje duke theksuar se shkenca me këtë vendim humbi një lavrues jashtëzakonisht të vyeshëm, i cili do t'i kontribuonte shumë më tepër njerëzimit si fizikan sesa si shkrimtar.

Ndërkaq, esetë e parë të Sabatos, të botuar në revistën *„Sur"* („Jugu") të Buenos Airesit, tërhoqen menjëherë vëmendje me stilin e vet polemizues, kulturën e thellë të autorit dhe luciditetin tij jo të përditshëm. Shumë prej këtyre eseve u botuan më 1945 në përmbledhjen *„Individi dhe univerzumi"*. Ky është një lloj fjalori filozofik i kohës sonë, përplot humor dhe vënerime shpotitëse.

Ardhja e Peronit në pushtet dhe shpërthimi i krizës së thellë shoqërore, politike e morale e detyturën e thellë të autorit dhe luciditetin e tij jo të për-Kohët nuk ishin më të përshtatshme për lojëra. Sabato qe i shtrënguar të distancohej nga opinioni i atëhershëm kulturor argjentinas, i cili, edhe pse nuk e përqafoi demagogjinë peroniste, ishte pjesëmarrës i heshtur i tij, se luante rolin e opozitës së plogësht. Në vend të persiatjeve intelektuale, në shënimet e tij të shkurtëra, në veprën e tij hetohet për herë e më me fuqi angazhimi serioz letrar e humanist. Në ca nga esetë e tij *(„Njerëzit e ingranazhet"*, 1951,, *„Fytyra e peronizmit"*, 1958) si dhe në romanin *„Tuneli"* ndihet në mënyrë të thellë ky riorientim i tij.

Në horizontin intelektual të Sabatos duken edhe ndikime të tjera që, ndër të cilët ishte më i fuqishmi ekzistencializmi, lanë vulë të epur në krijimtarinë e Sabatos të asaj periudhe.

Sabato, pas rënies së Peronit, refuzoi të marrë pjesë në restaurimin e botës anakronike dhe oligarkike, e cila bëri të mundur, e madje, të domosdoshme shfaqjen e peronizmit, gjë që vetëm ia rriti edhe më tepër prestigjin shoqëror këtij shkrimtari.

Në mbështetje të kësaj Emir Rodriges Monegalo, kritik i njohur latino-amerikan, konsideron se Sabato bëhet paraprijës i asaj gjenerate pak më të re të shkrimtarëve argjentinas, e cila i hyri, ndonëse pat deri-diku të drejtë, likuidimit të pamëshirshëm të trashëgimisë së tre shkrimtarëve të vjetër: Martines Estrade, Eduardo Maleo dhe Horheo Luis Borheso.

Nga kjo periudhë rrjedh portreti i Ernesto Sabatos si antiborhesonist ose i shkrimtarit që paraqet alternativën më të mirë argjentinase të Borhesos.

Emir Rodriges Monegalo konsideron se portreti i këtillë i Sabatos është pjesërisht i pasaktë. Hapat e parë letrare të Sabatos janë të lidhur me Borheson. Ai i fle edhe për nga shumë preokupime të veta intelektuale. Gjëja që, Sabaton e dallon, në realitet, prej Borhesos, është xhindosja e tij e thellë nga fuqitë e errta të personalitetit të njeriut. Për këtë arsye Sabaton e radhisin ndër shkrimtarë të tipit të Dostojevskit, gjë që e dëshmon më së miri romani i tij më i ri *„Mbi heronjtë dhe varrezat"*, i botuar më 1961, si dhe përmbledhja e eseve *„Shkrimtari dhe vegullia e tij"* që u botua më 1963.

Nëse Sabaton nuk e trajtojmë si alternativë të Borhesos, atë mund ta konsiderojmë shkrimtar ndër realistë dhe, njëhohësisht, shkrimtarë ëndërrimtarë argjentinas si është Roberto Arlto, Leopolo Mareshalo, madje edhe Hulio Kortasaro, bashkëkohës i tij. Sabato paraqet qe disa vite atë letërsi argjentinase që nuk njeh kufij të tjerë, përveç atyre që ia imponon realiteti i ndërlikuar.

Romani *„Mbi heronjtë dhe varrezat"* është vepra më voluminoze dhe më e epur e Ernesto Sabatos. Në këtë vepër të thellë të epur Sabato depërton në shtresa më të errta të vërdalljes dhe paraqet nëntokën çuditëruese e kaotike të Buenos Airesit. Ngjarja e këtij romani zhvillohet në kohën e pushtetit të Peronit. Sabato, duke njohur historinë dhe faktet, pikëzon me njohuri të njëmendtë personalitetet karakteristike, të kënduara ndër tangotë si dhe ngjarjet dramatike, siç është djegia e kishave sipas urdhërit të Peronit, në qershor të vitit 1955. Kapitulli me titull *„Raporti për të verbërit"*, në të cilin përshkruhet aktiviteti i çuditshëm i një organizate të të verbërve që sundon botën, shumë kritikë e konsiderojnë kryevepër. Në këtë vepër përshkruhen gjithashtu edhe ngjarje historike të Argjentinës, të cilat i paraprijnë krijimit të dramës argjentinase të padiferencuar. Kjo është dramë e një vendi ardhacakësh, vend pa plangçorë, i cili përplitet ndërmjet Evropës dhe Amerikës.

Kjo përplitje më të kërkuar të kulturës vetanake, definimet vetanake dhe qenia nacionale, dalin nga ky roman i Sabatos.

Kritikët latino-amerikanë me renome *„Tunelin"* e konsiderojnë si një lloj parathënie të gjerë të romanit *„Mbi heronjtë dhe varrezat"*. *„Tuneli"* mund të merret më parë si uvertyrë në të cilën përmblidhen motivet themelore, obsesionet më qenësore të veprës letrare të Sabatos: vetmia dhe imposibiliteti i komunikimit me botën.

Ky roman i epur, i cili lexohet me një frymë, do t'u ndihmojë në mënyrë të qartë lexuesve si hap i parë për të njohur këtë shkrimtar, i cili i përket, qe bukur do kohë, elitës së shkrimtarëve latino-amerikanë dhe botërorë.

R. T.

BIBLIOTEKA POPULLORE „MILLADIN POPOVIQ"
BIBLIOTEKA „MILADIN POPOVIQ"
NARODNA BIBLIOTEKA • PRISHTINË-PRIŠTINA •

ERNESTO SABATO

TUNELI

Redaktor teknik:

Enver Sylejmani

Korrektor

Shemsedin Gorani

Tirazhi 2.000 copë

U shtyp në dhjetor të vitit 1981
në Shtypshkronjën e OPGBG
„Rilindja" — Prishtinë

Ernesto Sabato • TUNEL

Cmimi 50 din.